


VIOLETA ALLMUÇA

BIBLIOTEKA

B6H-31  
H-59

# JULIA

roman



BOTIMET TOENA

**Botues: Fatmir Toçi**

**Redaktor: Perikli Jorgoni**

**Korrektore letrare: Elda Kelo**

**Përkujdesja grafike dhe kopertina: Lavdie Cenmurati**

**ISBN 99927 - 1 - 808 - 0**

**© Autori**

**BOTIMET TOENA**

Rr. "Muhamet Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: (355) (4) 240116; 240117

Tel./Fax: (355) (4) 240117

E-mail: [toena@icc.al.eu.org](mailto:toena@icc.al.eu.org)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

## EPILOG

 Yteti i hirtë nuk fshihte asgjë, as gjurmët e dimrit, as lagështinë e vjeshtës. Ditët errësoheshin shpejt, ndërsa netët flinin gjatë. Pasardhësit filluan ta urrenin qytetin e lagësht, ashtu siç urrenin ndryshkjen e hënës, për të cilën kishin dëgjuar nga të parët. Ata i harruan këto përfytyrime, derisa një ditë qyteti u zgjua mbi vdekjen.

- Ikën paraardhësit, - tha Angjelina D. - Ikën në botën tjetër. Quditërish ne jemi një racë që kryqëzuam vetveten. Kohë më vonë bota kishte dëgjuar ulërimat e ulkonjës, pas ngricës së egër të dimrit. Shenjtori i qytetit u lut për mëkatet e paraardhësve që morën me vete emrin e tyre të mirë dhe zemërimin e keq.

Vetëm një personazh nuk kishte ikur ende në atë botë, Angjelina D. Ajo ishte pushtuar nga mëdyshja. Trokiste çdo mbrëmje me një bastun të hirtë tokën duke mërmëritur nën zë. I akuzoi pasardhësit, se mbi ta do të binte urrejtja e të vdekurve. Madje secili do të humbte shpirtin, po të harronin të ktheheshin.

- Bij kurve jeni të gjithë, - tha me zë të lartë shitësi i qumështit, teksha shoqëronte kortezhin e përmortshëm të një vajze të re.

Fundi i ditës u mbyll nën një qiell pa ngjyrë, me pikë të mëdha shiu si lotë njerëzorë.

- Ajo do të shkojë sonte në përjetësi, atje ku jeton shpirti i të gjithëve, - foli Julia D.

Njerëzit mbanin mbi supe arkmortin e rëndë të vajzës, që askush nuk e dinte pse vau veten.

Para syve i kalonin duar që përqafonin atë kriesë të brishtë e të prekshme, e cila kishte mbajtur mbi vete botën e shurdhër. Një pluhur lulebore i ra në gjoks. Ajo mbeti vetëm një hije në përshtypjen e të gjithëve.

- Cila jeni ju?, - pyeti me një zë të dobët gruaja që e preku me dashje në parakrah.

- Një pasardhëse e kësaj bote, - iu përgjigj vajza dhe kreu lutjen e zakonshme.

Sytë e tejdukshëm të Angjelinës u shkëputën nga pluhuri i luleborës.

**S**humë kohë më parë Julia D. mendonte se u përngaiste mjaft të parëve të vet. Murtaja e mëvonshme e hakmarjes u shfaq një ndajnatë si maskë e vjetëuar në formë të një tèrbimi. Duelet në historinë e njerëzve prisin të mbaronin, kur të frynte era e frikshme e vdekjes. Ajo dëgjonte si e përhumbur shtyren e kohës që bëhej njësh me mendimin për të mos u kthyer mbrapa.

Njeriu mund ta sajonte si të dëshironte legjendën e jetës së të tjerve. Por ai nuk mundej kurrsesi ta fshinte nga kujtesa ose vegimi i pasardhësve të tij, sepse kështu funksiononte pushteti i jetës mbi vdekjen. Mjaft ide të pashpjeguara kalonin nga njëri pushtet në tjetrin duke formuar moskuptimet që lëviznin nga paraardhësit tek pasardhësit.

Julia besonte, se mungesa e një ndryshimi mbante peng shpirtërat e pafajshëm të zanafilës njerëzore. Askush nuk mund të shkonte në vdekje pa jetuar jetën e tij me jetën e të tjerve.

Ajo ishte vajza e dytë e fisit më të njojur të qytetit E. Qysh në moshën dhjetë vjeçare vajza mësoi të rrrethohej nga disa rregulla që e mbërthenin prej mëngjesit, deri në mbrëmjen e shkurtër. Altari i saj i veçantë ishte zbulimi në një kohë të pacaktuar i një emri enigmatik të familjes. Gjithçka ishte lidhur me një keqkuptim që kthehej nga fillimi, e stërhollohej më shumë nga një zë tek tjetri. Kur

asgjë nuk kishte fund thyhej heshtja. Gjyshja Angjelina, pjesa e gjallë e trungut të mbetur nga fisi i saj i dëgjuar, zbuloi e para se dashuria ndaj një burri, nuk ishte vetëm një ndjenjë e gjallë, por edhe e vëtmja ndjenjë e vdekur.

- Dëgjo, Julia çfarë po të them. Kujtoje sa herë të kesh nevojë t'i thërrasësh kujtesës, - iu drejtua vajzës me një vështrim të gjatë. - Ti nuk e di, çfarë është përcëmimi i së kaluarës, sepse ti je një fëmijë që dëgjon historitë e të tjerëve. Ndoshta të vjen rrëth e rrötull bota e dikujt tjetër. Por mos harro, secili ka historinë e tij të lidhur me historinë e të tjerëve. E vëtmja që të mbetet, është të kujtosh e më pas të harrosh se ke fiksuar me vërtetësi të shkuarën, madje ta mbyllësh atë brenda vetes.

Jashtë njolla të hirta kishin mbështjellë qiellin e silleshin përqark, sikur të kishin frikë nga njëra-tjetra. Diku retë thërrmoheshin në mjegull e fshihnin paragjykimet e natës së shkuar, nëpër udhët e ftohta të janarit.

Julia zbriti me të shpejtë shkallët, e veshur me një fund të shkurtër, apo dëgjoi sinjalin me refrenin e himnit kombëtar. Ajo qeshte shpesh nga këto pasione të të dashurit, për t'i kthyer gjendjet e trazuara të shpirtit në përjetime ngazëlliyese. Migeni i hodhi një vështrim të ngrohtë që buronte nga sytë ngjyrë qielli të errët, rrëthuar nga një skelet i hollë syzesh optike. Megjithëse ndodhej shumë afër saj, i dukej se ajo po i largohej deri në ikje.

Ishte adhuruesi i parë romantik i dashuruar ca kohë më parë që kishte hyrë në jetën e saj. Në fillim Julia i ngjasoi me diçka të paarritshmë, me diçka që ishte e prirur drejt asaj që emërhohej e pranueshmë për një moral tjetër. Vetë ai shqetësohej, sepse shpesh i ngjallte njëfarë dyshimi në qëndrimet e pakuptimta ndaj jetës.

Kur e kishte njobur në fillim, i ishte dukur aq e brishtë, sa Migeni, pasi kishte dëgjuar ca gërvishtje të zërit, ishte përplasur me atë vështrim sysh, thuajse të qetë. Ndodhej

nën harkun e dashurisë. Ndoshta kishte ardhur koha të ishte i dashuruar. Vetë Julia, lëvizte mbi ca ëndrra të mistershme e pëshpëriste se tashmë njeriu ishte më pranë ikjes prej vetes. Bota e dashurisë lëshonte mesazhe jashtë njeriut.

- Zoti, na ruajtë nga këto fjalë të pashpresa, - i tha një ditë Migeni.

Po ajo me buzët e plota ngjyrë rozë të lehtë, ishte përgjigjur me gjakftohtësi dhe bindje:

- Mos ki frikë nga vdekja.

Lidhja e frymës njerëzore me frymën e përndritur të botës sajonte histori të vërteta ose të pavërteta, për të qenë brenda kohës dhe hapësirës.

Ai u mbështet mbi krahun e saj të majtë. Ndjeu parfumin e lehtë "Devotion" që i pëlqente shumë. Julia vështroi retë e bardha ulur mbi malin e zhveshur. Qielli i ngjasoi me një grua shtatzënë. Mbrëmja ishte e ftohtë si një copë e ngrirë akulli, të cilën njerëzit me frymën e tyre filluan ta kthenin në një masë të lëvizshme ujore duke pritur të nesërmendielin. Ata të dy endeshin nën shtyrjen e trupave të njëri-tjetrit, bënин ca pyetje nëpër tym nën harkun e akullt dhe hakmerreshin kundër kohës së ftohtë me puthje të nxehtha.

Migeni nuk ishte i sigurtë, nëse ajo e dashuronte. Julia i thoshte, se dy njerëz të dashuruar lidheshin mes tyre me rrahyjet e zemrës. Dashuria nuk ishte si formulat e gjeometrisë, që dikush i kishte zgjidhur me kohë.

- Është fjala për një enigmë të vjetër, - tha ajo mes heshtjes dhe ikjes. Jeta ime ka rrjedhur brenda këtij shekulli. Por njeriu duhet të mendojë për njeriun, sepse lindja dhe vdekja ndodhin vetëm një herë në jetë.

Migeni vështroi sytë e saj të mbërthyer në qerpikët e gjatë. Teksa i mbante në duar gishtat e drejtoi përballë vetes dhe i tha:

- Ti kërkon të shpikësh një histori Julia, të gjesh copëza shprehjesh, për të rindërtuar të kaluarën. - A s'është kjo

një përpjekje e ngatërruar, një frikë, për të mos i besuar së ardhmes? A s'është kjo një lamtumirë e dhimbshme për jetën dhe botën?

Ai në të vërtetë do t'i ndërpriste fjalët, sikur shpirtërat e tyre të mos silleshin nëpër një shkretëtirë, ku nuk mund të kishte përhumbje të dashurisë. Julia i hodhi një vështrim të harruar. Tha sërisht se ishte në rrugëtimin e fundit të kohës. Zërat e të tjerve ia ngatërronin më shumë lëmshin e errët të ikjes së asaj nate pa mbarim.

- Më duket se është e shtunë sot, - pyeti ajo a thua sikur po bënte një pyetje misterioze që kërkonte një përgjigje të çuditshme.

- Po, - iu përgjigj Migeni si i gozhduar, - ndërsa ajo ishte tek pragu i derës.

- Zoti e ndihmoftë, - tha ai, duke u lutur për shpirtin e saj të brengosur.

Mëngjesi lindi i ngarkuar me shi. Dita e fundit e shekullit po mbyllej me kohë të keqe. Pikat e shiut dukej sikur binin me frikë. Lart kishin braktisur hapësirën e pafund dhe lëshoheshin mbi tokën që ngjante si një letër e zhubrosur.

Rryma e ftohtë e ajrit fshikullonte fytyrat e njerëzve. Ata prisnin të ikte dimri sa më parë e të flisnin për dhimbjen e atij viti.

Në ekranin pa ngjyra të televizorit, Julia kishte parë njerëz që arratiseshin. Ata dëgjonin lotët përzier me pikat e shiut. Zërat e tyre humbnin në ikje. Kaq shumë shpirtëra klithnin atë ditë, sa dikush tha se udhëtonin me trishtim nga njëri skaj i botës në tjetrin, sikur të ishin të vdekur. Nga larg kishin parë lindjen e diellit nën shiun e lotëve të tyre. Kthenin pas sytë në tokën e braktisur me hirin e mallit të djegur. Era u thante lotët.

Migeni ishte pasagjeri i fundit i linjës Tiranë-Zyrih. Në qiell u rrëzua një lamtumirë.

ulia, zbriti shkallët e bar “Mumjes”. Zgjati dorën për të takuar stilistin e njohur, të cilin e kishte ndjekur në sfilatën e fundit.

- Të kam pritur, Julia. Desha të di, nëse do të marrësh pjesë në sfilatën time, - i tha ai me një buzëqeshje në buzët e holla.

Ajo e përshëndeti në heshtje. Iu duk se pikërisht tek ajo kafene me emrin “Mumja” të gjithë njerëzit ishin zhytur nën një tym të hirtë e në biseda nga më të pashpjegueshmet. Në fillim kishte qenë një klub rinor, ku mblidheshin më shumë të rinjtë ekstravagantë bashkë me artistët.

Më vonë barin nisën ta frekuentonin një grup fotomodelesh, që silleshin nëpër korridoret e ngushta dhe as nuk u shkonte ndërmend të imagjinonin fantazma rrëth vetes. Ato ishin ca krijesa të brishta, të cilat sillnin një atmosferë festë në lokalini romantik.

Një natë në pjesën më të thellë të barit, drita natyrore ishte zëvendësuar me qirinj të ndezur që sajonin një kthinë. Atje filluan të hynin njerëz të elitës të të gjitha ngjyrave. Thellë gjithçka dukej e zhveshur. Njerëzit përpinqeshin të zbulonin të mirat dhe të këqijat e shtetit, i cili gjithsesi kishte dyert e tij.

Flitej se në një shteg që e njihnin të gjithë, vdekaturi, duke ditur pikat e dobëta të kësaj shtrese shoqërore, mbante ligjérata të mbushura me moskuptime. Nga qëndrimi për

një kohë të gjatë në kryqëzimin e atij vendi jashtë botës, ai vetëm mallkonte ditënaten. Arkitektët e kishin quajtur “Piramidë” ose tempulli i vdekatarit. Një nga modelet e reja dhe një politikan i ri thanë, se ndërhyrja brenda piramidës bëhej, për të ndryshuar të paktën kohën tjetër. Atij njeriu duhej t'i harrohej sa më shpejt emri, që njerëzit të lehtësohen nga imazhi i fantazmës. Debat i ishte i gjatë mes modeleve dhe politikanëve të rinj. Ata nuk ishin më shumë se njëzet e pesë vjeç. Dikush propozoi se nga të gjitha emërtimet, atij tempulli i shkonte emri “Mumje”. Askush nuk u lodh më të gjente ndonjë emër më të shpifur.

- Po, - tha Julia, teksa ulej në ndenjësen e blertë të lokalit të mbushur plot. Ajo e dinte se përballë ekstravagancës së tyre qëndronte plot mllef ngjyrimi i të vdekurit. Shpesh ai ngjante si një njollë, e cila shfaqej në mes të natës me një thikë të përgjakur pas shpine. Modeleve u pëlqente luksi i kafenesë “Mumja”. Për qenien e përhershme aty të vdekatarit, as që donin t'ia dinin. Ato nuk kishin dashur të dëgjonin për hije e fantazma që silleshin rrëth botës. Si një e fshehtë ruhej, për të mos u mësuar nga të tjerët, gjithçka dukej sikur ishte harruar. Dikush thoshte si rastësisht se vdekatarit do të ishte e vështirë t'i harrohej emri dhe bëmat. Në shtegun e kryqëzuar nga drita e qirinjve, ku shfaqej hija, pasdite një grua shtatzënë kishte parë një masë të ngrirë. Për të mos prishur festën, i la modelet bashkë me politikanët të pinin xhin dhe uiski. Pastaj grua u sul në mes të sallës. Me zë të lartë i siguroi të gjithë, se kishte vërejtur një zvarranik të lëshohej në shtegun, ku shfaqej herë pas here fantazma. Nuk kishte dyshim se kjo ishte e vërtetë. Askush nuk u habit, jo vetëm për ato që dëgjoi nga goja e gruas së lemerisur, por as nga kthimi i vdekatarit në një qenie tjetër.

Julia dëgjoi një rënkim si prej një njeriu të sëmurë. Dalloj në kryqëzimin e dobët të drivate një hije që brenda syve ishte shuar pa nam e pa nishan. Ajo tha e para, se kishte

ardhur koha që fantazma e tij të mos i shfaqej asnjë njeriu. Të gjithë u lutën të ndodhët diçka e tillë, e më pas kishin përplasur gotat me uiski.

Djemtë ekstravagantë që hynin e dilnin në kafene, bënин gjetje nga më të ndryshmet duke sajuar barcaleta. Kureshtarët me t'i marrë vesh, i ftonin nëpër tryeza e shkriheshin gazit me këto sajesa. Një kineast dokumentarësh tha se, vdekatari ende kishte rrëth e rrotull skllevër të rinj që megjithëse nuk dinin të bënин aspak politikë të mirëfilltë, u kishte marrë Zoti mendjen, të përrallisnin gjithë ditën për ngjarje politike e të mos i besonin as vdekjes së tij.

Edhe kur vdekatari fliste, askujt nuk i shkonte ndërmend se ulërima e tij përhapej nga ai shteg i kafene "Mumjes" deri në luleboret. Më në fund zëri shkundej pranë dallgëve të detit.

Gruaja shtatzënë e mbaroi frazën me pyetjen, se si ishte e mundur që një qenie e tillë i përngjiste jo një krijese njerëzore, por një lloj gjitari, i cili dukej sikur bënte striptizëm?

- Është një përcudnim i padëgjuar, - tha përsëri gruaja dhe njoftoi se priste të lindte binjakë.

Kur ajo largohej duke u lëkundur, Julia vuri re gjithë ata njerëz, të fshehur nën tymin gri të cigareve. Ishte mirë të ngrihej.

Në parahomë më shumë shquheshin dritëhijet. Fytyrat e njerëzve lëviznin pas një xhami të vizatuar me petale lulesh të ftohta, gdhendur në stinët e ikura. Julia u ngrit, kur dikush i thirri në emër nga kthina me dritë të kaltër qiriri. Ajo shkëmbue një shikim të paqartë. Shtyu derën e errët. Doli në rrugë. Qepenat e hirta të dyqaneve rrëzonin hijen e tyre mbi gjoksin e qytetit që dukej gati pa frymëmarrje. Ora kishte shkuar nëntë e gjysmë, kur u kujtua se duhej të ndiqte një leksion të estetikës për tragjiken dhe

të bukurën. Jeta e përditshme ishte kthyer në një monotonji pa ngjyrë, pa asgjë të re. Ajo iu shhang idesë se gjithçka për të kishte marrë arratinë. Vërtitej krejt e veçuar në një botë plot dyshime. Kohës i dukej se i mungonte guximi për të ndryshuar. Endej si grua e përdhunuar në atë qytet, ku merreshin nëpër gojë të mirat dhe të këqijat e botës. Njerëzit zgjidhnin të keqen më të vogël, duke mallkuar vetveten. Mendoi se gjysmë shekulli më pas në ato histori të mistershme kishte disa hollësi që një Zot e dinte, pse njerëzit sajonin varrosje e zhvarrosje për të zbuluar kohën e ikur. Shumë gjëra kishin ndryshuar. Julia si në një ekran ku lëviznin figura të akullta që përcillnin imazhe të shuara, u kujtua se kishte hyrë në shekullin e ri, po aq sa ishte jashtë tij.

Ndjeu një zë që e përshëndeti. Ktheu kokën në anën tjetër, por nuk e njohu. Zëri humbi andej nga erdhia.

Hyri në dhomë. U përpoq të qetësohej. Hapi dritaren. Rryma e ajrit i preku frymëmarrjen. Iu duk se dikush po e përkëdhelte. Angjelina i ngjau me një njollë të kthjellët prej qelqi. Ishte përpjekur ta mbushte jetën e saj vetëm me hijen. Ajo qe shembëlltyrë e barabartë me veten. Me mijëra herë besonte se ikja e kohës thuajse çdo ditë ishte vetëm një mesazh i shurdhër, të cilën nuk e dëgjonte askush. Një hapësirë e mbetur midis kohës së ikur dhe kohës tjetër, kishte qenë pjesa më e ndjeshme që nuk i shqitej nga mendja.

Të nesërmen ngrohtësia e rrezeve i prekte trupin, duke i fishkellyer me një zë të ri. Ajo sikur të kishte jetuar një shekull i gëzohej atij shpirti të mirë diellor që ndriçonte botën.

- Oh, lavdi Zotit! Vetëm perëndia e diellit e ngroh këtë tokë. Vetëm ajo nuk na ka braktisur, - thirri me një zë fëmije.

*A*snjëherë nuk i kishte pëlqyer të binte në sy. Fillimi i ditëve dhe fundi i netëve largohej nëpër kujtimet e mbeturës ca trajta lutjesh. Një zë që e afronte pas vetes vinte e zhdukej si një vegim, për t'i kujtuar se jeta dhe bota duheshin jetuar duke u mbajtur tek vjetvetja. Edhe tani që ishte në moshën e bardhë, nuk e dinte pse atë moshë gjyshja Angjelina e quante kështu, pranoi se nuk kishte arritur ta zotëronte kohën. Ishte një shpirt i braktisur në një skaj të harruar të botës.

- Jo aspak, - ti je një shpirt i mirë i thoshte Angjelina. - Mendo se në këtë botë ti nuk ke mbetur vetëm dhe as je një krijesë pa histori. Çdo njeri ka historinë e vet. Angjelina afrohej për ta përqafuar. Në ato çaste të rralla i dukej se Julia, sado pak, ia largonte vuajtjet duke i zgjuar një ndjenjë të mirë për botën.

Të shtunën, flinte më shumë se ditët e tjera të ngarkuara me leksione. U ngrit rreth orës tetë. Piu ngadalë qumështin e ngrrohtë me pak kakao. Ishte në mëdyshje t'i bënte telefon Migenit, apo të dëgjonte ngjarjen e çuditshme të shpifur nga Arli, i cili e kishte besuar si një përrallë të vërtetë mesnatën e kaluar mes miqve të tij.

- Po, po, është një "sajesë" e vërtetë, aspak një trillim, - i kishte thënë ai të gjithë miqve të njojur e të panjohur, kur e kishin pyetur për vërtetësinë e ngjarjes. Sipas politikanit më të ri të shtetit, përralla ishte shpikur nga

politikanë më të vjetër. Ata përveç fantazisë së pashembullt dinin të bënин tё besueshme vetëm një pjesë tё shpifjes. Në fillim e besuan më shumë gazetarët e rinj pa përvojë dhe vajzat bukuroshe, që i silleshin rrrotull atij politikani të ri, i cili kishte maninë tё gjente sa më shumë adhurues. Më tё pafajshëm ishin adoleshentët. Ata përpinqeshin tё tregoheshin me edukatë. Madje nuk donin t'ia dinin aspak pёr shpifje tё këtij lloji. Pranonin se historia ishte e pafajshme. Fajtorë ishin njerëzit që nuk dinin tё bënин historinë.

- Politika hiqet si një prostitutë e "virgjér", - kishte thënë një pesëmbëdhjetë vjeçare, para se Arli tё tregonte sajesën më tё re tё ditës. E shkuara sipas politikanëve tё vjetër ishte gati e barabartë me tё tashmen. Askush nuk ishte përgjigjur pёr atë "shpifje". Njerëzit e kishin marrë thjesht pёr ndonjë lajthitje tё radhës.

- Punë muti, - janë këto bëma tё sajuara dërdëllisnin adoleshentët. Ata puthnin tё dashurat që nganjëherë ishin shpirtvogla, por ama tё ndezura.

Julia i urrente debatet pёr politikën. Ajo pëlqente më tepër, tё vizitonte kopshtin zoologjik, se sa tё dëgjonte nён tumin e përhirtë kundërshtarët politikë që ngatërröheshin mes tyre.

Më duket se këta njerëz janë tё lidhur më shumë me veten, se sa me premtimet që marrin para historisë njerëzore, kishte thënë një ditë Migeni. Julia i ishte përgjigjur se nuk ishte optimiste, madje ndjehej e zhgënjyer pёr tё kuptuar vizionin e tyre tё mangët.

Në mes tё ditës ia kishte dhënë truri, një gazetari anonim, tё shkruante nëpër mure nё një sfond kuq e blu sharje tё ndyra, pёr tё ndaluar debatet mes grupimeve tё pozitës dhe opozitës.

- Ju qi... nënën, pёr mendjet tuaja tё dhjera... P. M.

Duhet të largohem prej këtej mendoi me vete Julia duke parë nga xhami siluetën e Arlit nën shiun e ftohtë të atij fund dhjetori. Ajo mendoi se ai do të futej për pak minuta brenda në kafene. Kur shtyu derën e xhamtë të bar "Mumjes", Arli, e kapi prej supesh. E ftoi të shkonin diku tjetër për të pirë një kafe.

- Më duhet ta harroj këtë qoshe të molepsur, - tha ai dhe hapi derën e makinës "Benz" të zi me perde blu. Ishte bërë e modës që politikanët bënin sikur adhuronin bukuroshet e reja, të cilat i shihnin me dyshim lidhjet e tyre. Tregonin madje se ata aq shumë ishin lidhur me idenë për të pasur të dashura, sa ngatërronin fustanet e grave të veta me trupat e zhveshur të të dashurave. U bënin atyre dhurata të shtrenjta. I çonin nëpër motele të largëta, harroheshin pas bukurisë së përkohshme, pastaj i braktisin.

Julias iu duk se po përjetonte një melodramë që përsëritez herë pas here. Ai ende mbante në dorë dhuratën e Krishtlindjes, një veshje të mbështjellë me një celofan të kuqërrëmtë që sipas tij përbënte zanafilën e festës. Ajo as që ia hodhi sytë, madje iu dukën të papëlqyeshme. Do kishte dashur, që Arli, të cilin e njihte fare pak, t'i kishte dhuruar lule. Por koha bënte të vetën. Të dashurat merrnin dhurata më të shtrenjta se sa gratë, të cilat megjithatë dinin të zbulonin edhe të fshehtat.

Sipas Angjelinës çdo burrë e kishte një grua tepër në kohët e sotme. Kjo ishte kthyer në një sjellje që sipas burrave nuk prekte moralin. Ajo po hutonte edhe burrat e shtetit, të cilët gjithashtu kishin shijuar në trupat e grave të njëjtën ngjyrë joshëse që u zhbllokonte ndjenjat intime.

- Të them të drejtën, nuk para më shkon ngjyra e kuqe, - i kishte thënë Julia atë çast Arlit. - Më duket vetja një genie tjetër, ndoshta si diçka jashtë vetes.

- Çudi, - i ishte përgjigjur ai. Nga jashtë dukesh romantike dhe sensuale, por qenka krejt e kundërtat.

Megjithatë mua më pëlqeijnë vajzat që fshehin diçka. Ndonjëherë ajo i kishte lénë përshtypjen e një tipi të brishtë. Kur e kishte parë në fillim tek bar “Mumja” nuk dinte pse i ishte dukur e mëshirshme. E ndjente larg si të ishte një flu e paarritshme. Vetëm se ajo kishte një bukur marramendëse. Të gjithë jetonin me sytë e saj, sikur të jetonin me një botë të largët që e shihnin fare afër.

Julia nuk e pa të nesërmen siluetën e tij në cepin e drítësimit të butë, lyer me driten e qirinjve dhe as në portën e Akademisë së Arteve të Bukura, ku e kishte pritur më parë.

Ai disa herë kishte ca sjellje të mbrapshta para njerëzve, sa Julias i duhej të mbante frymën për ta kuptuar. Dikur kishte hequr dorë nga shkencat humane. I kishte quajtur shkenca të sémundjeve botërore dhe nuk ishte i dhënë pas tyre. Më vonë familja e kishte shtyrë të ndiqte shkencat politike.

- Ndoshta, do të mësojë të vetëpërbahet, - i kishte thënë e ëma të atit, mëngjesin e parë të tectorit, kur Arli iu kishte folur për një leksion që kishte lidhje me identifikimin njerëzor.


Prindërve u ishte dukur se vetëm atëhere, ai kishte ndryshuar. Dalëngadalë filloi t'i largohej së kaluarës. Nuk ishte më i shtyrë për flirte dashurie, të cilat i cilësonte si ngjarje të rastit ose aventura që u ndodhnin të gjithëve.

**J**ulia tek vështronte muret e mistershme, ku të gjithë përfytyronin lloj-lloj historish, kishte njojur rastësisht Arlin. Ai i kishte treguar se sapo ishte arratisur nga një dashuri, e cila kishte qenë thjesht një aventurë që nuk i kishte depërtuar aspak në qenie, por vetëm ishte shfaqur kalimthi. Julia nuk kishte menduar ndonjëherë se rrugët e dashurisë ishin të ngushta. Për të justifikuar këtë, Arli donte t'i mbushte mendjen se nuk shkonte me vajza të çfarëdollojshme. Sipas mendimit të të tjerëve kjo nuk ishte asgjë, veçse një aventurë e rëndomtë.

Julia nuk u takua me Arlin gati dy muaj. Kishte mbetur e habitur, pse i rrëfente historitë e tij për të tjerët. Dukej se ai, kur tregonte të kaluarën hakmerrej kundër saj.

- Më pengon të ardhmen, - i ishte përgjigjur Arli. Dua ta harroj. Fytyra e tij shpesh kishte një shprehje që nuk e kuptonte lehtaz. I duhej të lodhej për ta kuptuar.

- Ai mendon ndryshe nga të tjerët për dashurinë, - i kishte thënë një ditë Ada, shoqja e saj e kursit. - Por njeriu mund të gjejë mënyra komunikimi, pse jo përvoja të ndryshme. Arli ka një botë tjetër, - kishte ngulur këmbë Ada. - Flet me ty, fare hapur duke menduar se ka para vetes një qenie të njëjtë me veten. Në të vërtetë, unë mendoj se njeriu një ditë mund të jetojë dhe pa të kaluarën e tij. Ai e harron në një cep të jetës, madje as kujtohet më për atë humbje.



- Më duket se e kaluara, le gjurmë në jetën e njerëzve, por e nëpërkëmb edhe të ardhmen , -ia ktheu Julia. - Si mund të ndodhë të jetosh brenda dy kohëve?

- Eshtë e vërtetë, - vazhdoi Ada. - Vetëm se më vonë ajo nuk është më e tejdukshme, madje në situata të ndyshme, thyhet ose vdes. Kjo ka ndodhur në të gjitha kohët.

- Nga e kaluara nuk vjen e keqja, - i kishte përsëritur një mbrëmje Angjelina. - Thjesht ajo mund të kthehet në një kohë kujtimesh që e shtyn njeriun drejt së mirës.

Arli ishte shfaqur pas derës së xhamtë të lokalit. Julia e pa si u ul sërisht në cepin e dritës së holluar të qirinjve. E ftoi të shkonin në tryezën e tij. Me sy iu lut të rrinin pak kohë bashkë, ndërsa ajo ktheu kokën nga hyrja.

- Kam një surprizë për ty Julia , - i tha pranë veshit duke e puthur lehtë në buzë.

- Sinqerisht je ndryshe Julia. Më beso. Ti nuk je si të tjerat. Të betohem.

Ajo kujtoi se niveli i tij shoqëror, me atë pamje tërheqëse e ndihmonin të hidhte sytë gjithkund, për të fituar. Julia, e cila e njinte fare pak Arlin, tek dëgjoi ato fjalë, pshëretiu nga vështrimi shpërthyes. Dyshoi se në sytë e tij shkrepit një stuhi dëshirash. Nuk dinte pse bar «Mumja» ishte e ndriçuar vetëm nga qirinjtë e përzier me reflekse gri. Disa herë ngjante i errët, ndoshta jo vetëm për shkak të mungesës së dritës, por edhe nga labirintet e shtrembëra që të ngacmonin shpirtin.

- Jam i marrosurr pas teje Julia, qysh në sfilatën e fundit, - iu drejtua ai duke i hedhur një vështrim përvëlues.

- Faleminderit, - ia ktheu Julia. - Ndjehem mirë, kur të tjerët më bëjnë komplimenta.

Ajo pati përshtypjen se ai po e vështronte me një shikim të pushtetshëm, sikur të kishte para vetes hijen e tij. Vështroi me ëndje si e përhumbur sytë e ndezur nga sensualiteti. Hapësira dhe koha u fshinë nga ai vështrim,

ngulur në dekoltenë kafe të bluzës lino që i rrinte puthitur pas gjoksit të fryrë. Arlit i cingëriu zilja e telefonit. U përgjigj shkurt. - Shihemi më vonë. - Zëri nga ana tjetër lutej për më shumë fjalë, por ai e mbylli telefonin.

- Ti je një mrekulli Julia. Unë po kërkoj një shpirt, - vazhdoi ai me ngulm, - madje duhet ta dish se jam i zoti ta fitoj atë që dua.

Julia kishte heshtur. Jashtë shiu binte shtruar dhe njomte tokën e përtharë që ngjante si një e dehur. Koha kishte filluar të hynte në aventurat e veta. Njerëzit ishin të lodhur nga vapa që kishte nisur qysh në ditët e para të majit.

- Më falni, - iu drejtua me maturi Julia. - Sot më duhet të shkoj në një ceremoni varrimi. Ka vdekur një grua e re. Dje në mëngjes kam lexuar afishen e vdekjes së saj. Më vjen keq. Ka shumë kohë që shoqëroj kufomat e të ikurve ngajeta. Eshtë diçka njerëzore. Ndoshta edhe në vdekjen time do të ketë shumë njerëz që do të më përcjellin në banesën e fundit.

- Çfarë, çfarë, - e pyeti ai krejt i çuditur. - Shkon për të shoqëruar të vdekurit në varreza? - Mos jeni e marrë? Një vajzë kaq e bukur, një fotomodele, një aktore të ketë një hobi të tillë? Oh, Zot... Mos më thuaj të tilla fjalë!

Julia nuk ishte më aty. Po fliste me ajrin dhe hijen e mbetur.

Arlit i ngjau me një shembëlltyrë murgeshe të trishtuar. Brenda saj shfaqej një bukuri e tejpushme dhe një sjellje e çuditshme. Mbeti i ngrirë. Ajo ecte nën rrëkezat e shiut, sikur t'i përkiste një bote tjetër. E ndoqi pas imazhin e saj duke mbajtur fryshtë. Nga larg trupi i hollë i Julias i ngjau me pikat e shiut të majit. Nuk mundi të kuptonte asgjë. U çudit si ajo kishte gjetur atë lidhje të mistershme për të përcjellë kujtimin e jetës. Mund të jetë një nënshtrim i vetes, mendoi Arli. Një botë e trishtë ka lindur një pjellë të trishtuar.

Natën deri vonë, ai nuk vuri gjumë në sy. I shfaqeshin fantazmat e njerëzve të njojur e të panjohur që luteshin për pak dashuri. Për një çast dyshoi se Julia nuk ishte normale. Ndoshëta ka shenja të çmendurisë. Ndonjëherë njeriu, del jashtë vetes.

Julia u ndie e lehtësuar, kur pushoi shiu. Iu duk vetja larg atij njeriu. Zëri i tij i vinte si nga një ëndërr. Hyri në derën e hapur të dhomës së bardhë, ku varej një fotografi e gruas së vdekur. Ajo kishte mbyllur sytë përgjithmonë një mbrëmje më parë, pa e shikuar ftyrën e ditës së re.

Gruaja kishte lënë pas pjesën e jetës së gjallë, ose atë që quhej e kaluara. Ishte shndërruar në një kujtim. Julia ngushëlloi me një ulje të kokës njerëzit që rrëthonin kufomën dhe vuri mbi arkmortin e saj trëndafilë të bardhë.

Në orët e fundit të pasdites, Julia mendoi për vdekjen. Besoi dhimbshëm se koha e ikur tashmë kishte vdekur bashkë me të nesërmen e asaj gruaje. Por gjithsesi kishte një shteg që e lidhët me të kaluarën. Njeriu nuk mund të jetë në këtë botë pa jetën dhe vdekjen e tij. Ato shtegtonin njëra pas tjetrës në udhën e fatit. Pra, gjithçka i përngjiste një enciklopedie të lidhur me kujtesën dhe ekzistencën që bashkonte fletën e hapur të jetës me fletën e fundit. Atje lidhej fryma e lutjeve. Megjithatë Julia nuk kishte frikë as ngajeta, as nga vdekja. Njeriu i mbartte me vete jetën dhe vdekjen. Shkoi të flinte pas asaj dite të zymtë.

U zgjua rreth orës gjashtë. I pëlqente të zgjohet herët në mëngjes, sapo dëgjonte hapat e Angjelinës që ngrihet kur lindte dielli. Shtëpia kundërmonte nga aroma e kekut me lajthi të pjekura dhe çajit të malit. I tregoi se kishte përcjellë në varreza kufomën e një gruaje. U mbështet në gjoksin e saj dhe e puthi.

- Më duket se kam në shpirt gjithë botën, kur jam me ty,  
- i tha Julia duke u shtrënguar pas saj.



ysh kur ishin larguar prindërit në Amerikë, ajo ndjehej e lidhur me Angjelinën si të ishte një engjëll i njëmend që e mbante gjallë, për të kapërcyer kohën e ndarë. Julia buzëqeshi e lehtësuar, kur Angjelina i tha, se ajo ishte një kriesë që kishte ngjashmëri me shpirtin e jetës. Gishtat i dridheshin lehtë. Në thellësi mbante dhimbjen e kahershme që nuk i fshihej nga kujtesa.

Jashtë frynte erë. Dita po mbulohej dalëngadalë nga nata. Tashmë qe shkëputur nga ajo botë, ku gruaja i mbeti si një dhimbje e re në shpirt. Iu duk se kishte një shekull që nuk kishte vënë gjumë në sy. Mezi hëngri një copë kek dhe një portokall. U shtri në shtrat e zbuluar.

Në dhomën e gjumit të prindërve, e cila tashmë ishte e rrëthuar nga të katër anët me heshtje, secili kishte një jetë të mbetur që përgjonte ndoshta shpirtin e nisur në gjithësi. Julia nuk u ndje e braktisur, kur ata emigruan në Amerikë. Vendosi të qëndronte me Angjelinën, sepse bota e tyre ishte aty ku luteshin paraardhësit.

Julias i kujtoheshin sytë e përlotur të së ëmës dhe ngutja e të atit që mezi e përbante veten, para se të udhëtonte pas mesnate me linjën ajrore Albania - Airlines. Ishte mëngjes kur ata ikën. Atëhere Julia ishte njojur me Arlin. Zemrat nuk mund të ndaheshin në dy botë.

- Ik, - i kishte thënë ai, por ajo nuk mund të kërkonte pas dashurisë, hijen e tij të largët. Vëllai i vogël Kristi që

kishte lindur para dymbëdhjetë vjetësh, kërkonte koleksionin e fotografive të familjes. Ai mezi priste të fluturonte me aeroplan. Julias i dukej se flisnin zërat e tyre **të mbetur nëpër cepat e dhomave. Ndiente zërin e zemrës si thërrmohej, ashtu siç shuheshin yjet në botën e largët.**

Ajo dëgjoi për herë të fundit këmbanat që lëshonin ca tinguj si të mijëra shpirtërave. Iu duk, se ishte e përqafuar nga ëndrrat që mbushnin me dashuri botën e saj të vogël. Në mesnatë zilja e telefonit binte pa ndërprerje. Me sy të myllur mori receptorin. Nga ana tjetër dëgjoi zërin e Arlit.

- **Më pëlqen të bëj dashuri me ty, Julia. Jeta është kujtim i dashurive dhe jo i vdekjeve. Unë kam frikë nga vdekja, madje e urrej atë. Të lutem eja. Nuk më pëlqen të rendësh pas vdekjeve.**

Julia nënqeshi me zor. Uli dorezën e telefonit. Sytë i kishte të ngrirë e të palëvizshëm. Ndezi një qiri për shpirtin e gruas së vdekur. Nuk e kuptoi pse iu shfaq pamja e "Mumjes" që përtypte kokrrat e kafesë së zezë.

**U zgjua e trembur. I erdhi në mendje ftyra e Arlit dhe** sytë e ndezur për dashuri. Me flokët e prerë shkurt nën vështrimin e hirtë, veshur me pantallona xhins firmato e me këmishë gri i ishte mbushur mendja se e adhuronte deri në marrëzi Julian.

Atë mbrëmje ajo i kishte thënë, se dashuritë nuk mund të numërohen si lodrat e fëmijëve, kur nuk kishin qenë dashuri të vërteta.

- Ato janë përvoja të dashurive të humbura, - i ishte përgjigjur Arli.

- Gjithsesi mendoj sejeta në periudhën më të bukur kërkon diçka të re. Disa herë njeriu kumton mesazhe që i ngajnjë fabulave.

Julia ia kishte ndier gjunjët t'i ngjiteshin pas gjunjëve të saj. U ngrit. Vështroi përtetje drifte së veshur nga avulli, refleksin e "Mumjes" dhe ca qen të lodhur që përballonin

natën e ftohtë. Të dashuruarit strukeshin midis pemëve të zhveshura. Prisnin ardhjen e stinës së gjelbërt, ku gjithçka bulonte mbi tokë. Ishte në mëdyshje të ikte, apo të qëndronë përballë tundimit të tij. Thellë në shpirt besonte

**se dashuria ishte endërr. Sidoqoftë nuk i pëlgente të ishte një zemër, kur dikush kërkonte të bënte prova dashurie.**

Ndonjëherë jeta i përngjante një anijeje. Atje secili nuk shihte endrra mbi tokë, por nën një qiell të hapur. Dikur kishte përjetuar një dashuri pa lamtumirë. Dy duar zgjateshin e fshiheshin nën dritën e trupit.

- Me ty, po më ndodh krejt ndryshe nga dashuritë e shkuara, - i tha Arli. Pastaj e kapi nga krahu. - Unë jam sot adhuruesi yt. Të dashuroj sa një jetë.

Ajo mezi priste të ndizej një yll. Nëpër zjarrin që rrokullisej brenda qenies po ndodhë magjia. Julia kishte arritur ta bindte veten, se asnjëherë nuk ishte mundur në duel me jetën. Madje, kurrë nuk kishte pranuar të ishte hija e saj. E kishte kuptuar këtë qysh kur ishte shtatëmbëdhjetë vjeç. Atëherë kur përmbyllte hartimin për mrekullinë dhe dëshpërimin, ajo shkruajti se njeriu jetonte brenda dashurisë.

- Jo, sipas meje dashuria është një përndezje e vetvetishme e shpirtit, - tha Arli atë mbrëmje. - Ajo nuk është një shndërrim i realitetit në përjetësi.

- Këto janë fjälë e fantazi të nxjerra nga librat, - iu përgjigji Julia. - Dashuria është një sprovë, ku njeriu duhet të ndihet i lumtur.

- Më duket se ka kaluar koha e teorive, - mërmëriti ai ca fjalë që Julias i mbetën në mendje. - Njerëzimi po vuani nga fantazitë e veta, pse jo nga endërrimet e veta.

Julia mendoi se Arli po jetonte nën ndriçimin e një drite që sipas tij ishte drita e yllit të fatit.

Të nesërmën kishte provimin e estetikës. Kërkoi të largohej, por ai nuk e lejoi. Iu lut të qëndronin dhe pak kohë së bashku.

Lékura e saj qumështore e ndizte më shumë se ajo etje për të pasur të gjithë trupin e saj brenda vetes. Atje thellë bota kishte mësuar të dilte nga heshtja.

- Po zgjohem nga një ëndërr e bukur, nga e cila nuk më pëlqen të zgjohem, - tha ai duke përkëdhelur lëkurën e saj. Julia u ngrit.

- Më duhet të gjej pjesën e fshehur të kohës së përhumbur, - tha ajo. Nga larg Arli vështroi trupin e saj të veshur nga misteri i erës.

Dukeshin sikur të fshehtat e saj dorëzoheshin brenda genieve njerëzore, aty ku ishtejeta dhe vdekja, e pamundura dhe marramendja.

Arli u ndje i vetëm, kur nuk e pa më trupin e Julias. Ndoshta asnjëherë nuk e kishte mbytur vëtmia sa atë natë të gjatë, që i rrëshqiste para syve. Vetëm kur dita filloj rrugëtimin e përhershëm, kujtoi se ishte zgjuar.

- Natyrisht është ditë, - tha ai duke lëshuar makthin në ajër. Ishte ende i pasigurtë, se si kishte lindur ajo dashuri. Ndoshta, sepse nuk ishte e njëllojtë me lidhjet e para. Një forcë që i kishte ndryshuar kohën e tërhiqte më shumë se sa e kishte tërhequr e kaluara. Lindja dhe shembja e aventurave e kishin prekur si shumë të tjerë. Nuk kishte ndodhur ndonjë magjepsje apo marrëzi dobësie, por një dridhje shpirtërore që arrinte cakun e trupëzimit të munguar të shpirtrave. Vetëjeta ishte një aventurë.

Kur hyri në zyrë, një dridhmë i përshkoi zërin. Dosjet e përditshme i kishte larguar nga tavolina. I përsëriti vetes, se do të gjente arsyen të shpjegohej më vonë për atë çka po i ndodhë me Julian. Ndjeu zhurmën e qytetit, i cili notonte në pluhurin e rëndë të trafikut që ngrihej përpjetë në qill. Sapo kishte mbaruar masterin për mbrojtjen e mjedisit në Zvicër. Asnjëherë nuk kishte menduar se do të gjendej një ditë në karrigen e zëvendës ministrit. Ishte lidhur me

grupin më të madh partiak. Atje kishte dëgjuar sa herë fjalët, se duhet t'u shërbente njerëzve dhe vendit të tij. Në fillim nuk i dalloj ditët e pritjes me grevat e qeta të studentëve për hapësirat e natyrës që po zhdukeshin. Njerëzit e zvarrisnin fryshtat e tyre tek pritja e gjatë në këmbët e semaforëve, ku paqja dhe natyra ishin në konflikt me qetësinë. Ajo kishte ngritur gishtin e madh duke mallkuar ambientalistët, të cilët dëgjonin rënkitmet e ngrata nën pluhur.

Miqtë e tij e kishin pritur më kërshéri zgjedhjen e Arlit në atë post. Vetë ai që besonte se ishte një njeri i dhënë pas punës dhe detyrës e kishte quajtur një privilegi. I pari që besoi se ai ishte një njeri i zotit, që ish-ministri i mëparshëm. Ai e kishte njobur kur ishte profesor në fakultetin e inxhinierisë së mjedisit. Arli qeshte kur kujtonte se njerëzit harroheshin pas tituve me ish-et, apo lidhjeve krejt të pakuptimta që fashiteshin bashkë me ikjen e tyre.

- Është fatkeqësi të kthehesh në një ish- i kujtohej diku shprehja e hershme.

Ai ka filluar të ndahet nga vetja, mendoi Julia duke marrë fryshtë nën ajrin e hirtë të mëngjesit. Në udhë rrëzoheshin rrezet e holla të diellit dimëror që përkuleshin thellë deri në dhimbjet e mbartura të ditës. Njerëzit zgjoheshin të nesërmen për të mos e humbur ditën. Ata ndjenin si ujërat rrethuese të shpirtit njerëzor depërtionin nën të përditshmen. Çuditërisht i dukej se emocionet e një nate më parë e sulmonin në thellësi të trupit. Mbylli një çast sytë. E la veten të binte në qetësi. Një rrymë e vvetvetishme që i vinte nga një botë tjetër i dukej se po e kapërtihente rrëth ndjenjave të ndryshimit. Kisha ndodhur vetëm një ditë më parë. Kur kishin bashkuar trupat e tyre, gjithçka ishte shkrirë në atë formë që ekzistonte. Diçka e njëjtë si të ishin të uritur e të ushqeheshin me fryshtat e secilit, për të provuar ndjenjën e të gjithë qenies. U përpoq të ishte e

vëmendshme, sepse tmerrohej kur nuk dinte ta mbronte veten. Iu kujtua Migeni, i cili e kishte braktisur pa kuptuar asgjë nga bota e saj. Nuk e kuptoi pse meditoi të kaluarën. Humbiste në mendime të largëta, kur besonte se qysh herët i pëlqente tragjikja. Madje e kishte përshëndetur profesorin e estetikës që e vlerësonte tragjiken në gjininë e së bukurës.

Migeni e kundërshtonte dëshirën e saj për të barazuar tragjiken me të bukurën. Sipas tij ato nuk kishin një forcë të njëjtë. Ishin dy fuqi të kundërta që të tërhiqnin pas vetes. Pikërisht jashtë njëra-tjetrës ishin të ndara dhe të bashkuara. Julia disa herë ishte përpjekur ta braktiste të kaluarën. Sipas estetëve evoluimi ndodhte në të ardhmen.

Shpesh në trajtën e diçkaje të errët që i shfaqeji jashtë vetes, dikush vraponte të gjente ditën, për t'u larguar nga terri dhe nga shembelltyrat që vijonin të gjenin lidhjet e saj të brendshme.

- A thua edhe harrimi ishte një përcaktim i bukur? I ishte shkrirë njëherazi në mendje ideja se depërtimi i së bukurës tek tragjikja nuk kishte pozicion të njëllotë, sepse tragjikja përfshinte edhe vdekjen. Në mendësinë e saj vdekja ekzistonte si diçka e bukur.

- Ti ke probleme me përfytyrimet dhe vetëdijken, - i kishte thënë Migeni në një natë të lagësht. Ai nuk e ndjeu veten fajtor. Qysh atë ditë i tha, se ajo mund të bëhej një murgeschë e zellshme, për të ndryshuar të bukurën dhe tragjiken. Julia besonte se do të ikte në atë botë krejt papritur, ashtu siç ikte edhejeta drejt fundit të panjohur.

Atë natë, kur e braktisi, Migeni ndjehej i mposhtur nga idetë e shndërrimit në vdekje.

- Ai iku, sepse kishte frikë nga vdekja, - e ngushëlloi veten Julia. Vendosi ta harrojë historinë e dashurisë me Migenin. Ajo tashmë nuk ekzistonte. Kishte vdekur dikur. Shpesh e pyeste veten për atë ide të zymtë apo të egër që imagjinonte se do ta ndante ngajeta.

Vetëm për një çast. Pastaj kishte menduar të bashkohej me vdekjen. Askush nuk i kishte thënë se vuante nga ndonjë sëmundje. Vetëm ndjente se jeta po i largohej.

Eshtë një fantazi dhe asgjë më tepër, - i kishte thënë Angjelina një mbrëmje vonë.

- Zot, përse më duhet të gjej iluzione? - Jeta është një himn i shenjtë që ka një fillim dhe një fund. Në qendër të saj duhet të mbretërojë lumturia, jo vuajtja. Ajo ndieu një dhimbje në gjoks. Hodhi në shpinë çantën e lëkurtë. Hapat e ndaluan në sheshin e zhurmshëm, ku shfaqeshin fytyra që i ishin dorëzuar shuarjes. Lexoi kronikën e vdekjes së tyre. I erdhi keq. Ata do të iknin nesër nga kjo botë, për të shkuar në një skutë të errët e të lagësht, ku shuhei vetëm trupi, por jo frymëmarrja e kujtimeve.

Nuk dinte pse mendimi i ishte ngulitur si shigjetë. Jo pse nga ikja në atë botë vinte ankthi i humbjes, por sepse njerëzit ndjeheshin të pushtuar nga frika e saj.

Dita ishte ngjitur pas shiut. Lindja e kohës së mirë ishte disi larg. Në mesnatë u shpif një stuhi gulçuese. Qelqet e përgjumta të dritareve u drodhën në ajër. U ngrit ngadalë. Pa nga lart qiellin e errët të braktisur nga yjet duke u fshehur, siç fshihite një grua fytyrën. Nuk dinte çfarë e shtyu të merrte estetikën. Lexoi faqet e fundit dhe u çlirua nga shtrëngimi i stuhisë, që ia ngulte gishtërinjtë tokës. Shkuma e bardhë e shiut u shkri vetëm në mëngjes. Qielli mori sërisht ngjyrën blu të pjekur.

Piu e vetme kafenë me qumësht që i përgatiste Angjelina. Mbylli pa zhurmë portën e jashtme. Hyri në sallën e madhe me tavolina të zhgarravitura, ku të gjithë ishin të bindur para vetes. Diku jashtë dritares iu shfaq gjysmë hija e Arlit, i cili e priste në sedilen e pasme të makinës.

- Unë nuk kam bërë asnjë mëkat, - mendoi, kur profesori hijerëndë i estetikës hyri në sallën e provimit. Ishte i sigurtë se njeriu përderisa kishte brenda vetes disa lloj

dashurish, qoftë edhe për luleboret, nuk kishte pse të mos e pranonte vdekjen si një formë tragjike që i mungonte elementi i së bukurës. Kishte dëgjuar se shumë njerëz që nga parahistoria e kishin marrë vdekjen në sy. Ajo nuk ishte një fjalë e pamatshme, por një përkulje para jetës. Njerëzit i kapte një trishtim i thellë kur përfytyronin fundin e tyre.

- Vdekja nuk është gjëja më e keqe në këtë botë, - kishte thënë një natë Angjelina. Ka dhe gjëra të tjera më të tmerrshme, ndaj duhet ta respektojmë atë. Edhe vdekja ka dinjitetin e vet tek njeriu.

Julia ishte ulur në perëndim të sallës së madhe. Rrezet e veshura me diellin i hynin deri në thellësi të trupit. Bëri lutjen e zakonshme siç bënte gjithmonë para një beteje. Largoi emocionet. Ishte e vëtmja studente e arteve të bukura që sipas mendimit të të gjithëve ndryshonte nga të tjerët. Jo sepse e kërkonte të bukurën tek tragjikja, por edhe sepse kundërshtitë mes tyre i maste me madhësinë e qenies njerëzore. Ajo dinte të gjente hapësirën e kriuar nga zbrazja që ekzistonte pas ikjes. Ishte e qetë kur doli nga provimi i fundit.

- Ju mund të jeni një aktore interesante, sidomos për interpretime tragjike, - i kishte thënë njëherë Migeni në telefon. Por ajo e kishte fshirë imazhin e tij. Mendonte krejt ndryshe. Vdekja ishte një mënyrë që e kishte zgjidhur koha për të përsëritur ritualin e paraardhësve, ku mbështesnin kokën pasardhësit. Ndjeu të ftohtë, ndërsa ecte në udhën e përbaltur të liqenit që kishte nxjerrë në breg trupin e një gruaje. Sytë e saj të hapur mallkonin botën e përbashkët, së cilës i mungonte dhimbja. Julia preku duart e gruas. Ishin të ngrohta, një masë e butë që shndërroheshin në lutje. Ajo grua ishte zemëruar me të gjithë qytetin. Liqeni ndjehej i pafajshëm. Ai ulërinte se njerëzit kërkonin të vishnin lëkurën e vdekjes.

- Zoti na ruajtë, - ishte lutur Angjelina në mesnatë, kur Julia i tha se gruaja dukej se ishte e etur për vdekje. Pas mesnate, gjysma e qytetit ishte përmbytur nga urrejtja e gruas. Në shtë e njerëzve, uji ishte kthyer në një bishë që kishte përlarë çfarë i dilte përpara. Toka qe mbuluar të nesërmen me pemë të këputura nga rrënjet. Mallkimet e gruas nga ajo botë mbërrinin deri në baltën e murrme. Kishte ikur me shpresa të zhgënjiyera.

Në agim, një diell i lëmuar preku dhimbjen e tokës dhe varrin buzë rrugës të gruas që nuk kishte dashur të pajtohej me veten. Ajo ishte e bindur se shkatërrimi nuk ishte më një sekret. Ishte një zgjidhje e dobët, për t'u arratisur nga bota.

*L*avdi Zotit, - kishte thënë të nesërmen Julia, kur pa se dielli ishte mbështetur mbi trupat e njerëzve. U ndje bosh brenda vetes, kur u ul në kafene „Europa” . Harroi pse nuk i kishte telefonuar Arlit.

Ajo kishte parë siluetën e tij ditën që kishte mbaruar provimin e fundit. Por ai ishte larguar sikur prej saj ta shtynte një forcë e brendshme. Ktheu edhe njëherë fytyrën nga qielli. Mendoi se përsosmëria e botës qëndronte në diellnajën e brendshme të shpirtrave njerëzorë.

Julia u ngjit nëpër kthinan e ngushta të ligenit. Brigjet e tij të përbaltura nga nata e kaluar reflektoheshin në ndriçimin e rrezeve. Ndjeu fëshfërimën e blirëve të rinj që nuk ishin rrëzuar. Ata kishin ditur të qëndronin. Duket se ruajnë një qëndresë tërheqëse për të mbijetuar, mendoi duke i prekur. Dëgjoi nga afër zhurmën e një makine dhe zërin e shoferit të mbështjellë nga shurdhëria. E rrethuar nga hapësira e lagur, Julia nuk e ktheu kokën.

- Shefi më porositi se ka caktuar një orë, për t'u takuar me ju. - Oh, - çfarë fati ka bosi im të njohë një vajzë si ju!

Ai u ngërdhesh, duke qeshur jashtë dritares së makinës. Julia heshti. Ndoshta do të ishte kthyer, por tek shihte sytë e tij që po e ndiqnin me një domethënje tjetër, kuptoi se Arli ishte njeriu që vuante nga xhelozia. Thuajse i ngjante baltës së mbetur nga nata e përmbytjes së ligenit.

- Mirë pra, mos eja, - i tha ai dhe ktheu makinën e zezë që përplasej me udhën. Ajo nuk besoi. Në sytë e saj mungonin të fshehtat që Arli ende nuk ia kishte zbuluar. Pati përshtypjen, se ai e njësonte gjithçka me veten. Harroi sejeta ishte e tejpashme, ashtu si yjet e zhytur në qiellin e kthjellët. Julia u kthye menjëherë, kur dëgjoi zërin e tij.

Vetëm pasi e kishte zotëruar në sytë e déshirës, ai mendoi se pushteti i çastit nuk ishte brenda botës së saj. Përsosmëria e botës shfaqej tek njeriu i mirë që bashkohej me shpirtin. Njeriu mund të ishte skllav i vetes, tek çlirohej nga frymëmarrja miliona vjeçare e jetës. Nuk dinte pse Arli jetonte me dyshime. Ajo duhej t'i nënshtrohej idesë së qenësishme të arsyes, se bota e saj mund të ekzistonte pa të. Dy shpirtëra ishin të mjaftueshëm që të mos humbnin pikërisht atë ndjenjë, e cila lidhej me të drejtën e zotërimit. Sytë e Arlit lëshuan edhe njëherë dritën e rrëzuar si valët që këputeshin pa i gjetur kurrë lidhjet me dritën e bregut. Ishte e njëjtë të pranoje gjendjen e zhvendosjes së pushtetit nga njëri trup në tjetrin, ku fijet që i bashkonin si një qenie zhdukeshin pa e kuptuar. Disa herë i kishte krahasuar sytë e tij me dy sy të tjerë. Ato çuditërisht dukeshin, se gërvishqin dritën, ku mbyteshin kaçurrelat e saj të kuqe.

Benzi i zi mori kthesën në të djathtë të bulevardit "Zhan Dark". Julia u ndje në paqe, sikur të ishte një fëmijë. Ajri pengohej duke u përzier me smogun e dukshëm që gjerryente gjoksin e kryeqytetit. Ngjante se ishte veshur me një cipë të hirtë pluhuri. Ishte fundjavë. Njerëzit i ishin nënshtruar ditës së qetë, tekxa natyra u kishte lëshuar një ndriçim tërheqës. Ishin ndjenjat që të jepte natyra. Arli afroi trupin që kishte atë vetinë tërheqëse, për t'u ndezur duke u joshur me shijen e vërtetë të një gruaje.

- Eshtë një muzikë ëndrrash që më afron me tokën, - tha Julia. - Më ngjan se toka ka të njëjtën lëkurë si gruaja e veshur së brendshmi me ndjenjën e mëmësisë.

- Nuk është e njëjta gjë, - ia ktheu Arli, ndërsa kishte lëshuar pëllëmbët në tokë. -Ç'fjalë e shëmtuar do të ishte po të pranoja, se ajo është forca midis njeriut dhe jetës që ndan gjallimin nga vdekja.

Julia e kishte dëgjuar në heshtje. Fytyra e tij i largohej dhe afrohej, ndërsa në parkun e Dajtit dielli po perëndonte.

Sonte do të qëndrojmë në motelin e një mikut tim, - iu drejtua ai duke i shtrënguar gishtat. -Më pëlqen të zgjohem në krahët e një gruaje.

Julia i hodhi një vështrim në heshtje. U zhyt sërish në ngjyrat e fillimverës, e cila shtrydhëte lagështinë nga trupi i njomë i tokës. Shkëmbinjtë e hirtë, ku vareshin rrezet e fundit të ditës, provonin qëndresën në kryqëzimin e erërave që ngatérroheshin nëpër pishat e ulëta. Arli ndaloi para motelit. Julia tha se i pëlqente të pinte një kafe. Kohët e fundit i pëlqente kafeja. Nuk dinte pse Angelina, e përngjasonte kafenë me gjuhën e njeriut.

Zemra e saj dëgjonte lavjerrësin e përhershëm, ku rinistejeta. Ndjente trupin e tij të nxehëtë, i cili lëshohej si një marrëzi. Atje shkëmbehej kënaqësia. Të dy, shembeshin në shtratin e butë, ku kontaktet e shpirtit fshiheshin nga ajo magji e brendshme.

Në thellësi vërvshonte energjia e brendshme e trupave që ua ngrohte lëkurën, me zjarrin e çastit. Kur nata ishte zhbërë në ditë, ata e pranuan se e kishin zotëruar njëri-tjetrin. Qielli ishte veshur me tisin e trishtimit të reve, kur dolën nga moteli.

- Le të kthehem tek vetja, e dashur, - tha ai krejt papritur.
- Në të vërtetë nuk kam ndonjë të fshehtë të të përfshij në të dashurat e mia. Veçse ti je krejt ndryshe. Kam frikë nga imazhi yt. E kanë adhuruar të tjerët. Brenda meje kanë mbetur disa gjëra që rrjedhin nga koha. Çdokush zhvendos dashuritë e një tjetri që duken se një ditë mbeten si copëza të grisura në trupat tanë.

- Unë, nuk kam bërë ndonjë faj të madh, - ia ktheu ajo. - Asgjë më tepër se sa keni bërë ju me të dashurat e tua. Tashmë nuk ka mbetur asnjë fije nga lidhjet e mia. Secili ikën pas jetës së tij. Ti nuk më dashuron Arli. Kjo është e vërteta. . .

Arli vuri syzet e errëta dhe shtoi shpejtësinë e makinës, a thua kërkonte të zhdukej prej saj. Ishte e vështirë të gjente forca, për të harruar gjurmët e një tjetri. Gjithçka kërkonte ta kishte brenda vetes, pa i përkitur asnjëherë të tjerëve. Mos vallë ishte çmenduri të kërkonte një arsyë të tillë pér të braktisur një zemër?

- Për mua dashuria zgjat sa vetëjeta – ia ktheu Julia. - Ajo nuk tretet, ashtu si nuk treten ndjenjat. Ndoshta nuk më çudisin ish të dashurat e tua dhe lindja e një ndjenje të re.

Arli largoi gishtat nga flokët kaçurrelë. Nuk ishte në gjendje të përballonte retorikën e saj.

- Më duhet kohë të gjykoj vetveten, - tha ai. - E rëndësishme është të duhem. Julia vuri re se tek ai diçka kishte ndryshuar. Ideja e mosnjohjes, aspak nuk përbënte atë që ai e quajti ekzistencë e dikujt tjetër. Ndryshimi qëndronë në përbajtje. Ata jetonin në realitetë të ndryshme.

- Ju më njihni fare pak mua, - tha sakal Julia pa dashur t'i shndërrohej fjala në lutje. E dini që sapo jam diplomuar pér dramë. Më vonë më pëlqeu të isha një fotomodel. Ndjehesha mirë në pasarelat e modës. Ju dini vetëm anën e jashtme të jetës sime ! Dikur i përkisja një tjetri. Por ai asnjëherë nuk arriti të hynte në botën time. Nuk e di pse Migeni kishte një botë të zbrazët brenda vetes. Unë nuk munda të mbështetem kurrë në botën e tij dhe as ai nuk provoi të gjente botën time. Ne ishin dy të huaj në këtë botë.

- Më duket se po flet si në një telenovelë Julia, - e ndërpren ai. Edhe pse gjurmët e së shkuarës fshihen një

ditë ngajeta, ajo që mbetet është diçka që gjerryen ndjenjat.

Julia heshti. Ai po fliste krejt i shpenguar, pa u përpjekur të ndiqte vështrimin e saj. Edhe pse i kishte zbuluar të vërtetën e një dashurie të shkuar, ajo njëmend, tek shihe në sytë e tij pasqyrën e vetes, mendoi se pikërisht po gabonte sërisht. Arli nuk ishte njeriu që mund ta bënte të riletonte brenda dashurisë. Iu kujtuan gjurmët e së shkuarës në dashurinë e fundit që ishin zbehur nga harresa. Ajo nuk kishte dashur, të besonte se forca e dashurisë ishte e paripërtëritshme. Ndoshta vetëm atëherë do të ishte shfaqur mëkat. Pesha e fajit pas ikjes së Migenit, nuk mbeti vetëm mbi trupat e tyre të ndarë, por edhe mbi atë pjesë të kohës së grisur si manteli i virgjërisë që i kishte bërë pis të nesërmen.

Dielli ishte ngulur pingul mbi tokën që kryqëzohej me jetë të tjera. Si mund të zbrazej një jetë njerëzore nga ndjenjat e një tjetri?

Tek shihe udhën e ngushtë, ku ishte rrëzuar errësira, mendoi, se nuk kishte asnjë kuptim të bindej për atë dashuri. Arli i përkiste një ndikimi të ekspozuar para një historie. Ai kapérthehej nëpër zhgënjin, ku sytë hapeshin vetveti atje tek shfaqeji drita. Gjithçka qe rikthyer në zhdukje. Koha ishte ndarë në dy pjesë, ashtu si një cigare e shuar. Më në fund historia mes tyre ishte bosh, qe kthyer në hi. Mbuloi fytyrën me duar nga flaka e djegur.

- Më duhet të shkoj, - i tha Arlit. - Kam një takim tjetër me stilistin. Kërkoi të çlirohet prej tij siç kërkonte ajri të filtrohet nga pluhuri i mbetur në zhurmën e frymëmarrijes. Arli ndaloj makinën para këmbëve të piramidës që dukej si një kufomë e shtrirë pa qeliza. Jeta nuk ishte asgjë tjetër veçse një mbrëmje e vdekjes së èndrrës. Kishte dëshiruar të përjetonte një gjendje tjetër. Arli ishte episod i një nate të vdekur që kishte lëshuar mbetjet në një kohë, kur priste të qetësohej era kalimtare. Mendimet e ndaluara ishin në

mëdyshje të shndërroheshin në një zinxhir. Atje stampoheshin njollat e fundit që ndoshta mund të pastroheshin në ujin e luleboreve. Fjalët endeshin sa mbi pushtetin brenda një njeriu, aq dhe në mënyrën se si tërhiqeji për ta kuptuar fuqinë e kundërt. Errësira ishte derdhur gjithkund. Jeta ishte thyer në copa-copa.

Julia ngjitur pas ndenjëses së butë, vështronët bliret që luhateshin. Kishte dashur të përfytyronte një natë tjetër, por Arli e kishte bërë të ndeshej me të shkuarën që asaj i dukej e tejskajshme. Megjithatë të ardhmen duhet patjetër ta kërkonte në domethënien e furtunave të ikura. Ndjenjat po e zotëronin pas atij ndryshimi që e kishin bindur, se ata nuk ishin të njëjtë. Ai kishte brenda ndërgjegjes së tij një fije të errët të lidhur me të kaluarën.

Julia e pa së largu stilistin. Ai po qëndronte në kthinën e fundit të bar “Mumjes”. Vështroi rrëth e rrotull muret e heshtura, ku vareshin ca piktura që mezi shquheshin në mjegullnajën e hirtë. Kishte dashur të hynte në botën e ngjyrave të modës. Të gjithë e kishin quajtur bukuroshja e vitit. Julia nuk u ndie mirë nga mungesa e dritave. Ishte një shkrepje e mendjes së pronarit të lokalit, një burri të bëshëm me ca sy të palexueshmë, i cili dëshironte të krijonte çaste intime për të dashuruarit. Stilisti ishte ulur në tavolinë me Inën, modelen me të re që mbante në krah qenin e saj të bardhë. Julia u përshëndet me Iglin. E mundonte shumë heshtja e dritave të vërteta. I ngjante se ishte në një shkretëtirë. I kishte pëlqyer qysh në fëmijërinë e tij të parë të sajonte për trupa njerëzorë veshje, të cilat, e ëma, një rrobaqepëse e kujdesshme mezi ia përshtaste, sipas shijeve të të birit. Jeta e saj shpesh ishte mbushur me kohë të vështira, ndaj ajo ndonjëherë nuk i vinte pas fijes. I ati, përkundrazi duke ndjekur idetë e pavarura të të birit, i cili e adhuronte modën, e shtyu të shoqen të pranonte se i biri ishte krejt i pafajshëm. Ai e kishte zbuluar të bukurën në

sipërfaqen e asaj bote që i ngjitej pas vetes. Igli humbte tërësisht në kukullat që i vetëshkatërronte e motra. Ai sajonte ca fustane të kaltërtë që e magjepsnin kur shihte trupëzimin e tyre me trupat e gjallë njerëzorë.

- Çudi e madhe, - kishte thënë një mbrëmje e éma. Eshtë e habitshme. Një djali i pëlqen të veshë kukulla. Djemtë i kërkonin lojërat e tyre në armët plastike. Për Iglin ato ishin të pakuptueshme, madje i urrente. E pushtonte tmerri sa herë i prekte. Ai ishte deklaruar i çmendur pas sfilatave. Atëherë kishte besuar se sinjali që i ishte ndezur brenda vetes po i hynte deri në eshtra.

Në fillim i kishin pëlqyer ngjyrat e ndezura me lule të gjithfarshme. Kukullat i ndjente si qenie të gjalla, të cilat përbënët botën e tij mbrëmësore. Më vonë ai u shfaq në kopertinat e revistave të modës. Shihte çdo ditë në ëndërr pasarelat e blerta. Vitin e kaluar modelet e tij kishin spikatur për një lloj veshjeje tradicionale-erotike. Kjo ishte arsyja pse ai nxiti kureshtjen e njerëzve në botën e së bukurës. Filluan ta preferonin klientë të të gjitha rangjeve, qysh nga gruaja dhe vajza e presidentit, të dashurat e ministrave e deri tek adoleshentët që kishin maninë të dukeshin krejtësisht ndryshe.

- Fustani yt do të jetë një copë prej mëndafshi ngjyrë hëne, - i tha stilisti i ri Julias, kur në bar "Mumja" po shuheshin qirinjtë e fundit.

*A*ngjelina D. preku gërshetin e butë si zemra e një fëmije dhe vështroi muret e bardhë të shtëpisë së braktisur nga të gjithë. Mungonte shpjegimi ti, ai, ata, të cilët bënин pjesë në botën e mbështjellë nga heshtja. Terri ishte zvogëluar deri në ikje, ndërsa njollat e agut ndriçonin fijet e drejta të flokëve të saj. Ajo kishte mbetur reja e vetme e jetës në atë shtëpi, ku lëvizte një hije as e gjallë, as e vdekur.

Mori frymë thellë. Nata ishte larguar me trishtimin në shpirt. Të gjithë e kishin quajtur lavire, vrasëse, vajzë e përdalë. Ky imazh e kishte mbërthyer si një litar qysh atëhere, kur qyteti pati kërkuar ta fshihte fytyrën e saj pas një historie që ishte mjegulluar bashkë me grimcat e përhumbura nga një vrasje. Angjelina ekzistonte në shumëfishin e mallkimeve, nën qjellin e nxirë nga urrejtja, brenda një dimensioni të vrazhdë, disi e largët, e padukshme, fshehur nën retë e harresës. Ajo kërcënonte të ishte vdekatarja e marrë e qytetit të ndarë nga rraskapitja e muzgut.

Jeta e saj ishte krisur nga e shkuara. Asohere që përcaktuar si një zemër e zbrazur nga e nesërmja. Ishte mbyllur në vetvete duke u thërrmuar në mijëra mbetje të lodhura. Gjithçka ngjante me një sëmundje ngjitése që i brente trupin si një qenie anemike. Njerëzit kishin pasur frikë, se një ditë qytetit do t'i mungonte gjaku. Epilogu i

asaj vdekjeje davaritej prej enigmës që mbante brenda vetes ditën më të zezë të kujtesës së tij.

Angjelina gërvishти me gishta membranën e zhveshur, të pambrojtur nga koha e humbur. Dikur ishte mbështetur në vërshimin e pajetë të një nate pa ëndrra, ku një e fshehtë misterioze e dënoi t'i largohej së shkuarës. Gjithçka ishte tretur. Por ajo edhe njëherë të vetme nuk kishte pranuar se njeriu mund të jetonte pa të kaluarën. Mjaftonte forca e dashurisë brenda një zemre, për të gjetur pikëmbështetjen e së ardhmes.

Angjelina jetonte duke kapërcyer verën vetvrasëse dhe dimrin e akullt me shuplakat drejt diellit. Ai rrëthohej nga muri i hirtë i reve, të cilat afronin stuhinë shpërthyese të shiut. Nuk e dinte pse zgjohej pa dritë. Agu lindte brenda shtatzënës së natës, mbështjellë me lecka të lagura që vareshin nëpër dritaret e thyera. Vitet e zhdukura e mbulonin me një kuvertë që frymohej nga retë. Nën nënökresë e zinte gjumi me fotografinë e tij. Atje dukej e shkuara dhe një vështrim i gjallë në ditën atë. Ajo mbështetej mbi trupin e harruar që ishte endur një mëngjes duke kërkuar fytyrën e saj. Në mbrëmje, ai ishte parë nën dritën e zbehtë i rrëzuar mbi trupin e tokës. Ashtu lidhur me qelizat e secilit, ai dhe toka dukeshin se ishin pjesë e njëri-tjetrit. Angjelina pinte kafenë e hidhur, lëshonte përtej dritares lutjet e përditshme dhe pastaj zhdukej pa e ditur, në do të ekzistonte të nesërmen. Kërkonte të ikte sa më shpejt nga ajo botë. Lutej para Zotit deri në përhumbje, por asnijëherë nuk u zgjua e vdekur. Rrëfehej natën vonë para hijes së tij, të cilën e shihte të gjallë.

Askush nuk e kishte parë të vdekur Erten S. Gruaja më e bukur e qytetit kishte dëgjuar një zë mallëngjyes. Erteni ishte parë me një të dashur para ikjes në atë botë. Dikush fliste nëpër qytet, se ai ishte mërzitur me jetën ose ishte arratisur prej saj, sikur të bënte një lojë. Me sytë e veshur nga lotët, Angjelina dëgjonte histori të heshtura, pothuajse

të llahtarshme, histori të ndaluara që shkruheshin nëpër copa letre e ajo gjente diku vend për t'i ruajtur. E kishte pyetur shpesh jetën e saj, pse vuante nga ajo histori tragjike që pa mëshirë ia kishin sajuar të tjerët. Ata, vetëm kishin ditur të thurnin një të „vërtetë” të hidhur, të rrezikshme, e cila ishte besuar nga të mençurit dhe të marrët.

Angjelina i ishte dashur vetëm një ditë-natë, për të mos e besuar atë histori që kalonte nga njeriu tek koha, transformohej brenda trurit të njerëzve në një kohë tjetër. Të nesërmen bëhej më e ndërlikuar, më e frikshme, më e pakuptueshme.

Jashtë në kubenë e qiellit të errët që ulërinte si një qenie njerëzore i shfaqej djalli. Ai e kishte shkëputur nga përndritja. Fliste me kohën e ikur. Vetëm një histori të pabesueshme kishte përjetuar në jetën e gjallë, pa shkuar ende në vdekje. Nuk ishte faji i saj, pse nuk kishte mundur ta besonte atë ngjarje tragjike. Ishte lutur me mijëra herë ta zbulonte të vërtetën, por kujtimet e godisnin siç qëllonte breshëri tokën e thatë pas një vere përvëluese. Nuk dinte pse nuk dëshironte të dëgjonte të flitej për vdekjen. Madje dikush kishte dëgjuar se mungonte kronologjia e ikjes nga bota e të gjallëve e Erten S.

Edhe pse qyteti ishte i mbështjellë nga tymi i vdekjes, imazhi i Ertenit u shfaqej të gjithëve. Të paktën vajzat e liceut nuk besonin se ai ishte zhdukur nga ajo botë.

- Mos flisni më kot, fjalë në erë, - u drejtohej njerëzve në udhë Angjelina. - Mos u bëni të marrë. Ai njeri nuk ka vdekur. Madje nuk ka asnjë provë për vdekjen e tij. Askush nuk e ka parë kufomën, pra si mund ta besoj këtë humbje? Eshtë një alibi në jetën e Erten S.

Kishte ndaluar në perëndim të qytetit dhe një Zot e dinte pse të gjithë e shihnin me urrejtje.

Fytyra e tij i shfaqej vetëm syve të saj, gjithkund në portat e shtëpive me ngjyrën vjeshtake, në lëndinën e fshehur kur

e puthi për herë të parë, në shkallët e liceut. . . Gjithkund shihte hijen e tij. Dukej se ndiqnin hijet e njëri-tjetrit.

Vetëm e imagjinojnë vdekjen e tij, mendoi edhe njëherë Angjelina. E keqja më e madhe e këtyre njerëzve është se ata nuk merren më shumë me veten, por me parandjenja naivë për të tjerët. Atëherë kur ngjau se nuk e pranonte vdekjen e tij, dikush e kishte parë përmes hekurave duke pritur. Ajo ishte një nga të akuzuarat për vrasjen enigmë.

Dëbora apo ishte shkrirë. Nga larg ajo pa ngjyrën e vërtetë të tokës. Dielli, mëshiruesi më i madh i botës, i preku kaçurrelat. Dëgjonte në gjithnjë zërin e shpresës. Erten S. nuk është hije. . . Ai i urrente hijet. . .

- Nuk është faji im që s'e besoj këtë vrasje të trilluar, - i tha oficerit të hollë flokëverdhë. Ai e kërcënonte për ta pranuar vdekjen e njeriut të dashur, i cili të gjithëve në mënyrë të çuditishme u buzëqeshte nga ajo botë edhe i vdekur.

- O Zot! Por si mund ta besoj, zotëri, vdekjen e Erten S? . . . Nuk mundem. Eshtë krejt e pamundur. Asnjëherë nuk e kam besuar.

Unë mbrëmë gjithë natën kam bërë dashuri me atë njeri. Ishte e vetmjë dashuri e jetës sime.

Dhe e kuptioni çdo të thotë kjo? Unë mendoj, se kjo do të thotë të qëndrosh me jetën dhe jo të shkosh në vdekje, zotëri. Më ka dhuruar mijëra përqafime. Ato kishin aromën e dashurisë. Dhe në fund kam pritur atë dallgën eëmbël që është themeli i jetës. Kurrë nuk më besohet, kurrë nuk më besohet se ai ka vdekur. Kjo është një lojë, një lojë. . . pse jo alibi. . .

Oficeri, i cili shikonte vetëm gjysmë portretin e saj fare afër, i tha, se atë ditë kishte qenë e shtunë. Në trupin e tij ishte gjetur një plumb. Ndoshta kishte vrarë veten.

- Jo, ai e ruante një plumb, për t'u mbrojtur dhe asnjëherë për të justifikuar vdekjen. Madje, unë e dija, ku ruhej plumbi.

Edhe tani e di . Eshtë në librin e luleve. Ai nuk i trembej vdekjes, zotëri, as vrasësve.

S'ka asgjë që mund ta gjykojë këtë vrasje, sepse Erten S. nuk i besonte vdekjes. Nuk e di kush e shpifi vetëvrasjen e tij. Një histori e lindur vetëm nga përshtypjet e të tjerve.

- Dikush i kishte parë një plagë të mavijosur, - vazhdoi oficeri. - Ishte një vrimë e çregullt në zemër ose në ballë. Diçka e tillë më duket. Unë vetë nuk e kam parë kufomën.

Muret e tokës ishin lyer me pika gjaku. Ai dhe toka ishin shkrirë me njëri-tjetrin. Çudi si një ditë të gjitha jetët njerëzore bëhen një trup me dheun. Ndoshta, njeriu ka më afër tokën. . .

- Nuk ka qenë ai i vdekuri, - i tha Angjelina, oficerit që i dukej i huaj. - Unë mendoj se bëhet fjalë për ndonjë person tjetër, ose për ndonjë shembëlltyrë të tij. Bota është e njojur për sozie. Ka njerëz që ngjasojnë shumë me njëri-tjetrin.

Oficeri kishte ngrirë vështrimin mbi fytyrën e saj si era e akullt që frynte jashtë dritares. Ndjehej krejt i përhumbur pas forcës së zërit të Angjelinës. Më në fund nuk ishte në gjendje të kërkonte një arsyё tё brendshme, për ta trupëzuar si një fotokopje në kujtesë atë vdekje. Kjo nuk është një çështje e thjeshtë, mendoi me vete, para se të mblidhë copat e asaj ngjarje që kishte trondit tur qytetin.

- Pra, ti Angjelina, dashuron një të vdekur, - i tha oficeri.  
- Kjo është marrëzi!

Të nesërmen Angjelina D. ishte parë të sillej në qendër të sheshit, ku shpalleshin njoftimet e vdekjeve të njerëzve. Pa aty shembëlltyrën e tij të lagur nga shiu i ndërprerë. Iku nxitimthi me mendimin, se nga nesër e tutje do t'i ngjitej pas ajo vdekje misterioze që i gërryente mishin, duke ia mbështjellë jetën me të shkuarën. Kishte zbrazur në botën tjetër të ardhmen.

Në mbrëmje i ngjau se po e mësynin zemrat e gjalla të qytetit. Disa syresh e kërcënonin, pse nuk mundi ta mbante

brenda trupit të saj zemrën e tij. Askush nuk mund të bëhej një engjëll mbrojtës për fundin e një jete. Madje nuk hynte në historinë e tij një vdekje e tillë.

Angjelina u largua nga qyteti në mesnatë. Errësira mezi lëvizte, për t'i lëshuar vendin dritës. Dyshoi, se nuk do të mund të jetonte pa tokën e veshur me diell të lodhur që digjte një shpirt.

Oficeri nuk kishte të drejtë të lëshonte mesazhe të pavërteta për një vrasje të errët. Ishte kulmi i një zbulimi që nuk ekzistonte. Mirëpo qe shtangur para Angjelinës, kur ajo i tha, se nuk mund ta kapërdinte një shpifje kronike.

*A*ngjelina lëshoi jashtë vetes një mërmërimë nën qiellin e rrethuar me re të hapura rrëth e rrotull, duke shkaktuar një rrëmujë që nuk e linte as të kujtonte ngjarjen e shkuar. Kishte ndezur një qiri, apo hyri në shtëpinë e bojatisur me një cipë të bardhë gëlqereje. E shkuara dhe e sotmja endeshin lirisht nën pluhurin e tyre, duke iu shkrepur më në fund të mos pyesnin për asgjë. Askush nuk ishte i panjohur në sytë e tjetrit. Ajo sërisht krijoj imazhin e njeriut që për të tjerët nuk ekzistonte më. Brenda vetes e braktisi përjetësish atë ide duke pranuar, se kjo ishte e vërteta më e çmendur që kishte dëgjuar. Koha kishte përpara të ardhmen. I përngjasonte një dashurie të pavdekshme, e cila e mbante gjallë në këtë botë. Dashuria ishte më e fortë se njeriu, madje më e madhe ngajeta. Ajo kishte imposhtur zemrat e të dashuruarve në të gjitha kohët. Njerëzit kishin mbijetuar vetëm me drithën e dashurisë së përjetshme.

Ai e thërriste gjithmonë dashuria ime, sepse ajo ishte më e thellë se fuqia për jetën. Vetëm pasi kishte bërë një natë dashuri me trupin dhe shpirtin e saj, Erteni qe ndriçuar me drithën e thimthave të gjoksit shpërthyer nga tërheqja drejt jetës. Angjelina ndjeu se gjithçka kishte ndryshuar pas asaj dite, kur ishte mbështetur mbi supin e tij sikur të ishte në majën e një mali. Për t'u bindur në ndryshimin mes kohës dhe jetës, ajo mbeti gojëhapur, kur i thanë se Erteni nuk ekzistonte më. Sikur atë mëngjes të

mos kishte prekur trupin e tij, ku energjia brenda jetës çlirohej deri në zgjim, nuk mendoi se mund të ndodhë diçka krejt ndryshe, një vrasje e padukshme.

Atë ditë ishte e dielë. U zgjua duke rikujtuar, dashurinë që nuk do të kishte fund. U përpoq sërisht të kthjellohej, teksa po përplasej me një kohë të zhbërrë para pëlhirës së natës. Besoi atëherë, se edhe ajo do të quhej e vdekur.

Nga larg dëgjohej një zë violine. Ajo nuk vinte nga fundi i botës. Si nëpër ëndërr i largoheshin pa prerë tingujt e kthimit, tek pesha e dashurisë që mbetej në zemër.

Angjelina pa fytyrën e saj rozë të zbehur. Ideja e sajimit të historive njerëzore ndodhë gjithkund. Duke pëshpëritur emrin e tij, tha se ishte njëlloj si të besonte një ëndërr.

Ata të dy, apo ishin kthyer nga një botë tjetër që për ta kishte qenë e huaj. Secili kishte shënuar në kujtesën e tij kontrastin e atdheut të vërtetë, që e gdhendte në çdo kohë dielli. Rrezet e tij i vareshin si kordele mbi fytyrë pas shiut të ftohtë. Era që si një grua e dehur, rrethonte qytetin e huaj nën qiellin e vejushave kishte fshirë mjegullën. Ata ndjenin brenda shpirtrave mungesën e diellit jashtë vvetvtes. Ishin ca lidhje prej qelizave të gjalla nga qiellorja deri në materien e fjalëve të syve.

Qielli ishte duke vjedhur rrezet e harruara të marsit, kur ne u dashuruam marrëzisht.

Shikoheshim në dritën e njëri-tjetrit, poshtë atij qielli të huaj që nuk i përkisnim.

Ajo do të studionte për violinë dhe ai për drejtësi. Kishin fituar nga një bursë. Nuk dinin si u bindën të niseshin të dy me anijen e mesnatës “Durah”.

Prindërit e saj, nëna një mësuese violine që kishte studiuar në Vjenë dhe babai një tregtar i zoti kafeje, nuk kishin aspak frikë për talentin e së bijës. Ajo kaloi periudhën e adoleshencës, pastaj mbaroi liceun me dëshirën për t'u bërë dikush.

Fliste për muzikën, sikur fliste me jetën. I depërtonin ndjenjat e zotërimit të tingujve, aq sa ato i kujtonin shkëndijën e lindjes si një fillim kohe të re. Në atdheun që kërkonte të lëvizte drejt botës së qytetëruar, secili kishte një ëndërr. Të ishte pjesë e trupit të tij, ku të shqiptohej vetëm një zë.

Të dy i uruan gjithë të mirat qytetit që kishte çati të përjetshme diellin. Vrapuan drejt portit të lagur nga përplasja e valëve me bregun, ku rrëshqiste hëna e mallit. Qytetin e lanë me fytyrë të kthyer nga perëndimi. Nën errësirën e përzier me sipërfaqen e lakuriqtë të detit ishte shkrirë drita që tërhiqte drejt vetes lidhjet e trupave të tyre. Njolla e vogël e tokës u zhduk. Ata nuk panë më asgjë të dukshme, përveç heshtjes së yjeve dhe kërkëllimës së zërave detarë që rrëzoheshin në gjoksin e zjarrit duke djegur dekoltenë e errësirës. Erteni dalloi dy pika loti të mëdhenj në sytë e gjelbërt të Angjelina. Ia fshiu me shaminë e kaltër të ditës. Përtypja e lagësht e valëve që dukeshin se kishin braktisur shtratin e bregut, përzuhej me erën e hutuar. Ajo shtyhej sërisht prapa. Të dy, ishin shtrënguar pas njëri-tjetrit. Ata lanë tokën që mund të krahasohej me virgjëreshën dhe u gjendën në agim në një botë tjetër, të cilën vetëm e kishin ëndërruar. Kur lexonin ndonjë libër, apo kur profesorët e gjeografisë dhe të historisë shënonin në hartë me gishtin tregues vendin që mund ta preknin me duar, besuan se ishin në një qytet të huaj.

Roma ishte një tokë ngjyrë gjethesh, me udhët e ngushta që uleshin mbi ca shtëpi të zhurmshme. Këmbanat qetësonin heshtjen e njerëzve, të cilët merrnin pjesë në meshën e së dielës. Mëngjesi qe i ftohtë. Ata u ndjenë sikur ecnin drejt qendrës. Një drithë marramendëse shtrihej nga jashtë e shndërrrohej në një zbrazëti të braktisur. Dëgjoi brenda vetes një ndjenjë tjetër, atë të kapërcimit të qenies së saj në agun e zgjatur mbi vitrinat. Atje shfaqej një vizion

tjetër i botës që ekzistonte në ndryshimin kureshtar të fytyrës së huaj.

Brenda qenies së gjallë ndieu peshën e dashurisë për fytyrën e tokës së largët. Provoi një përshtypje mirëqenieje, të cilën e kishte imagjinuar kalimthi. Udhës së gurtë mezi tërhiqeshin karrocat, që kishin një pamje trishtimi e ndoshta mallkonin barrën e rëndë sipër vetes. Angelina ndjeu se po i shfaqej një botë tjetër. Ajo ishte aq e dukshme, sa edhe e padukshme. Udhëtuan me një karrocë të ngjashme me fytyrën e hutuar të karrocierit, i cili fërkoi trupin e kalit, sikur ta kishte një shpirt. Më vonë i hodhi një vështrim të butë çiftit të panjohur. Ata vështronin vetveten, para se të këqyrnin qytetin tek zgohej nën reflekset e lamtumirës së yjeve të natës. Ende ndjeheshin larg paqes, kur trokthi i kalit ndaloi para një ndërtese të hirtë. Afér dëgjoheshin tinguj të gjallë, të cilat i pushtuan shpirtin. U ndie e vendosur. Ngjiti shkallët e mermarta, mori frymë thellë dhe hyri në sekretarinë që kishte një formë të pjerrët. Një grua rrëth të dyzetave i pa me një vështrim të vëmendshëm para se të kryente veprimet me dokumentacionin.

- Ah, siete arrivati d'Albania? - pyeti ajo duke vështruar pamjen tonë të jashtme. - Sa mirë! Ne jemi edhe fqinj me njëri-tjetrin, përveçse duhet të kapërcejmë një det të përbashkët. Ka edhe studentë të tjerë këtu nga vendi juaj. Jo se kanë prekur ndjenjat e mia, por janë njerëz të mrekullueshëm. Ajo ngriti mëngët. Zëri i saj rrëshqiti duke mbushur hapësirën bosh që ishte krijuar pas domethënieve të zakonshme.

Pak më vonë ata kishin dalë në udhën e gurtë që të conte drejt koloseut. Ai dukej se mbështetej mbi supet e qiellit. Pëllumbat e butë ngrinin një pluhur të bardhë rrëth gjurmëve të tyre. Nga dritarja e hapur shfaqej një pjesë e vogël e Romës së lashtë. Atje ende përfjetohet mesjeta që

dukej sikur kishte rrahur brigjet e fshehura pas gjunjëve të hapura të tokës. Jashtë frynte një erë vjeshtore, e cila përplasej me hijet e gjelbërta të akacieve.

Erteni u vendos në një apartament gjatë bregdetit. Ai dukej sikur përkulej deri në ijet e detit, për të puthur barkun e ndritshëm si qelqi të valëve që thyheshin në breg. Ata të dy ishin të huaj në atë qytet, të përkohshëm në praninë e tij, ku i priste ndjesia për një botë tjetër. Në trup dhe fytyrë Evropa e vjetër zbulohet vetëm nga jashtë duke fshehur përthyerjen e fundit. Askush nuk ndjehej fajtor, pse ajo botë po shihte hijen e afërt, e cila po i mbështillej muzgut.

**A**ngjelina lëvizi gishterinjtë mbi telat e ndalur të violinës, ku shpalley dashuria e madhe. Tani ndodhej në një cep të botës, duke qenë mirënlohëse për çdo zemër që i zgjonte në shpirt ndjenjën e paqes. Lidhjet e thella me botën përballë bregut tjetër i ruante nën një flamur të vogël, të cilin e vuri në dritare. Brenda tij gjente fytyrën e atdheut.

Më në fund e kuptoi se ndodhej në mes të një trupi. Sytë shihnin nga bregu i vjetër dhe hapat e çonin në brigjet e tokës së huaj. Kishte frikë nga ikja, si të kishte frikë se në gjurmët e saj diku largohej hija e mbetur në metronë e kujtesës.

Erteni nxori nga valixhja një këmishë të mëndafshë. Ia kishte dhuruar një miku i tij, që sapo ishte kthyer nga Parisi. E ndjeu veten elegant përballë Angjelina. Edhe ajo asnijëherë nuk kishte qenë më e mirë se atë ditë. Në lice nuk kishte spikatur si një vajzë e bukur, por mungesen e bukurisë e plotësonte më së miri një shpirt. Aty kishte aq dashuri e dhimbje, sa e kthjellonte ditën e mbyllur nga retë.

Erteni nuk kishte guxuar ta prekte kurrë. Megjithëse i dukej se kishte një shekull që e njihte, në të vërtetë qenë njojur vetëm katër muaj më parë. Nuk i kishin shpëtuar magjisë së shikimit shpërthyes nën një gjysmë hënë që afrohej e largohej, sa herë ata shihnin fuqinë e dashurisë. Ajo u kishte prekur çdo pjesë të qenies. Pak minuta, mbeti pa frysë. Ai i tha se e kishte futur brenda vetes qysh atë

çast të ndritur që sjell vetëm për një grimë jeta. Nuk e thirri asnjëherë në emër, por as ajo nuk çuditej kur Erteni e përkëdhelte, dhe e thërriste „Engjëlli im”. Ata kishin hyrë brenda njëri-tjetrit. Zbuluan se ndjenjat ishin nën pushtetin e dashurisë, siç ishte toka nën pushtetin e diellit. Trupi i asaj dashurie kishte mbirë si një pemë e madhe në shpirtin e të dyve. Ajo gjithherë ishte në rritje edhe në atë vend të huaj, që për të tjerët ishte i njohur si bota e re. Angjelina mendoi se asgjë nuk mund ta ndante prej Ertenit, megjithëse ky ishte një arsyetim i vjetër, i përdorur nga të gjithë të dashuruarit e botës.

Po binte muzgu. Të dy kishin ndaluar në zemër të qytetit. Diku bleu një gramafon. Prej tij shpérndaheshin tingujt e violinës. Në kishë mori bibliën. Kishte dëgjuar se ajo të sillte fat. Shëtitën nën dritat e zbehta të fenerëve varur nëpër muret e hirta të vilave të vjetra hijerëndë, pothuajse me të njëjtën veshje pshërëtimash që koha po i gjerryente ngadalë. Nëpër vitrinat e librarive duke sheshin revista bardhë e zi me trupa grash të zhveshura. Ato më shumë ngjasonin me fajtore që kishin tradhëtar vete. Ndaluani në një bar të vogël, ai për të ndezur një cigare dhe ajo për të marrë një çokollatë që i pëlqenin shumë.

Ndoshta atje kishte ndonjë festë të veçantë, pasi kamarieri një djalosh i zeshkët veshur me një këmishë të bardhë, i ftoi duke menduar se ishin me grupin e të ftuarve. I shoqëruan tek një tavolinë rrëthore në anën e djathtë të lokalit. Në mure vareshin ca piktura të vjetra që të kujtonin Shën Mërinë dhe portretin e një të dënuari me vdekje të shtyrë nga tradhëtia. Ata të dy qeshën me pikturen e vdekjes sentimentale të shprehur në art nga dora e një gruaje. Ajo shpallte se edhe pas vdekjes një burrë apo një grua nuk mund ta tradhëtonte dashurinë. Dikush hapi gramafonin. Zëri i ëmbël i një gruaje i lutej Zotit të dhuronte më shumë dashuri në zemrat e ditës e të largonte si natën, urejtjen mes

njerëzve. Të ardhurit vallëzonin mbështetur mbi krahët e njëri-tjetrit. Ndjenin parfumin e lehtë që u përzihej me notat e muzikës. Angjelina iu duk e tepërtë të qëndronin më shumë, por dikush krejt papritur e ftoi në vallëzim. Ajo nuk kundërshtoi. I shpjegoi të panjohurit se ata nuk ndodheshin aty për festën. Ishin studentë të huaj, të sapoardhur. Ai buzëqeshi lehtë. Edhe ai ishte një student i huaj. Në atë bar organizoheshin festa të thjeshta me studentë nga e gjithë bota. I panjohuri kërkoi falje, kur Angjelina pikërisht atë çast i kapi duart. Ndjeu shtrëngimin e trupit si të ishte zgjuar në krahët e djaloshit. Teksa po shkëputej prej tij, ai i tha se vinte nga një vend fqinj me emrin Shqipëri. Ajo brofi si të ishte çuditur nga një ëndërr. E përshkoi një dridhje e thellë në të gjithë boshtin që e mbante në këmbë.

- Oh, Zot, - foli si rrallëherë me zë të lartë. - Edhe ne jemi nga Shqipëria. Jemi nga e njëjta tokë dhe udhë që merr frymë nën parajsën e diellit. Oh, - më vjen keq që nuk u njohëm për shkak të gjuhës. Më duket e frikshme, kur një gjuhë ikën larg si diçka që harrohet.

- Punë dreqi, - tha Erteni. - Në një vend të huaj flasim gjuhë të huaj dhe ndihemi të huaj. Eshtë një ëndërr e tmerrshme të jesh larg atdheut, është si një zemër jashtë nesh.

- Gëzuar, - tha i pari Erteni. Trokiti gotën me Angjelinën dhe të saponjohurin.

Ai quhej Anton. Ende e qeshura e tij përhapej në ajër, teksa i përqafonte me mall dhe lot nga sytë e kaftë. - Hej, çfarë mrekullie...

- Ç'rastësi e bukur, - vazhdoi ai duke thithur cigaren "La Perla". - Nuk na falet vëlla, nuk na falet të mos e njohim njëri-tjetrin. - Ah, - botë e keqe. E bukur është vetëm në dukje. Antoni kishte një shtat të gjatë e pak të kërrusur. Tha se ishte nga qyteti i Rozafës.

Studionte për drejtësi dhe s'kishte dëshirë të fliste përveten. Dolën të tre së bashku para mesnatës, ndonëse ende Antoni fliste përmëkatin e harrimit. Të nesërmen ishte e dielë. Ata pas atij faji të pafajshëm e lanë të takoheshin përsëri. Ndodheshin në të njëjtin qytet, ku gjithsesi bota ishte e të gjithëve.

Angjelina ngjiti shkallët. Njeriu ishte si ai shpendi çudibërës, i cili dinte të lehtësohej në folenë e tij, sepse kishte frikë nga vëtmia. Megjithatë një ndjenjë mirënjohezë kishte mbetur në botën e secilit. Ajo ndihej tërësisht e çlodhur. Hapi dritaren të largohej prej arratisjes. Ndoshta kjo histori e vogël, qe një histori e madhe, për të mos jetuar me vetveten. Ata besonin të jetonin një të ardhme dhe luteshin tek e nesërmja. Angjelina u shtri në shtrat. U lut sërisht para biblës. Ndjeu zërin e nënës atje në tokën e largët, që ishte i njëjtë me zërin e të gjitha nënave të botës.

Fusha e rrezeve e nxirrte më në pah qetësinë. Era shtyhej pas vetes deri në malin e shpirtit. Për fat të mirë Angjelina e adhuronte gjithë botën. Megjithatë i duhej të mësohej me qenësinë e atij qyteti prej gjethesh, që ndonjëherë i ngjante me një fotografji. Ajo vetëm për një çast ishte skllave e syve të tij.

Qielli befas ishte fshehur nga një lëkurë qumështore resh, nën një rrëthim të shiut që e priste tokën me ca shkrepje drite.

Pas shkarkimit të shiut mbi trupin e ngjeshur të tokës, qielli u duk i téri si një perëndi, e cila i kishte huajtur njerëzve ngjyrën e jetës. Bota jetonte nën pushtetin e saj. Secili përkulej për të gjetur kohën që i përkiste. Ishin të vetëdijshëm se të gjithëve iu pëlqente largimi i erës dhe forca e diellit. Angjelina nuk habitej, pse njeriu kishte një formë që tërhiqej nga brenda. Ajo ndryshonte nga e shkuara, diku shfaqej e pacipë, apo e rëndësishme thuajse ashtu siç u ndodhë të gjithë qenieve njerëzore. Askush nuk mund

të mendonte se njerëzit qenë ndarë. Ata kishin shtyrë së jashtmi përkohësisht një pjesë të rrahjeve të kohës. Njëherësh së brendshmi, rrahjet e zemrës gjendeshin në një botë tjetër që griste terrin.

*N*ata dukej sikur po zbraste barkun e saj nga errësira, për të lindur ditën. Kishin vetëm tre muaj që ndodheshin në atë qytet të huaj. Çdo mbrëmje ndjenin se diçka u ishte shkëputur nga vetvetja. Kjo nuk ishte tjetër, veçse një njësim i pashmangshëm që i ndiqte nga pas. Ata ende nuk e njihnin atë botë të ngatërruar, e cila jetonte kur i duhej të bënte diçka të tillë dhe vdiste krejt si e paqenë. Erteni kujtonte sa herë zërin e thellë të shtetit më të vjetër. Sipas ekzemplarëve historikë të ruajtur nga njerëzimi, të parët e tyre ishin lidhur me të njëjtën fije me të ardhmen, ashtu siç rilidheshin perënditë që u interesonte vetëm e ardhmja. Këta njerëz asnjëherë nuk kanë qenë metafizikë, shkruante historiani Giren. Çuditërisht ata janë qenie magjepsë, që dinë të dhurojnë vetveten.

- Oh, Zot, sa më ka marrë malli për vendin tim, - i tha atë mbrëmje Ertenit. - Më duket se ia ndjej frymën qysh larg. E çuditshme si ndodh me njeriun. Ndihem e pafuqishme larg tij.

Thuaqse për hir të artit jam mes gjendjes së humbjes, të përkushtimit dhe të mosikjes nga vetja. Erteni e mbështeti në gjoks. I miratoi fjalët e saj. Ata dëgjonin brenda njëri tjetrit, se kalimi nga njeriu tek toka përmblidhej si një rilidhje e vjetër e gishtërinjve me diçka të rëndësishme hyjnore. Ishte një e kuqe e vetvetishme si lidhja e mishit me gjakun. Ndonëse ishin të magjepsur pas Romës, arti

ishte një lloj energjie që i lidhët me gjuhën e njëjtë të tingujve. Ai qytet me orët e leksioneve, me restorantet dhe kinematë, me personazhet e panjohur, dukej si çdo e përditshme e një qyteti të huaj. Moskomunikimi me zërin e gjallë të atdheut të përjetshëm, që e kishin pasur brenda vetes, qysh ditën e parë kur lëshoheshin nga rëndesa e nënës, i bënte të mendonin se ishin të përkohshëm në atë botë. Diku sillej rrëth e rrötull hija e tyre. Sa herë kishte dëgjuar Ertenin të vuante nga brengat e thyerjes së vetes në dy botë të ndryshme. Referimi ishte një dashuri, e cila nuk ngjante me asnje lloj dashurie që kishte krijuar njerëzimi. A mund të jetonte njeriu pa një dashuri të madhe, apo duhej të bënte përpjekje të mblidhët ca dashuri të vogla që mund të jetonin vetëm për një çast?

Angjelinës i shkrepit në mendje aty në skenën e madhe të orkestrës simfonike, teksha dëgjonte muzikën e madhërishme të Beethovenit, ideja se njeriu dinte të mbijetonte.

Në fund të koncertit imagjinoi atë botë, ndërsa një botë tjetër ndjente peshën e dhimbjes. E shihte shpesh në ëndërr dheun e fjalëve të saj. Ai vegim i largët e shtynte të pyeste vete, pse zemra i dukej e ftohtë si të ishte jashtë qenies? E dinte, se atdheu ishte dashuria më e vjetër që kish hedhur rrënje qysh me lindjen e njerëzimit. Ajo kishte djegur shumë shpirtra nga dhimbja, kur të gjithë vraponin pas shpresës së mëdyshjes gati bosh në një botë tjetër.

- Janë vetëm kujtime e dashur, - i tha Erteni, kur ajo po rrëfehej para tij. - Njeriu nuk mund të jetojë pa kujtime, sepse ato ngjajnë me vizitorët e zemrës. Kujtimet janë mbretëria e shpirtit. Ato e bëjnë atë të vuajë, por dhe të jetë i lumtur, ndryshtë koha vdes ose humb në heshtje. Angjelina e ndjeu të domosdoshme të qëndronte pranë Ertenit atë natë të gjatë dimri. Mendonte, se kishte ardhur përkohësisht në këtë tokë të huaj të eksploruar qysh nga

historianët e shekullit të vjetër. Vetëm koha ishte e përjetshme. Fjalët vareshin si frytet e pemëve që zakonisht na pëlqen t'i provojmë. Ato lidhen nga dashuria e mëvetësishme brenda dashurisë së tokës dhe laksmisë së njeriut. Por udha e kthimit përmes yjeve ishte e lirë. Secili kishte një yll të ndezur para vetes. Erteni mbante në duar një tufë trëndafilësh të bardhë. Piste Angjelinën të mbaronte orën e leksionit mbi „Artin dhe muzikën e Verdit”. Dukej se ishte ringjallur nga larmia e akordeve të asaj muzike, që nuk dinte pse e krahasonte me shkrepimat e rrufeve.

- Të dua shumë, - i tha Erteni disa herë. - Do t'ia dalim me sukses edhe në këtë vend të huaj. Bota është e mirë. Jeta duhet jetuar. Njeriu mund të gjejë forca, për të mos u përulur para jetës, as para vetes. Ajo ndjeu krahun e ngrohtë të Ertenit, siç ndjente anija qetësinë e detit. Shpirtërat e tyre kishin një lidhje të dukshme, ngjitur me frymëmarrjen e njëri-tjetrit. Angjelina ishte e vetëdijshme se brenda vetes, në thellësinë ku përplaseshin lëvizjet e trupit të tij, ndodhej tërësisht brenda lirisë. Ajo nuk mund të shkëmbehej me asgjë.

Kur dielli po fshihej pas perëndimit, ata vështruan mbi bregun e kuqërremtë të qiellit krahët e hirtë të dallëndysheve që dukeshin së largu si lundërtare. Ato nuk i frikësonte as mjegulla, as një qiell tjetër. Ertenit iu kujtua forma e lëvizjes së tyre. Lart në pafundësi kryenin të njëjtin rit. Fluturonin si mërgimtarë dhe nuk harronin të ktheheshin sërisht në qiellin ku jetonin.

Në fillim të shekullit të humbur flitej për një shtet të vjetër që u zvogëlua, sepse ai ishte i myllur në vete. Dukej se shtetit i mungonte një pjesë e fytyrës, e trupit dhe e historisë. Ishte një humbje që i përkiste së shkuarës, ndaj njerëzit ndiheshin si të braktisur. Pamja e ikjes ishte diçka mizore. Ky popull që kishte pasur faraonët e tij, tashmë qe

lëshuar nëpër udhët e botës. Në secilin udhëkryq shihje hijet e mbetura të hapërdarë para syve të tyre. Njeriu me hark që ishte lidhur mes tokës dhe prijësit, klithte nga varri, se ai vend nuk duhej të mbetej lakuriq. Lajmet e fundit vinin nga fasadat e largëta. Ato flisnin për rrënime, plaçkitje e shkatërrime në ditët e ardhshme. Ishte e vështirë që këta njerëz të gjenin mbrojtësit e vërtetë. Karvanët, shkonin e vinin të veshur me diell, nën vetminë e gjelbërt. Zvarriteshin pa e ditur se kush ishte fundi i botës. Hapat e tyre i mëshonin tërheqjes së dheut. Kokën e mbanin të kthyer mënjanë. Dukej vetëm njëri sy që lëkundej mes vështrimit nga ditënata. Mbi majën e qiellit shfaqeshin hijet e stërgjyshërve dhe yjet e ndezur, mbi bregun e shpresës.

Detarët endeshin në detet e ngrohta. Teksa ngrinin spirancat e ftohta, shihnin një trup që varej krejt lakuriq me kokën të ngritur në çatinë e diellit. Në thellësi të frymës së mbetur, ai besonte se një ditë do të lindte prijësi i mirë ose ndonjë syresh tjetër, siç kishte lindur njeriu i madh që për një shekull mbajti në duar armën më të rëndë të botës. Në fund të fundit, kur para syve i shfaqeje liria e brishtë, ai bashkoi njerëzit dhe durimin e gjatë me frymën e të parëve. Pasardhësit kishin rendur të gjenin një çmim, të njëjtë me lirinë e tyre, që të kujtonin faraonët e shkuar. Nga minaret e Zotit secili lutej para tij, për një kohë më të mirë. Tek mëngjeset e së ardhmes, bijtë shihnin kokën e kthyer mënjanë të atdheut të ngushtuar. Ata njerëz e kuptuan herët se prijësit e kohës së mirë ishin më të pasur me liri se sa ideologët që kërkonin ta gjenin lirinë tek të tjerët. Të gjithë ecnin duke u luhatur në atë pjesë të rrizuillit, ku tregoheshin historitë e ngatërrimit të duarve. Ato futeshin në barkun e tokës së kafshuar, sikur të ishte prerë me një armë të imprehtë në copa-copa paralele. Ndërsa vizitonte muzeumin e paqes, Angjelina pyeti veten pse populli i saj nuk kishte mbrojtësin e vërtetë, apo prijësin e duhur? Sa herë ishte

shtyrë para kësaj pyetjeje, kur mund të merrej vesh se shkëmbimi i lirisë së një kombi përthyhej në rrëzimin e tij para së ardhmes. Kishte menduar shpesh se mbrojtësi më i mirë në tokën e vjetër ishin vetë njerëzit e asaj jehone, diku thellë brenda vetes. Ndryshe si mund të të mbronin kryqëzatat e të tjerëve? Ishte vetëm një përfytyrim i mundur që rrëzohej në një hendek.

Erteni kishte dëgjuar se njerëzit, të cilët i mungonin atij vendi, kryqëzoheshin brenda hapësirës së cunguar. Aty përplaseshin lëvizjet e kohës që kërkonte të rendte dhe të fshihej nga nemitja. Shteti më i vjetër i Evropës plakë ishte rrethuar nga një krizë e panjohur më parë. Lajmëtarët flisnin për një rrëfimtar, që mbante peshën e tokës, mbi trupin e njerëzve ku balta krahasohej me diçka të ëmbël. Grupe vizitorësh, nuk mundën thjesht për një sinjal të kohës të besonin, se dheu ishte një formë e shurdhër, që përkohësisht ndihej i hutuar para dëshirës së maleve. Flitej nën zë se flota e një vendi fqinj do të ishte mbrojtëse e privilegjuar që do ta shpëtonte më në fund llojin e fiseve të shqiptarëve, të cilët nuk pëlqenin të silleshin si bota tjetër. Fati nuk kishte dashur. Pasardhësit që pinin një pije të prodhuar nga fruti më i mocëm i asaj toke, u betuan se ishin gati të flijoheshin. Thellë erës së fjalëve dyshohej për një vdekje të afërt të lirisë së mbetur. Dikush që luante rolin e ndërmjetësit kishte thënë, se mbrojtësi ishte habitur nga pyetjet e marra, të cilat njerëzit i paraqitnin si ideale për qenien e tyre. Rastësia e pritjes së tij, qarkullonte në pikën më të largët. Zëri i lëshuar pa domethënje, tha se mes këmbëve, aty ku shquhej një natyrë e qetë po ngrihej një mur i varur mbi lëkurën e tyre. Bota tashmë ishte larg. Ata mezi e shihnin.

- Zoti e ruajtë lirinë time, - tha i mërzitur Erteni. - Gjithherë ka qenë me kokë të prerë. Modeli i saj është shfaqur mbi një tokë të ngushtuar nga përthyerja e mureve.

Angjelina kishte menduar gjatë atë mbrëmje për dilemat e shpjegimit të lirisë. Erteni i perceptonte ato sikur të ishin ca lëvizje të diktuara nga koha, të cilat qarkullonin mbi një qiell të errët.

- Nuk e di a pranojmë se e njohim vveteten, apo modelin e mënjanimit të kundërt? - i tha Ertenit, para largimit.

Ca hije me baltë të kuqërrremtë i silleshin nëpër mend. Hijet e jetës dhe të vdekjes së lirisë nuk kishin çfarë t'i lexonin njëri-tjetrit. Në ikje, ajo madje nuk e kishte ndier as puthjen e nxeh të Ertenit. Ndihej ende e ligështuar.

Natën kishte harruar dritaren hapur. Në mëngjes ndjeu dhimbje të gjymtyrëve. Nuk dinte pse në atë qytet të huaj shpikeshin mbrojtësit e lirisë, kurse heronjtë ishin të sigurtë se, liria i përkiste atyre që u mungonte.

**D**shte mesditë kur dielli u zhyt pas reve të hirta. Hyri me Ertenin në kafene "Liberta". Ajo ishte mbushur me studentë nga e gjithë bota. Piu një verë të bardhë, për ta harruar qiellin pa yje, i cili i kujtonte një enciklopedi të vjetër e të harruar. Historitë nuk kishin lindur, për t'u mësuar përmendsh, por për të treguar se forma e së shkuarës arratisej, për të thënë të vërtetën e së ardhmes.

- Unë di të pres një ditë tjeter, - i tha pranë veshit Erteni. U përkul ta puthte për ta bërë sadopak të harronte atë natë. Kishin lexuar diku, sekretet për sprovën e barrikadave të historisë franceze. Iu duk një llahtari të pranonte se humbja e lirisë do prekte dhe vendin e tyre.

- Oh, fat i keq, përsë e ndjek hijen time? - tha ajo me zë të lartë. Të gjithë kthyen kokën. Zëri i Angjelinës dukej sikur ishte zhveshur nga e panjohura.

Afroi fytyrën në xhamin e ftohtë. Vetëm disa këmbë e ndanin nga hija e një përbindëshi që po kërkonte të ishte shenjë e një historie pa trup. U bind se botës po i afrohej një shpërthim zhurmëmadh. Tej fjalëve të gjakut do të endeshin gjymtyrët e kufomave. Grisën disa figura nga një revistë me ngjyrë të blertë, e njëjtë me lëkurën e rrudhur të bretkosës së lumenjve, ku mbinin ca lule të zeza.

Nga lindja frynte erë e ftohtë. Erteni ishte në tarracën e katedrës së drejtësisë. Po hulumonte një pjesë të botës së ndarë. Zbriti prej andej në perëndim të diellit dhe hyri në

udhët e ngushta të qytetit. Ai po mbyllte dritaret e hapura, për të mos dëgjuar lajme të këqija. Më shumë të ngarkuar me shqetësimet e botës ishin gazetat. Aty qarkullonin ide nga më të çuditshmet. Lajmet nisnin që nga kriza e vajgurit e shkonin deri tek ndarja e kohës në ngjarje të zymta, apo të madhërishme. Nga larg vinte zhurma e detit, i cili dukej se përkthente valët. Angjelina nuk e kuptoi pse hapat e çuan në pjesën më të shkretë të qytetit, tek ndodhej kinemaja e vjetër. Në thellësi shihej kurrizi i zgjatur i Romës. Ndoshata nuk i pëlqeua ta kujtonte më ngjarjen e re të dëgjuar nga Erteni, rrëth mbikqyrësve të rinj të perëndimit. Ata si nëpër tym i afronin kurorëzimin e humbjes. Trurin ia kishte zaptuar një aktor i shkujdesur që nuk dinte të kërkonte fatin e tij. Ai priste midis turmës së njerëzve. Njerëzit nuk arrinin të dallonin mirë as shiun, as diellin, por vetëm prisnin e prisnin në një skaj të botës qumështin e bekuar të fatit.

Ndonëse kishte pllakosur një thatësirë e paparë ndonjëherë, dikush kishte propozuar se njerëzit mund të jetonin edhe me pështymën e vet. Në ditën më të keqe të pafajshmit në sy të njëri-tjetrit kishin ndërtuar kodin e tyre që e konsideronin si një zbulim, sipas mënyrës së paraardhësve. Megjithëse pjesa më e madhe e hijeve të ikura ishin zhdukur, ata e identifikonin veten me krijues të hartave të reja. Përveç një prirjeje të vetëmbrojtjes, ata kërkuan të përsërisnin historinë e të parëve. Ca thërrmija të së ardhmes, më vonë do i ngjanin një enciklopedie të përbotshme. Të gjithë shihnin një dritë në terr që kërkonte të zgjonte kohën më të lakuriqtë. Disa syresh më shumë përdornin heshtjen si mjet të zotërimit. Në mimikën e tyre të lexuar dyfish nga sytë e spektatorëve në gjysmëterr, nuk përdorej fjala, por zbulimi i një force të tepërt jashtë dhe brenda botës së ndarë. Angjelina kujtoi një histori të vërtetë të paraardhësve. Ata ishin sulur mbi telat me gjemba, dhe

mbijetuan duke shtyrë në det perandoritë me brinjë të thyera.

Ajo kurrë nuk besoi se në atë film, njeriu që kishte harruar lirinë e vet në një çmenduri të humbur, kërkonte lirinë e të huajve. Më në fund ishte grisur kureshtja. Brigjet kishin uri për t'u ushqyer me mishin e të tjerëve.

- Kam frikë, kam frikë, - përsëriti ajo dy herë me zë të ulët. U mbështet fort pas trupit të Ertenit. Nuk e di, por ky njeri me sy të mëdhenj, ku mungon jeta, është i rrëthuar nga vdekja. Ai, do ta shkretojë botën dhe shekullin.

- Zoti na ndihmoftë, që popullit më të vjetër të brigjeve mbrojtëse, të mos i bjerë kjo e keqe.

Ajo vështronte sytë e tij. Një shi fjalësh rrëzoheshin nën qerpikët e lagur që sajonin një statujë në lëvizje drejt qiellit të lyer me ngjyrën e zemrës.

- Po, po. - Ai njeri i çmendur me një njollë pa ngjyrë do ta djegë botën, - ia ktheu Erteni. - Eshtë e vërtetë që i përket racës së vrasësve, ku shpirti është i ndarë nga trupi.

- Pjellë e keqe, njeri pa zemër, - foli sërisht Angelina. Nëpër natë u ndie e rraskapitür.

Ishte pasdite vonë kur studentët e huaj, mbledhur në sheshin e lirisë dëgjuan zërin e përzier me zjarr nga idetë e zbulimit të një kohe tjeter dhe harrimit të së shkuarës. Njerëzit do të jetonin në një botë të formuar nga shkrirja e njëri-tjetrit. Deri brenda qenies jehonte klithma e fjalëve. E drejta nuk ekzistonte më. Ishte tkurrur në trupat e huaj që luftonin me paqen e ndaluar. Njeriu, i cili në vetvete i përkiste shkatërrimit si një hije ishte shfaqur në kufijtë e së ardhmes. Bota shihnte veten në fotografí. Kishte mbuluar fytyrën në zemër të asaj nate, kur dita ashtu si gjithmonë po tretej në tejpashmëri.

Në qill u shpërnda një shkarkesë e ndezur rrufeje që mbikqyrësit i kujtoi vdekjen e së shkuarës të lidhur me një pështjellë të bardhë. Në kërkëllitjen e rrufesë ndezi një

cigare, e cila po i digje gishterinjtë e ndotur. Me gishtin tregues në ajër foli për një botë tjetër, ku njerëzit mund të jetonin lirinë që e barazonte me paqen.

Kishte kaluar mesnata, kur Nora shoqja e saj e dhomës lëshoi një pasthirrmë. I doli nga shpirti me një fuqi lutjeje, sikur ajo thirrje të ndryshonte hapësirën e hirtë të qiellit. Ai i ngjasonte një të sëmuri. Gjithçka ishte lënduar brenda shpirtërave të tyre.

- O Zot, - na jep kurajo të ikim nga e keqja, - tha ajo. - Gjithë jetën na ka ndjekur hija e saj.

Angjelina i kishte fshirë lotët që i buronin nga akulli i asaj nate dhe në heshtje bëri lutjen e përditishme për shpirtërat e gjallë e të vdekur. Ajri në dhomë ishte ngatërruar me mendimet që lajmëronin se diku po frynte era e kufomave të reja. Ideja e ringjalljes pas njoftes së vdekjes mbi telat me gjemba i bënte zotërit e asaj toke të kthenin kryet pas, nën ngjyrimin e një shpate.

Nora pëshpëriti sërisht se botën mund ta ringjallte vetëm dashuria, e cila ishte energjia më e thithur nga njerëzit. Ca zëra të bekuar iu ngjitën në natën e ngrirë. Një zë i thërriste nga thellësia e botës. Fryma e lodhur e nënës u lutej se kishte ardhur dita të ktheheshin në tokën e dheut të kuq. Ishte një brengë që gjerryente zemrat e arratisura në kohë. Angjelina ishte në këmbë, kur pa nga dritarja shiun e hollë që ngushëllonte fasadat e gjelbërtë të Romës. Fytyra e atdheut i shfaqeje afér dhe larg. U ul gati e përgjumur në sallën e ftohtë të leksioneve. Profesori i historisë së arteve po fliste për triumfin dhe zgjimin e identitetit që i lejonte muzika lëvizjeve të reja në raport me sekretin e lirisë. Sipas tij muzika asnjëherë nuk kishte qenë e padukshme, por dinte të mbërrinte tek njerëzit gati e tejdukshme me fytyrën e së ardhmes e të së shkuarës.

Muzika ishte një hapësirë e të gjithëve. E çliruar nga dhimbja dhe urrejtja e heshtur, ajo tërhiqej pas dashurisë.

Largoi nga fytyra e zbehtë kaçurrelat e rrëzuara që i rrëshqisnin mbi supe. Mendoi për Ertenin. Kishin jetuar një dashuri me përfytyrime të ndezura për jetën. Ajo lidhje krejt magjepsëse shndërrohej në forcë, për të arritur brenda zemrës nëpërmjet përfytyrimit të dritës së brendshme.

- Përse të rraskapitemi si hijet? - tha me vete Angjelina.  
- Përse?

I ati i shkruante se dimri i atij viti kishte qenë shumë i ftohtë dhe pranvera kishte harruar të vinte. Megjithatë dashuria për ty na mban gjallë, shkruante ai në sipërfaqen e lëmuar të letrës që asaj i dukej sa sipërfaqja e atdheut. Gjithçka mbetet thjesht një kujtim mendoi, para se të habitej që i ati, i cili i kishte blatuar hyrjen e jetës nëpër genet e tij, të besonte se jeta tjetër ishte në fund të qytetit të lagësht.

Po dëgjonte fjalët e premtimit të Otellos, kur ai kishte pranuar fajin, pas humbjes misterioze të Desdemonës. Gishtat e saj luanin mbi një fashë drite tingujt e mbrëmjes së dashurisë. Dukej se po i ngjiteshin kockat e thyera të trupit. Ishin ndezur rrezet e zhytura nën re. Këmbët po e çonin kudo, sikur të ishte në një krizë. Për fat të mirë gjithçka fillonte nga fillimi, si agu mes tokës dhe qiellit, dashuria, jeta dhe ringjallja. Ajo nuk kishte frikë nga asgjë, megjithëse jeta ishte ndarë me mure.

- Ah, por jeta është e lidhur me vdekjen, - tha më në fund profesori, në mbyllje të leksionit, për kontrastin mes artit dhe lirisë.

- Vetëm trupat ikin nga kjo botë. - Për fat të keq Bethoveni vdiq. Muzika e tij mbetet. Në fund të fundit, ajo jeton.

Angjelina kishte menduar shpesh për koncertin që i kishte propozuar maestro, i cili ndihej i shqetësuar vetëm brenda botës së tingujve. Asgjë nuk mund të mbretërojë në botë më shumë se fryma e tyre, thoshte gjithmonë para

studentëve. Njeriu mund të rijetojë tërësisht nën pushtetin e asaj bote. Profesori i violinës, tha se kishte zbuluar tek ajo shndërrimin e tingujve në magjinë e thellë të erës njerëzore. Sipas tij asgjë nuk ikte drejt vdekjes, përkundrazi gjithçka ringjallej. Për fat të mirë bota rrotullohet rrëth jetës dhe jo jashtë saj, foli ai duke mbyllur leksionin. Mos harroni...

Në fillim kishte pasur drojtje nga mirënjohja e tij e çuditshme. I druhej më shumë vetes se sa epokës që kishte mbijetuar me tingujt e muzikës së gjallë. Atë çast mundi të imaginonte një fytyrë konti ose konteshe, apo vështrimin e një aristokrateje të mekur nga heshtja para një bote tjeter që kishte padronët e vet. Muzika është një sprovë. Ajo gjithmonë nis nga fillimi, i kishte thënë shpesh e éma. Ka shijen e ëmbël të buzëve të dashurisë dhe lind nëpër èndrra.

- Italia mbetet aq sa një çizme, - zbrazej sa herë mërzitej Nora, e cila studionte për mësuese. Ishte një vajzë e bukur. Për çudi Angjelina besonte se të gjitha mësueset ishin të bukura. Pamja e tyre i kishte mbetur një model i bukurisë fizike dhe shpirtërore qysh nga mësuesja e klasës së parë. Ajo e kishte frymëzuar t'i kushtohej artit, pasion i cili e kishte pushtuar tërësisht.

Angjelina mori një pamje të shqetësuar, kur e pranoi idenë e profesor Andreas për koncertin. Maestro kishte pamjen e një njeriu melankolik që i përulej në gjunjë vetëm muzikë si të ishte një shenjtëri. Vitet e rinisë i kishte kaluar në Paris. Kishte marrë nga francezët dinjitetin, të cilin e vlerësonë si praninë e vetë njeriut. Ndoshta për këtë arsy, ai mendonte se artistët ishin qeniet më të padjallëzuara të botës. Ata jetonin të zhgënjer në ishullin e shpresës së tyre. Sipas tij, muzika nuk e kishte ngatërruar asnjëherë botën, por vetëm e kishte ringjallur nga vdekja. Mirësjellja e Andreas, së cilës nuk i mungonte asgjë, shfaqej qysh nga

sytë kafe të butë e deri në adhurimin për lulet që i krahasonte me buzët e një gruaje.

Ishte e hënë, kur ai e ftoi Angjelinën për një lajm të mirë pa i shuar kureshtjen.

- Eshtë një talent, - i kishte thënë kolegëve të tij. – Se ç’ka një çelës në shpirt që e hapin vetëm gishtat e saj.

**K**ur hyri në apartament, Nora i hakërrehej vetes se ishte e shkujdesur kohët e fundit. Kishin filluar t'i zbeheshin fjalët nga reflektimi i mjegullës në dheun e huaj. Kujtimi i mëmëdheut i vërvshonte mbi mallin e djegur dhe ankthin e kthimit. Gjithçka ishte brenda saj. Jashtë ishte vetëm era. Në thellësi të vetes kishte krijuar „mitin” e mësuesit „si njeriut” të dërguar nga Zoti, sepse fëmijëria kishte lidhje shumë të ngushta me këtë mit. Në bardhësinë e fytyrës së saj ndriste një buzëqeshje në zbrazëtinë e atij vendi të huaj që mbahej mbi kolonat e shkuara. I ngjante, se aty i mungonin ca gjëra thelbësore qysh nga realiteti e deri tek sytë e shpirtit të nënës që e vështronin nën qiellin e ngushtë.

Mendonte shpesh se njeriut dikush duhet t'ia ndriçonte udhën dhe ta paralajméronte për të keqen. Ndaj një mëngjes të hëne, kur shkoi në klasën e parë fjalë mësuese i mbeti në buzë.

Këtë fjalë e përsëriste me zë të lartë para të gjithëve si lutje për të ardhmen. Ende mendonte atë detaj të vogël, që e kishte shtyrë të udhëtonte mbi një ëndërr të vetme, atje në tokën e të tjerve e të çapitej nën ndjenjën e bërë njësh me veten.

- Po, - i tha në mbrëmje Angjelina. - Dikush duhet të bëhet udhërrëfyes i njeriut, për ta çuar drejt së mirës. Eshtë virtyt i njerëzve të mëdhenj, për t'ia dalë mbanë një ndjenje të tillë.

Angjelina u zhyt në ujin e ngrohtë dhe doli prej andej duke fshirë gërshetin që i kapërcente mbi supet e bardhë. Ndjeu të dridhura në trup, por mendoi se i ishin afruar emocionet e takimit me Andream. Mbylli për pak minuta sytë. Njëfarë shkëlqimi i dritësuar i afronte kënaqësi të madhe, diçka përvëluese që e përpinte deri në dhimbje.

Kur doli në rrugë e rrëmbeu ideja, se si po shkonte në atë takim konfidencial pa e lajmëruar Ertenin. Do t'ia bënte surprizë lajmin e koncertit që e kishte ëndërruar me kohë.

Profesor Andrea po e priste në hyrje të teatrit të operas, veshur me kostum gri. Dielli përshkonte ende për çudi xhamat e errët të teatrit. I pëlqeu ta kishte brenda vetes atë diell që përpiquej të ngrohte sado pak ditën e ftohtë. Dimri gati po çorientohej mbi kurrizin e zgjatur të pranverës. Gjethet e blerta të akacieve shpërthenin duke rrëmuar mbi dritën e zgjuar. Pikërisht atë moment kishte në mendje fytyrën e nënës që i shfaqej sa herë ndihej e vetmuar.

- Eshtë thjesht ajo që quhet lidhja e shpirtrave, - i tha Andrea sapo preku sytë e saj. - Natyrisht është e drejtë t'i duash paraardhësit. Ata janë zotërit tanë.

Drita kishte filluar të mbyllej nën ngjyrën e trëndafiltë të sallës së koncerteve. Angjelina ndjeu një valë që lëvizte nga bregu i një bote tjetër. Orkestra luante nën ritmin e zotërimit, simfoninë e Antonin Dvorzhakut "Bota e re". E pushtoi hapësira e madhe e tingujve të skenës, në të cilën mbretëronte liria. Për një çast harroi gjithçka, ditën e ftohtë, diellin përtëritës, apo krizën e fundit që po i turrej botës. Kiske pasur nevojë për të jetuar e shkëputur nga brendia e shembur mbi veten. Ajo ishte zgjuar në kohën e dritës. Qysh kur ishte tetë vjeçë, e ëma e saj, Leonora, një grua e pashme vieneze, e lidhur me natyrën dhe artin, hapte dritaren, kur dëgjonte muzikë. Shtëpia e ngritur sipas stilit të vjetër, me mure guri i ngjante më shumë një kështjelle të pushtuar nga tingujt. Ato zgjasnin pafund zbulimin e

përtërirë të jetës, për të harruar kohën e ikur. Ishte dashruuar me të shoqin, kur kishte parë figurën e tij në pasqyrë.

Gjithçka kishte ndodhur rastësisht. Njohja me një të huaj që jetonte në një vend krejt të panjohur pér të, kishte ardhur, thjesht siç dinte të vinte dashuria. Ajo nuk kërkoi të prishej kjo lidhje dhe as të lëkundëj dashuria mes tyre. Ishte kthyer nga një udhëtim nëpër Evropë. Të nesërmen, - i tha Françeskos se i pëlqente të martohej me të.

Fytyra e saj ndriçohej nga një dritë e brendshme që shpërndante buzëqeshje prej dielli. Nuk mori shumë sende me vete. Ishte krejt e qetë, kur la atdheun. Me një anije mallrash në krahët e Françeskos, nën një qiell blu të errët, preku tokën e panjohur, të cilën e mbështillte dielli. Angjelina, ishte fëmija e vetme e Leonorës. Dukej se e kishte hedhur të kaluarën e saj, nën një qiell tjetër që e barazonte me harkun e jetës. Ishte kthyer më në fund në ngjyrën e kuqe të asaj toke, e cila i ngrinte në shpirt valë dashurie. Ajo e kuptoi atëhere pse e ëma përkëdhelte fytyrën e së bijës. Ishte një ndjenjë tërësisht e shkrirë brenda pushtetit të mëmësisë. Dëshira e saj ishte shndërruar në një èndërr reale në cepin e vogël të botës. Madje i dukej e njëjtë me tërësinë e dashurisë, e cila nuk i njihte kufijtë e dhimbjes. Zgjohej çdo pragdite brenda një lumturie të domosdoshme, tek shih te lëkurën ngjyrë rozë të së bijës. Mbështeste kokën në supin e Françeskos. Ai i besonte forcës së saj. Kishte jetuar jashtë vetmisë së kohës emocione të trazuara dhimbshëm në skajin e atij vendi, ku frynte era e vërtetë e jetës së tij. Leonora ishte e vëtmja grua që i jepte frymë.

Angjelina i largoi kujtimet e kohës së èmbël. Pasioni i dashurisë pér jetën iu bashkua me dashurinë pér muzikën si bota e vetme pa konflikte.

Profesor Andrea e pa se ajo po mendonte pér të nesërmen. I ishte dorëzuar asaj bote të mbushur me shpirtra të bukur që e çonin njeriun tek Zoti.

- Eshtë një simfoni me frymë të thellë njerëzore, - iu drejtua Andrea. - E di që këtu nis e ardhmja. Muzika të çon në një botë të stërmadhe, i kukohej një thënie e së emës. Çuditërisht ajo fliste për gjithçka vetëm një herë e nuk përsërliste shpesh të njëjtat gjëra. Ishte një grua e zgjuar që mbërrinte atje ku kërkonte vetë, pavarësisht së në ndonjë çast mqedisi i dukej i zbrazët. Kurrë nuk i kishte shkuar ndërmend të harronte rrënjet e ngjitura pas trupit të saj, por kishte frikë se mos e bija i trembej së ardhmes atje në botën e huaj. Netëve lutej për Angjelina duke thirrur engjëllin mbrojtës. Gjuha e brendshme që e këmbente vetëm me ashtin, nuk ishte asgjë tjetër, veçse fitorja e dashurisë së përbotshme.

- Pernjëmend, kam fituar një shpirt, - i thoshte shpesh Françeskos.

Profesor Andrea e kuptoi atë mbrëmje se Angjelina "po vdiste" për ata tinguj që mund të krijuar një herë në jetë. Zemra e saj po kalonte çaste të reja nga fryma e lirë, të cilën e kishte krijuar njeriu. Dhe nuk dinte pse u ndie e hutuar, kur i tha Andreas se muzikën nuk e ndërronte me asgjë tjetër në botë. Ajo i ngjasonte diçkaje të çmuar që zgjonte jo vetëm jetën, por një frymë mbijete që të dhuron kohën e panjohur, ku eksposohej vetja. Muzika për të ishte qendra e rëndesës, ku bota e ngjinjur nga urrejtja, kishte kthyer kokën pas të shihte se si njerëzit i mëshonin lakmisë, për të mbetur një spirancë në brigjet e tokave të djegura. Drejt jetës po humbiste udha që të conte në horizontin e zemrave.

Mezi priste të takonte Ertenin, për t'i treguar tundimin që ende po e mbante të mbyllur në qenien e saj. Ishte rrëmbyer pas atij koncerti simfonik si të qe një shkëmbim i vetes me lirinë e një bote, midis lëvizjes e përplasjes. I zbrazi para Ertenit të gjitha emocionet, sikur me atë njeri nuk do të shihej më kurrë. Ndjeu frymëmarrjen e tij në

tingujt e simfonisë „Bota e re”. Ai e mbuloi me puthje që i preknin buzët e uleshin drejt pjesëve të zbuluara të trupit.

- Mendoj se muzika mund ta sfidojë këtë kohë të mbrapshtë, - i tha Ertenit, ndërsa buzëqeshte me teorinë e të tjerëve, predikuar qysh nga lindja e tingujve.

Ai e dinte, se ajo jetonte brenda atyre çasteve të lumtura dhe dalëngadalë do të arrinte të bukurën, sepse i ishte dorëzuar tërësisht jetës.

**N**ë fillim të javës profesor Andrea e njoftoi përsëri. Tashmë nuk ishte në dilemë për të ardhmen e saj. Madje ndihej i lumtur që ajo i kishte hapur vetë dyert drejt lidhjes së përjetshme me muzikën. I dukej se po bënte udhën më të përsosur në jetë, mbi të cilën kishte ëndërruar. Muri mes saj dhe botës ishte shembur pikërisht, kur ajo do të luante në violinë pranë orkestrës së operas, duke u çliruar nga ankthi i vetes. Në mbrëmje shkruajti gjithçka në librin e saj të kujtimeve, që për çudi e quante libri i luleve. Vetë qenia njerëzore për të jetuar në lartësi ka të drejtë të ngjitet nëpër shkallëzat e pambaruara. Jeta nuk kishte dy kohë, por një kohë që formonte historinë e secilit.

Vjeshta nën një diell të verdhë, kishte përzier gjethet e lakuriqta që kishin mbetur të shtrira në rrugë. Trëndafilët përmes grilave dukeshin të stampuara në copën e hënës së qetë si miq të njobur. Nata kishte filluar të zvogëlohej. Angjelina parandjeu dimrin e lagësht si katër dimrat e kaluar. Pëllumbat përshkonin qiellin paqësisht, sikur donin ta shkëpusnin prej errësirës me gjuhën e tyre të mësuar në tokë.

E ëma i kishte shkruar sérish. Ndihej e lumtur që e bija ishte kthyer në një besimtare të simfonisë “Bota e re”. Ndoshët do të jetojë një botë ndryshe, lutej ajo për të me dashuri. Ditën e parë, kur emri i përflytej në grupin e orkestrës së teatrit të operas, Angjelina falenderoi maestro

Andrean. Ndjeu një si shkarkim rrufeje në sy ku po i bulonin lotët. Ndriçimi i brendshëm zbulohet deri në përfytyrimin e ndezur për një botë tjetër. Pak njerëz dinin për origjinën e saj. Një vend i afërt apo i largët, me të njëjtin det. Ata preknin krahët e njëri-tjetrit me velat e valëve, të cilat e shuanin etjen në bregun e lagësht. Në fund të javës, Angjelina do të interpretonte pjesë të njoitura të klasikëve botërorë të muzikës. Nga ajo ndjenjë e çlironte vetëm ideja se do të kishte sukses. Tashmë i kalonte mbrëmjet nën rrezet e nënshtruara të dritës. Ajo shfaqej me delikatesë nga harku i magjisë së skenës e deri në zemrat e njerëzve që arratiseshin pas tingujve. Ishte kthyer në një personazh të njojur në qytetin e huaj, i cili ishte i frymëzuar nga muzika më e famshme e botës. Madje dukej se qyteti kishte qenë më i interesuar për Verdin, Beethovenin, Listin, sa ftyrat e tyre i ndriçonin udhët. Disa herë përjetonte sprovën e përkryer të ndjenjave të muzikës mbi humbëtirën e kohës. Kjo do të thoshte se ekzistonte dhe e përbotshmjë e të gjithëve. Angjelina kishte çaste që ishte brenda mureve të vetes, kur Erteni predikonte se tek njeriu kishte ndjenja të tjera më të mëdha që e lidhnin me jetën. Ishte e pamundur të mos besoje pushtetin e mirëkuptimit të tij.

Bota nuk mund të mbrohej vetëm nga tingujt e një kohe të përbashkët, që kishin një ritëm të përbashkët, por nga një liri e përbashkët që i mungon kësaj bote të mallkuar.

Angjelina heshti pas shijes së atyre fjalëve. I ishte dukur se Erteni e kishte lënduar kuptimin e ndritshëm të gjysmëbotës. Ajo mendoi se ishin fjalët e dikujt tjetër, siç përhapeshin në ajër zërat përtej dritareve të hapura.

Qielli si një peshqir i lagur fshinte natën e thyer në copa të errëta. Pas kurrizit ndjeu një dorë që e pështillte në gjumë. Ato duar ngriheshin në ajër si hijet e shkopit të dirigjentit apo maestros siç i pëlqente ta quante Andrean.

- Angjelina D. do të interpretojë në violinën e parë koncertin simfonik "Bota e re" të Dvorzhakut, - tha krejt i qetë Andrea mëngjesin e ditës së re. Ishte një ndenjë, e cila i pëershkoi gjithë qenien. Ajo besonte se një gjë e tillë nuk do të ndodhë kurrë. E dija që Angjelina D. ishte e denjë për një koncert të tillë. Unë nuk e di nga bie vendi i saj i vogël me emrin Shqipëri. Di që deti matet me milje, njoh botën e madhe të lirisë. Muzika është reale, zoti Erten S., nuk është imagjinare. Angjelina kishte ngritur supet e befasuar, kur Andrea kishte thënë se vitet e jetës i kishte kaluar nën pushtetin e muzikës dhe jo të hartave të vizatuara nga gjeografët. Diku pati dëgjuar për një hero të paarrithshëm që kishte dëshiruar të bashkonte atë vend, por koha rrëshqiste si rëra. Evropa e vjetër mbante të njëjtin tatuazh.

Erteni vështroi çdo pjesë të fytyrës së Andreas. I tha, se ai hero quhej Gjergj Kastrioti dhe se për herë të parë i kishte takuar shqiptarët me lirinë.

- Evropa, ah Evropa, na ka dënuar të jemi pjesë të ndara nga njëra-tjetra. Njerëzit udhëtojnë drejt tokës së tyre, maestro, - tha më në fund Erteni, duke u larguar.

Andreas iu bë se shihte skajin tjetër të botës. Ishte brenda syve të Angjelina D.

Kur hyri në apartament, Nora që dinte të dallonte ndryshimet, kishte humbur në vështrimin e fotografive. Ajo herë pas here lexonte sytë e gjelbërt të saj.

- Po jeton një èndërr Angjelina, një realitet të shpirtit, - i tha ajo duke parë qelqnajën e hedhur nga qielli prej drite.

- Me siguri të pret një e ardhme e madhe.

- Nuk është èndërr të kërkosh vetveten, - iu përgjigj Angjelina. - Eshtë një domethënie për të arritur tek të tjerët.

- A thua do të rilindim edhe ne një ditë brenda këtij qytetërimi, - pyeti duke shkëmbyer fjalët që i dukeshin se takoheshin brenda asaj hapësire të huaj.

- Në maj do të interpretoj me orkestrën e teatrit të operas së Milanos, simfoninë “Bota e re”. Kjo është e gjitha, - përsërithi Angjelina e qetë. - Bota një ditë do të jetë më e mirë. Duart e saj nuk do të jenë të ftohta.

Atdheu real që përcaktohej si zemra e kontinentit të vjetër, kishte mbijetuar duke u mbrojtur nga ndërhyrjet e fuqive të tjera. Pra ai kishte lundruar brenda dashurisë. Nuk urrente askënd. Madje asnijëherë nuk i kishte dashur kohët e mallkuara, ku liria kafshohej nga vdekja. Metamorfoza e zemrave të lira u prish, kur në fund të shekullit të ri, ca hije të zeza iu vërtiten rrrotull Evropës.

Mbikqyrësi ishte acaruar nga kriza e pushtimit të brigjeve të vogla. Atëhere kur dita ishte e gjatë sa nata, oborrtarët e tij rrëmbyen çfarë mundën dhe u larguan pikërisht, kur nata u bë më e shkurtër. Kishte dashur Zoti që populli i dënuar të flakte në detin e mbushur me urrejtje, mizorinë e një ushtrie të huaj. Në bregun ku frynte era ishte rrëzuar heroi i parë. Ai u mbulua me rërën e kuqërrëmtë e të virgjër, që më vonë u mbush me kufoma të djegura. Reporterët kureshtarë kishin fotografuar ngjarjet. Ata shkruanin, se ata njerëz nuk ishin gjunjëzuar, por vetëm ishin mbrojtur. Fjalët bardhë e zi ishin brenda syve të tyre. Gjymtyrët e përgjakura nëpër bregun e detit nuk kishin kërkuar tjetër, përveç paqes. Për fat të keq kishin marrë si shpërblim vdekjen e ftohtë.

Në mëngjes shteti nuk e kishte ndjerë lindjen e diellit të zakonshëm. Vetëm një copë e egër e ditës rrëthonë rrezet e humbura nga krismat e natës.

uart e Angjelinës prekën xhamat e ftohtë të dritares. Agu po shkundte dëshpërimin e natës së poshtëruar. Secili përfliste atë ditë të lagësht prilli, si një ditë pa dritë, apokaliptike që sipas prijësit të kombit usurpator quhej dita e fitores.

Bregdeti i bardhë që jetonte nën hijen e diellit thërriste me një zë të ikur fëmijët e vet ngarkuar me torba të gjata, ku kishin futur dhe hijet e tyre. Dallgët përplaseshin me një zhurmë të padëgjuar ndonjëherë me brigjet. Mbi trupin e tokës rëndonin mijëra këmbë në ca çizme të zeza duke thyer guackat. Disa syresh madje ishin parë të veshur me rroba banjo, për të shijuar atë ditë të çuditshme prilli që mezi arrinte mbi valët. Nxirrnin ca kuleçë të vegjël dhe i flisnin njëri-tjetrit me zë të lartë si fëmijë. Njerëzit tregonin se tokën e kishte rrëthuar një insekt në formën e merimangës së kripur. Ajo prekte konturet e përveshura të brigjeve. Askush prej ushtarëve të huaj nuk pranonte, se kishte vjedhur paqen e atij vendi që mbështete kryet mbi degët e diellit. Ata nuk do të ishin clirimtarët e asaj toke, por vetëm një trup i rëndë, i cili rëndonte mbi lirinë e të tjerëve. Pikërisht, ajo ditë ishte shkëputur nga mesdita. Në breg frymonte era e një beteje që ndante në mes hapësirën e rilindjes e të vdekjes. Njerëzit kishin mbyllur të gjitha dritaret. Të gjithë pinin një duhan të fortë mbjellë nga paraardhësit dhe ishin zgjuar të thinjur. Ndjenin mbi

peshën e tyre ditën më të tmerrshme të zbulimit të vvetes. Në njëmijë e një netë arritën të zbulonin se duhet të përdornin brinjët, për të mos u përkulur kolona e pasardhësve. Një gur i rëndë u ishte mbështjellë rrëth grykës. Në altarin e braktisur të qytetit endeshin ushtarë, të cilët shpërnguleshin përtëj detit. Ata që besonin se në atë vend kishin sjellë paqen, nuk u kishte shkuar në mend se do të prisnin vdekjen.

Angjelina ndjeu se qenies së saj, i mungonte edhe koha, edhe lëvizja. Dukej krejt e vetmuar. Kërkonte nëpër udhët e ngushta pjesën e gjallë të qytetit, i cili ishte zhytur në terr. Atje kishte ndodhur një marrëzi. Toka e të parëve ishte gëlltitur e braktisur nga thonjtë e vdekur të mishit të mbijetesës. Errësira i derdhej mbi trup dhe i hynte deri në jetën e shpirtit. Ertenin nuk e gjeti askund. Pa vetëm hijen e tij të barabartë me hidhërimin. U ul në një bar të zbrazur. Nëpër tymin e turbullt kërkoi të pinte. Kishte ftohtë, megjithëse prilli tërhiquej si një grua e çalë, e lodhur ngajeta. Nuk dinte pse brenda vetes kishte një ankth, i cili i shfaqej në të gjithë pamjen. E shkujdesur mbështeti kokën në murin me lule të zeza. Çdo të bënte nesër? Do të qëndronte apo do të ikte për t'u bashkuar me qenien e ndarë prej shpirtit. Hapat e kishin çuar në shtëpinë e profesor Andreas. U tremb kur pa portretin e tij të ngrirë. Trupi gati po i shembej. Ai e kapi rrëth mesit. Iu lut të qetësohej. E uli mbi një ndenjëse të butë pranë vetes. I dhuroi frymën e dashurisë, kurse ajo ndihej e vdekur. Ishte një ngatërrresë e humbjes së lirisë. Andrea kërkonte lëkurën rozë të mishit të saj. Ndjeu t'i ikte nga duart.

Të nesërmen ajo nuk u zgjua. Vazhdoi të vdiste pak nga pak. Andrea e pa të luante violinën e parë në simfoninë "Bota e re". Pastaj, pastaj. . . kishte rendur si e çmendur udhëve të qytetit, duke kërkuar Ertenin. Diku nuk e pa më as hijen e tij. Roma ngjyrë hiri i ngjau me një trup të

molepsur nga errësira. I kujtohej thënia e profesor Andreas, se brenda vetes i mungonte udhërrëfyesi. Ajo kujtoi sovranin e saj. Edhe ai vuante nga mungesa e tij. Kishte humbur brenda asgjësë.

- Ne prandaj shkojmë në toka të huaja, për t'u bërë udhërrëfyes të së ardhmes, - i tha Andrea duke e afruar më shumë.

Angjelina bëri një lutje, tek shihte sytë e tij të mendueshëm. Rrotulloi dorezën e heshtur të derës së dhomës. Si në një ekran pa kohën e hirtë, ku nuk shfaqej asgjë. Jeta frysonte në miniaturë. Një gojë e hapur çirrej duke kërkuar vveteten. I ngjau me një manekin të vogël, mbi dy taka të gjata trupëzuar rrëth viktimave të veta.

Më në fund kishte heshtur. Fytyra dyngjyrëshe e Andreas ishte harruar. Erteni, ripyeste veten, në do ta shihte hijen e Angjelinës pas simfonisë „Bota e re”. Kishin humbur nëpër natë. Ajo jetonte ende në ëndërr. Prekte tingujt për të shëruar rrënojat e botës. Në kujtesë i sillej një shpirt i madhërishëm. Ishte pjesë e shpirtit të përbotshëm që ëndërronte një kohë ndryshe.

„Bota e re” i shfaqeji si grua shtatzënë. Ajo priste të lindte një fëmijë tjetër, që kishte për Zot pushtetin e lirisë. Lexoi pas mesnate vargjet e Shekspirit. Otello, lutej për t'i bërë sfidë vdekjes. Një endacak publik rrëfehej nëpër natë para shenjtit të tij për forcën e vvetes.

Drita ishte derdhur mbi terrin. Angjelina veshi një fustan të bardhë. Pjesa tjetër e skenës qe veshur me kostume të zeza që nxinin nën dritën e trëndafiltë. Idetë romantike të maestros, pasi ishin ndarë në shtojca të zeza e të bardha, sundonin mbi dritën, ashtu si lulet e shpëtuara nga harresa.

- Dreqi e mori, - tha Angjelina. - Pse ngjyrat ngatërrroheshin me njëra-tjetrën? Hijet e zeza thërrmoheshin, nëpër tingujt e violinës.

Ajo lëshonte ca klithje që luteshin pér dashuri. Thellë vërvshonte rikthimi i lirisë së humbur. Tingujt ishin përhapur nëpër botë, pér t'u kthyer në forcë me trajtën e tyre. Jeta nuk ishte një zë në ajër, por një ikje nëpër dritë. Publiku shpërtheu në duartrokitje. Angjelina kishte tronditür natën e zezë dhe botën e ndarë më dysh. Tingujt ishin shpérndarë rrëth bardhësisë së shpirtrave duke shpërbërë ngjyrën e zezë të vdekjes. Dëshironte që ajo natë të mos kishte fund. Ndenji zgjuar deri pas mesnate. Të nesërmen mbante në çantë revistat me fytyrën e saj.

Anija e vogël po i afrohej tokës së lagësht. Paraardhësit ishin të gjithë të rrethuar nga frysma e pasardhësve. Ajo ra në gjunjë sikur të ishte një Zot i përhershëm para asaj toke. Dëgjoi zërat e të parëve. Në duar mbante trëndafilë dhe prekte sytë e nënës që ndiheshin të lagësht si bregu i detit. Grimcat e thërrmuara të yjeve rrëzoheshin mbi fytyrën e saj. Natën vonë ndezi qirinjtë pér të kujtuar edhe njëherë Erten S.

# J

ulia po kalonte verën e nxehtë nën sytë kureshtarë tē njerëzve, sidomos tē adoleshentëve. Kishte interpretuar nën filmin "Vdekja e kristaleve" dhe në tetor ishte shpallur fotomodelja më e mirë e vitit. Dukej sikur jetonte një kohë nën pushtetin e famës. Të tjerët mendonin se karriera e saj ishte një përkushtim ndaj vvetes. Tashmë ishte bërë bukuroshja më e njobur në faqet e revistave tē modës. Fytyra e saj përdorej në ekranet e televizioneve për reklamat e linjave ajrore dhe kutive tē medikamenteve kozmetike.

Atë mëngjes njerëzit kishin dëgjuar me habi se në muzeun e së shkuarës ishte parashikuar një vdekje tjetër. Producentët që endeshin pas marrëzive tē tilla e kishin ndryshuar ngjyrën e kontureve të tij nga gri në një ngjyrë të përzier blurozë.

Në fillim muzeut i vunë një maskë. Ajo shërbente, më tepër, për të afruar pasardhësit që të shihnin në pallatin e mermertë hijen e një ëndrrë tē përhumbur. Hija kishte mbetur deri në mendjet e shërbyesve, të cilët në atë kohë tē vështirë shpérndaheshin nëpër cepat e pajetë, duke u lутur fshehtas për ikjen e shpirtit tē keq.

Arkitektët ishin përpjekur që kur njerëzit tē vizitonin muzeun e vdekatarit, tē bënin tē besueshëm ekzistencën e padukshme, fshehur në muret e qelqtë. Skulptorët vazhdonin tē ngrinin dimensionet e bustit deri afér tavanit dritësor, ku hija **ngjitej** pas kristaleve. Fëmijët në fillim

shkruan ca hartime me tema të lira, si përshembull, «Vdekje s'ka», «Harresa është vdekje», «Koha nuk vdes», e të tjera. Nxënësit e zhytur në fraza të përbajtura ishin trondituri nga shprehje të tillë. Ata imagjinonin se pranë bustit gjigand të vdekatarit ishte mirë të mësonin notin afër pishinave të vogla, ku ravizohej hija e tij nën një ngjyrë uji. Madje, apo dilnin të lagur, shkruanin emrat e tyre në trupin e hijes e nënqeshnin të eksituar. Kur mori vesh ngjarjen sozia e vdekatarit, e cila çuditërisht ishte një qenie as burrë, as grua u kthye nga e shkuara. Në mungesë të tij ndërhyri që muzeu të pësonte një ndryshim: Të kthehej në një piramidë, ku në majë të dukej ringjallja e vdekatarit, ndërsa tek shkallët të shfaqej vdekja. Më pas sozia kishte pozuar për piktorin më të njobur në muzeun ku ndaheshin epokat e lulëzimit të shtetit me një paruke të thinjur në krah të burrit më të fuqishëm, para pesë shekujve. Aty ende shiheshin me sy gjurmët e kalit ndanë kështjellës. Teksa fantazonte për origjinalin e vdekatarit, sozia e arratisur fizikisht nga hija e tij, predikoi se dimensioni i paraardhësve nuk pranonë heronj të paqenë në asnjë muze apo gur. Vdekatarri sipas kronikave kishte qenë ose një fallxhor i fshehur në mjegull, ose një prerës kokash brenda të cilët përzihet era e gjakut me pjesën tjetër të trupit.

Megjithatë nxënësit e klasave të para ishin më shumë të mahnitur të shihnin pishinat e lidhura me kristalet, sesa për bëmat dhe kujtimet e mbeturë në maninë e të qenit hero. Disa syresh prej tyre shpikën mënyrën më të lehtë, për t'u ngjitur në majë të piramidës. Hoqën këpucët dhe çorapet për t'i shëndetësuar rrëshqitjes mbi mermerin e kuq, pastaj këmbëzbathur prekën çatinë e qelqtë të piramidës. Në majë të saj, vdekatar takohet me diellin duke i besuar ringjalljes. Ai ishte parë disa herë të luante rolin e profetit. Ende kërkonte të mbaheshin gjallë muret e shtetit të heshtur që jetonte i ndarë nga pjesa tjetër e botës.

Shitësi i qumështit, një burrë i shkurtër çapitej udhëve të shtetit të përhumbur. Ai ngjante me një qenie si vetja. Shfaqte dhëmbët e tij të mbetur nëpër dimrat e akullt. Nën qiellin e nxirë kishte britur se gati po çmendej në shtetin e vet.

Julia nuk e kuptoi pse pikërisht këto mendime po i silleshin rrëth arsyes, teksa ngjiste shkallët e fundit të piramidës. Për fat të mirë bota tashmë i dukej ndryshe. I ngjante një rrethi të butë. Ishte zhdukur shprehja pyetëse, se fundi të bën të vuash, apo e vërteta ishte e dyshimtë, se njeriu ka dy jetë për të shikuar qiellin dhe greminën e të tjera proçka.

Ndjeu aromën e akacieve që shpërbëhej nëpër gurët e udhës. Ndërsa provonte kontaktin me brishtësinë e diellit të janarit, buzëqeshi kur pa ftyra të panjohura që i dhuronin dashuri.

Në bar “Mumja” si gjithnjë ishin ndezur qirinjtë. Hijet e tyre shpërndanin shenja intimiteti dhe ftyrat e ndriçuara, dukeshin si ftyra të reja. Duart nuk po i ngroheshin. Ajo i mbështeti nëpër xhepa. Nuk dinte çfarë priste aty! Ideja se ekzistonte vetëm brenda vetes, e bënte të ndihej bosh, pa formë dhe e zhbërë. Pëlhura kërcënuese e tymit të cigareve ishte holluar. Kujtoi dashuritë e humbura. Nuk dinte pse imazhi i tyre i mbetej në gjithçka, të bukur apo të shëmtuar. Pesha e kohës i rikujtonte se jeta qe një pjesë e lindjes dhe e ikjes. Ajo nuk mund të ishte gjithnjë e mbyllur brenda trupit, ku secili përpiqej të shndërronte copëzimin e së keqes në një motiv të së mirës. Në kohëzgjatjen e vështirë gjërat ndryshonin aq sa mendësonte, vdekaturi. Angjelina predikonte, se pjesa më e madhe e botës që i shkonte pas, ishin ca fëmijë të hutuar dhe disa pleq të parrezikshëm.

Pas kthimit nga përtej detit Angjelina D. kishte folur para çdo jete, se një ditë do të shembej muri që kishte hyrë deri në lëkurën e njeriut. Julia disa herë e kishte pyetur,

pse bota nuk ishte e njëjtë ose e barabartë, apo pse njerëzit nuk i vinin krahët atij muri që vriste kohën. Kujtesa vrassëse e tij ishte një mekanizëm si çelës prej mishit, ku drejtpeshimi mezi priste të shembej. Julia nuk kishte jetuar kurrë e qetë. Ajo mendonte se muri që shquhej për terrin e mbulimit të kufomave ende paralizohej nga tymi brenda vdekjes së vërtetë. Vendi i saj që kishte lindur të jetonte në të njëjtën çati me pjesën tjetër të botës, prehej në vdekje. Çuditërisht, ai i kishte nxjerrë një nam të lajthitur vetes. E pëershruanin fytyrën e fjalën e tij si mrekulli e shenjtë, shpikur nga vdekatari, i cili kishte hipnotizuar deri edhe njerëzit e vdekur. Kur kujtonte dramën e këtij akti si për ironi i shfaqej fytyra e Arlit që bëhej i gjallë në bar “Mumja” pas gjurmëve të heshtura. Ajo që e trembte ishte se zemrat e përndritura nga dashuria, shërbenin për të bërë të dukshme anën e tyre tragjike, ku madhësia e vdekatarit varej në ajrin e ftohtë të quelqeve pa ngjyrë.

Në reflektimin ujor të pishinave, përtypëtë biskota që nuk ishin as të ëmbla dhe as të kripura. Julia dalloi nga larg, fytyrën e Arlit, i cili të jepte përshtypjen e një njeriu të arratisur prej vetes. Ulur në restorantin e vogël, ai pinte verë të kuqe nën shoqërinë e një gruaje. Dashuritë e shkuara të tij, kthetheshin ashtu si ai dinte t'i braktiste sa herë merrnin fund. E kishte ndier praninë e asaj gruaje, një ditë të harruar dhjetori, kur Julia kishte parë vështrimin e mësuar me një dashuri tjetër.

- O Zot, - tha duke u ngritur me shikim të ngrirë mbi sytë e Arlit. - Një dashuri tjetër, kurse ai përplaste vështrimin me trishtimin e saj.

Ajo uli shpejt e shpejt fundin e kaltër prej dantelle, sa ai u gris në anën e majtë. U ngrit duke e mbajtur me duar deri sa arriti në shtëpi.

Ndjeu zhurmën e makinave në udhët e ngushta dhe pasqyrimin e çarçafit të pluhurit. U përpoq ta harronte

fytyrën e asaj gruaje. Kishte menduar se ai do të kërkonte dashuri të tjera, pasi një burrë nuk mund të jetonte pa një të dashur. Fshiu parandjenjat. Në jetën e secilit kishte hapësira vetëm për një dashuri. I ishte dukur i huaj mendimi, se njeriu në jetën e një dite kërkonte të largohej nga e shkuara.

Ishte në shkallët e hyrjes së apartamentit duke lëshuar psherëtimat nëpër udhë, kur shiu i butë që vinte nga deti fshiu imazhin e pistë të mesditës. Një muzg i kuq mbuloi tokën e ndriçuar si pasarelat, ku gjykokeshin kontaktet me të bukurën. Në mbrëmje foli me Angjelinën. Ajo zhytej për orë të tëra në shezllongun lëvizës të ballkonit duke lexuar ndonjë libër të pluhurosur nga vëtmia. Julia mbështeti kokën mbi supin e saj sikur po priste të gjente qetësinë e fundit. Do kishte dashur t'i tregonte, se brenda vetes i ishte bindur formës së përkitjes së një trupi, ose shkrirjes me të, pa shpjeguar asnijëherë pse nuk dëshironte ta urrente atë njeri? Ajo kishte frikë nga urrejtja, ashtu siç kishte frikë nga forca e një dashurie, e cila mund të ishte ndryshe nga një tjetër. Mbante mend puthjen e parë të Arlit dhe çngjyrimin e fundit të ikjes, fshirë nga një lamtumirë. Kishte qenë e njëjtë me ngushëllimin e një vdekjeje. Udhët e lagura ngjanin me pamjen e një njeriu të lodhur që mezi gjente frazat e ditës. Dikush ecte pa peshën e tij që pashmangshëm ishte largimi nga ajo ditë e jetuar dimërore, pa dashuri. I dukej se nuk kishte jetuar. Koha e mbytur nën perden e reve përplasej drejt qiellit.

Mëngjesi u zgjua i kthjellët. Përfytyrimet e natës së shkuar ishin fshirë jashtë saj. Ndjeu zërin e shitësit të qumështit. Ai mbante në shpinë, ngarkesën me shishet e qumështit dhe shante me fjalë provokuese vdekatarin.

I dukej se njerëzit nuk i bindeshin më as vërvetes e jo më zërit të tij, i cili thyhej me heshtjen. Ai ishte i pari që kishte ftohtë nga dimri dhe vapë nga vera. Ende fliste nga

gjysmë drita, ku rrekej të kërkonte rrezet e harruara të stinës. Mbështeste këmbët e mëdha mbi tokën që i mbushte sytë. Lëkundej nën peshën e shisheve plastike duke mbërritur në secilën portë. Atje ende trupat e burrave rrotulloheshin, duke soditur barkun e gruas.

Julias nuk i kishte shkuar ndërmend, se udha e ngarkuar nga frika e eteve të ikjes, një ditë do t'i akuzonte njerëzit për mëkatin më të madh. Shtetit i mungonte një pjesë e zemrës. Udhët e botës kërcënoinin të mbanin sipër vetes edhe dhimbjen e zërave të ikur. I ngjante se afër apo larg i mungonin sytë, për të vështruar në vetmi zbehjen e së shkuarës. Pra, mundësia për të qenë e plotë i luhatej mes braktisjes dhe kthimit të vonuar, sa po dëgjonte lutjet e zërit të nënës.

Ikja nuk ka as fillim, as fund. Bota mbetet e rrumbullakët. Ne sillemi rreth saj si pelegrinë nëpër udhët me sy nga dielli, duke u lutar për një botë ndryshe. Braktisja ishte një mëkat si të gjitha mëkatet, një ndjenjë e njëjtë me barrën sipër vetes. Eshtë një formë e hakmarrjes kundër pranimit të vvetvetes, ose një braktisje e përkohshme, mendonte shpesh Julia.

Ajo ndjeu një dhimbje të brendshme. I zgjоhej gjithnjë, sa po vinte re udhët e shkretuara të qytetit. Krahët e ikur dukej, se rëndonin më shumë mbi atë muzg të varur, ku e nesërmja luhatej, për të gjetur përtëritjen.

Dielli i ishte varur në gjoks si një medalion fatsjellës. Angjelina - i tha, se një ditë koha do të hakmerrej për braktisjen dhe të gjithë do të shihnin një ëndërr të vdekur.

Shpirtërat e penduar do të kapërcenin kohën. Nuk do të kujtonin ikjen, por kthimin. Ndaloj në murin e njoftimeve të vdekjeve, sikur atje ta priste një personazh që i bindej lutjes së Zotit, për të shkuar pranë tij. Brenda tyre kishte qetësi, sepsejeta ndahej nga koha. Nuk e njihte portretin e

asaj vajze. Madje të gjitha kufomat që përcillte në botën tjetër nuk i kishte parë as si fytyrë.

Funerali i veshur me të zeza ende nuk e kishte marrë vesh, pse kishte ikur nga kjo botë Tina H. Ca thonin se ajo ishte në pritje të ikjes. Dikush kishte dëgjuar se Tina H. atë ditë kishte varrosur edhe dashurinë e vetme që kishte pasur. Ndoshta ishin fjalë, por në fytyrën e saj nuk shfaqej asnjë mëkat. Drita ndriçonte heshtjen duke zgjatur duart.

- Jo, - kishte thënë shitësi i qumëshit. - Tina H. vdiq nga një sëmundje e panjohur.

Mëkati fatal që përpinqeshin të zbulonin njerëzit ishte, se ajo kishte vdekur pa dashuri. Mjekët e kishin këshilluar të lindte një fëmijë. Por dashuria ishte ndarë përgjysmë. Gjysma kishte mbetur në gjakun e saj, kurse gjysma tjetër rronte në një tokë tjetër.

- Si mund të lindja një jetë prej mishi, kur mungonte një fytyrë dashurie? Fatalitet kishte thënë Tina H. Të nesërmën ishte gjetur e vdekur.

Mëkati i vetëm i saj është se ajo trupëzimin me një qenie tjetër e mori në atë botë. E thënë ndryshe, vdekja i erdhë sepse i mungonte një dashuri, jo një trup.

Në harkun e qiellit u dëgjua një shkreptimë dhe njerëzit në brendësi ndjenë ankth. Julia nuk mbante mend qysh kur kishte shkuar në varrimin e parë. I kujtohej pak, se si ajo grua me një thikë në dorë kishte vrarë veten. Sipas Angjelinës gruaja nuk kishte pasur frikë nga vdekja. Jo se qe në kërkim për të gjetur vdekjen, por sepse kishte zbuluar të kundërtën e tejskajshme, vdekjen e trupit dhe jo të shpirtit. Amen!

*M*brämja e mugët u lëshua mbi vështrimet e kalimtarëve. Furtuna u qetësua. Të nesërmen dita ishte parë. Julias iu kujtua ajo ditë, kur Angjelina e mori në krah. E uli në trotuar, para se të lexonte ato njoftime që mallkonin vdekjen. Ishte një fëmijë rrëth gjashtë vjeç. Atë ditë do të fillonte klasën e parë. Angjelina kurrë nuk kishte besuar se dashuria e saj e vetme për Erten S. ishte një èndërr e vdekur. Ajo besonte se Erteni ende ishte gjallë. Alibia e vdekjes që një fjälë në ajër. Julias i dukej se tek e mbante në krah bashkë me alibinë e shkuar, ajo kërkonte një zemër të humbur brenda kohës së mallkuar. Angjelina D. nuk kërkonte një vdekje, por një jetë të sendëzuar në dashuri.

Njerëzit koteshin në një gjumë të frikshëm, ndërsa ajo lutej përqark njoftimeve të ngjitura në murin e ngrirë, ku koha maste jetën e njerëzve. As vetë nuk e dinte, pse kishte një shpresë të madhe, e cila i afrohej gjithnjë e më afër, teksha shihte fotografitë e njerëzve që vareshin në murin e ndryshkur nga vitet mortore. Julia tërhiqej pas gishtave të Angjelinës. Kur i shfaqej rrathi i zi para vetes, bashkohej me turmën që shoqëronte të vdekurit. Bënte një lutje para kusomës dhe vinte mbi varr një tufë me lulebore. Angjelina bashkë me lotët lëshonte një grusht dhe' për të përkujtuar qenien e ikur nga bota e të gjallëve. Shpirti prej fëmije kishte mësuar nga Angjelina, se vetëm në botën e përtejme njeriu jetonte në paqe. Ndaj i vdekuri i thoshte lamtumirë

botës së të gjallëve kur arkmorti mbështetej mbi dheun e butë dhe gjindja ngashërehej për ikjen e tij. Viteve të hershme Angjelina ndiqte të njëtin rit. Nuk mbahej mend se sa e sa kufoma kishte përcjellë në banesën e fundit. Në fillim Julia ishte habitur, pse ato kortezhe mortore mbanin lule e ndiznin qirinj, pastaj pinin kafenë e hidhur të vdekjes në emër të jetës. Dikush i kishte treguar se të gjitha këto bëheshin vetëm për të kujtuar të vdekurin që ai të ishte i qetë në atë botë. Shpesh Angjelina i thoshte se njerëzit, të cilët nuk kishin bërë mëkate takoheshin në qiell. Aty secili kishte yllin e shpirtit. Duke vështruar me kureshtje qiellin e natës, Julia lidhej me ato shpirtëra që tërësisht preknin sytë e saj. - Shfaqja e yllit, bëhej pas disa kohësh, - predikonte Angjelina, - atëhere kur yjet e tjerë rrëzonin errësirën. Në agim ato ktheheshin përsëri në tokën e amshuar, ku sipas hamendjeve ndodhej panairi i zemrave të humbura.

- Fytyra e vdekjes nuk është një zbrazëtirë brenda trupit, - tha pas varrimit të Tina H. shitësi i qumështit, të cilit askush nuk i thërriste me emër. - Eshtë vetëm një ikje e asaj fytyre, qysh nga fotografia e varur në murin e vdekjes e deri në frymëmarrjen. Ajo që mbetet pas është historia e kujtimeve.

- Domethënë ju nuk keni frikë nga vdekja, - e kishte pyetur një mbrëmje me shi Migeni, ndërsa çuditej që Julia e shihte atë si një jetë tjetër të njeriut. Ajo kishte mërmëritur ca fjalë, të cilat i përkisnin gjuhës së ngushëllimit dhe dy pikë të qelqta loti i ishin rrokullisur në fytyrën ngjyrë gruri.

- Gjithçka varet nga prania e kujtimeve dhe jo tek zhbërrja e trupit, - i ishte përgjigjur Julia, pasi ishte ngopur me ajrin e lagësht të muzgut.

Migeni në fillim qe shtangur, kur dëgjoi nga goja e saj, se njeriu pranonte të kishte dy kohë brenda vetes. Njerëz mbi tokë, me të cilën kujdesej për shenjën e gjallë dhe jetën qiellore. Ai besoi se bota e saj ishte shformuar nga ide të

diktuara nga tē tjerët. Julia kujtoi duart e tij si dridheshin mbi lëkurën, kur trupi intim ishte zhytur brenda trupit tē saj duke i pëshpëritur nē vesh, se botën e mbante gjallë dashuria dhe jo vdekja. Ruante ende nē buzë shijen e puthjes së Migenit dhe tërheqjen drejt asaj lirie tē thellë, ku nuk ekzistonte shkretëtira. Ai kishte një parandjenjë, se do ta humbiste, ndërsa prekte gjoksin e plotë duke dihatur pas trupit tē zhveshur që mbështillej nën ca rënkimë tē mbytura brenda dritës. Buzëqeshi me vete pér ftyrën që tashmë i mungonte. I dukej se diku e shihte hijen e saj si një njollë, e cila e largonte me duar pas ndarjes së fundit.

- Nuk tē kuptoj, madje as jam nē gjendje tē thërras kujtesën pér tē tē pyetur, se çfarë tē shtyn tē ikësh tanë, pér tē përcjellë një kufomë tjetër? Nuk tē marr vesh, se përsë kërkon ta bësh një gjë tē tillë? Edhe humanizmi ka një kufi!

Julia ndjeu një marramendje nën bardhësinë e dukshme tē qiellit vjeshtor. Migeni po ia pushtonte pjesën më tē hapur tē zemrës.

- Ne tē gjithë do tē vdesim një ditë, - i ishte përgjigjur ajo. Brenda trupit frynte era e gjetheve tē verdha. - Koha do tē ndalojë diku, si këto gjethe që janë zbruzur nga magjia e gjelbërimit. Veçse nē funeralin tim, do tē vijë i gjithë qyteti, saqë dhe vdekja do tē magjepsej.

- Kjo është një aventurë e shndërruar nē përfytyrim, Julia, - tha ai duke e shkundur nga supet. - Ti ende nuk e ke njojur jetën. Ndoshta je nē skajin e ndarjes nga vetja. Ai i kërkoi përsëri gishtat e dridhur që fshiheshin nga nata, a thua se më nē fund kishte zbuluar tē fshehtën e saj para agut tē së nesërmes. Migeni mendoi se ajo kishte nevojë pér një psikolog që tē balanconte funksionimin e botës së brendshme. Por Julia nuk pranoi.

- Migen, unë nuk jam e sëmurë. Jam shumë e qartë pér atë që bëj. Askush nuk e ka tē mjaftueshme veten pér tē zbruzur tē tjerët. Ende nuk kam ikur nga koha e jetës.

Edhe po të shkoj, hija dhe kujtimi im i mirë nuk do të zhduket.

- Kjo do të thotë se ju nuk i besoni as vdekjes, - e mbylli atë natë të shurdhër Migeni duke marrë me vete hijen e saj të mbetur në degët e shtrira të vjeshtës. Ajo ishte ngjitur deri në katet e qiellit përzier me përmbytjen e reve.

Migeni mendoi që asaj historie të trishtë t'i jepte fund në një formë tjeter. Vendosi të shkonte në shtëpinë e saj për të takuar Angjelinën. Nuk e mori këtë veprim si një lajthite të vetes, përkundrazi, - i tha se e dashuronte marrëzisht Julian, se donte të bashkëjetonte me të dhe se nuk dëshironte ta braktiste.

- Po ti a do të ikësh një ditë prej meje? - e kishte pyetur Migeni.

Julia në heshtje i ishte përgjigjur, se nuk i pëlqenin lamtumirat. Dashuria e humbur shndërrrohej në një masë, ku lëkundeshin hijet e harruara.

Ai u njoh me Julian një pasdite vonë në aeroplanin e linjës Albania-Airlines, kur të dy po ktheheshin nga Austria. Ishte e mjaftueshme të shtynin një pjesë të udhëtimit, ku ai kishte ndjekur një seminar për zhvillimin e pakrahasueshëm, kurse ajo për t'u takuar me regjisoren e filmit.

Migeni e priste para kolonave të bardha të Shkollës së Arteve të Bukura. Ai ishte trembur, kur Julia i tha, se nuk ishte si gjithë tjerat, se ngashmérinë nuk e përfytyronte vetëm në ngjyrën e syve. Tha, se ishte normale të shoqëronte kufomat në botën e përtejme. Fjalët i uleshin ngadalë para syve. - Bota ime rrrotullohet rreth së mirës. Nuk dua që tjerët të mendojnë, se unë qenqam një e çmendur.

Edhe atë ditë ajo ishte veshur me të zeza. Migeni u drodh, kur e pa të afrohej nën kolonat e bardha. Pikërisht atëhere, ai për ta larguar nga vdekja, bashkonte trupin e tij me trupin e saj të brishtë. I lëshonte fjalë të ëmbla, lëkundej përmes

shikimit të syve të lagur, ndërsa ajo i ngjante me një degë, e cila jetonte mbi rrënjet.

- Harroje, harroje këtë dreq hobie, - klithte ai krejt i eksituar, teksha penisi i tij rrëshqiste në mes shalëve të lëmuara, para të cilave ai dorëzohej menjëherë. E shtrëngonte fort në krahë. Rrëzohej mbi formën e buzëve, ku dukej se nuk flitej gjuha e bashkimit, por e ndarjes.

Sipas tij seksi ishte një forcë që e ndihmonte Julian të harronte dhimbjet. Por asaj nuk i pëlqente që ai të hynte brenda trupit të saj, duke e krahasuar jetën me vdekjen.

- Eshtë vetëm një komunikim mes trupave dhe një moskuptim i shpirtrave, - i tha ajo. - Madje nuk më pëlqen të bëj seks, për të harruar ftyrat që ikin nga kjo botë. Nuk di, pse të ka lindur kjo ide e pakuptueshme, Migen. Nuk di pse kërkon që pas çdo vdekjeje të mytoshesh në ofshamat e seksit? A s'të ngjan sikur je në rolin e mëshiruesit të dhimbjes sime?

- Më duket, se njeriu lehtësohet nga dhimbja, kur të tjerët i ndodhen afër, - i ishte përgjigjur Migenit, kur ai lëshoi shprehjet e habisë. Secili ka nevojë pér mbështetje Migen.

- Je një model i veçantë njerëzor Julia, - je një model i prekur nga humbja, - i tha ai.

Julia ishte shokuar nga ajo krisje e brendshme e tij që papritur ishte gërvishtur nga zhgënjimi. Shenja e kthjelltësisë së shpirtit po ngatërrrohej rreth bashkimit të jetës me vdekjen. Ai kishte tmerr nga vdekja. I besonte botës së përjetshme. Por nuk mund të pranonte që Julia të merrej me trupa të gjallë e të vdekur.

Ishë ora rreth shtatë e mbrëmjes, kur ai trokiti në portën e shtëpisë së saj. Angelina e ftoi të hynte brenda. Migeni ndjeu zërin e ngrohtë, ku fjalët dëgjoheshin si një përshpëritje.

- Zonjë! Ju i keni ngjitur një brengë të njëjtë Julias, - i tha Migeni, ndërsa ajo u duk sikur u përtëri nga fjalët e tij.

Nuk e ndjeni se brenda saj po njëjtësohet jeta me vdekjen? A s'ju duket se po bëni një mëkat të madh zonjë, duke i krijuar asaj zbrazëtirën e jetës?

Angjelina kërkoi sytë e tij të fshehur pas syzeve. Lëvizi mes gishtave faqet e fundit të librit që mbante para vetes dhe si ai të mos ekzistonte aty vështroi sipërfaqen e lakuriqtë të qiellit.

- Lëre, Julian të jetojë jetën e saj, me dashuri për njerëzit. Unë kam një jetë që kërkoj një zemër të humbur, por jo një zemër të vdekur. Ndaj asnjëherë nuk i kam besuar ikjes nga kjo botë. E urrej të keqen, djalosh. Kam zbuluar se njeriu duhet ta kërkojë Zotin tek vetja, sepse duke i besuar vetes do t'i besojë edhe jetës. Mirësia është pavdekësi, Migen. Eshtë një dashuri që nuk lidhet me trupin, por me shpirtin.

Ai përmes perdes mbrëmësore ndjeu fryshtën e saj, që e tërhoqi pranë vetes. Në mur ishin varur piktura të vjetra plasaritur nga koha. Iu duk se kishte gjetur ca lidhje të panjohura, të cilat vareshin nëpër sipërfaqet e së shkuarës, ku frynte paqësish era e ditës së re.

Julia kishte shtangur teksha dëgjonte dialogun mes tyre. Vrapoi në udhët e lodhura dhe përnjëmend mendoi, se Migeni lutej ta largonte nga dashuria e përbotshme.

Mëngjesi ishte zgjuar nëpër copëza dyshimesh të rrudhura nga shkrirja brenda vetes. Sikur atë mbrëmje Migeni të kishte dëgjuar Angjelinën, do ishte mirë ta linte të jetonte botën e saj. Mendoi t'i thoshte lamtumirë. Ndërsa ishte duke pirë kafenë e mëngjesit Julia i dërgoi një mesazh me telefon.

- Eshtë mirë t'i themi njëri-tjetrit lamtumirë. - Jo sepse, ti ishe njeriu, të cilin e kam adhuruar, por sepse nuk më pëlqen që të tjerët të përgjojnë jetën time. Njeriu përvëç peshës së jetës duhet të mbajë mbi vete dhe peshën e humbjes. Historitë njerëzore asnjëherë nuk myllen pa një lamtumirë.

Migeni ishte bërë akull, kur lexoi mesazhin. Pra, Julia, ishte e bindur për atë që bënte. Përshpirtjet e lidhnin më shumë me njerëzit. Sipas tij, ajo nuk besonte as në ikjen vdekësore dhe as në haluçinacionet. Ishte krejt origjinale në atë që bënte. Do të vazhdonte të jetonte duke përcjellë të vdekurit.

Për shumë ditë me radhë Migeni e kishte pritur në muret e njollosura të piramidës, ku ishin shfaqur portretet e lagura nga shiu i tetorit. Dalloj dhe portretin e Arlit. E njihnte fytyrën e tij si një imazh të largët. E kishte parë në bar „Mumja” aty ku rrokulliseshin bëmat e shtetit. U kujtua se emrin e tij e kishte gjetur në revistat dhe gazetat e përditshme si një politikan i së ardhmes. Vetëm se figura e varur në kolonën e gjatë dukej krejt e vogël, përlyer me hijen e pluhurit.

Kur pa se kishte mbaruar së thithuri paketën me cigare „Slims”, u ngrit. Një diell i zbehtë zvarritej deri në trotuaret e lodhura. Ai i varej nëpër këmbët që mezi i bindeshin. Nuk do ta lejonte veten të rikthehej tek Julia. Kërkoi ta mbyllte atë në kafazin e kujtimeve, ashtu siç mbyllte një fytyrë të ikur nga vetja. E fshiu mesazhin nga ekran i telefonit. Gërmat e ndrojtura i ndereshin në sy.

Në skajin tjetër të udhës pa profesorin e tij të psikologjisë. E ftoi për një kafe. Ai qe një burrë trupvogël, i sapomartuar. Nuk dëshiroi në fillim ta pyeste për Julian. Por jo, jo...

- Të lutem, profesor, si mund ta kuptoj një qenie të tillë, e cila mbart brenda vetes diçka të tmerrshme? Pse varet nga një sjellje e tillë?

- Nuk mund të mendoni se ajo vajzë bën një akt human që ndodh për herë të parë, - iu drejtua psikologu, kur lexoi në sytë e tij dyshimin. - Unë besoj se ajo vajzë është krejt normale. Ka lidhje me historinë e paraardhësve. Për mendimin tim, ky akt është një rit i lashtë. Brenda saj nuk ka asgjë të errët. Përkundrazi, ka lidhje të hershme me

kujtime të gjalla që depërtojnë në një pikë reale. Ndaj njeriu mund të vazhdojë gjithë jetën të bindet, se ai nuk është i nënshtuar nga vdekja. Ky fenomen ndikohet edhe nga rrethanat. Të gjithë harrojnë se njerëzimi nuk e përfill vdekjen, ndërsa ajo e ka ndëshkuar. Eshtë një nxitje humane të respektosh vdekjen. Dhe kjo ndodh më shumë tek gruaja. Ajo lind dhe rijeton kohën, sepse rijetojnë kujtimet e shkuara, - vijoi profesori kur jashtë ishte rrëzuar nata.

Kishte dëgjuar rrallë histori të tillë që njerëzve iu dukeshin të trishta, njëfarë mënyre për të triumfuar mbi gjithçka. Ishte ideja e perceptuar nga të tjerët që ndryshe ishte shfaqur tek pasardhësit.

- Në kohët e sotme bota është e hapur për sjellje humane, Migen, - tha profesori duke u ngritur. - Gruaja, e cila lëviz botën drejt së mirës, mbetet e rrethuar nga pushteti i dashurisë. Megjithëse mbretëron brenda fustaneve që i pëlqejnë shumicës së meshkujve, gruaja ka një zemër për të dashuruar jetën dhe një shpirt të lidhur me amëshimin si një tabu për atë që ikën.

**J**na G. i telefonoi Julias për një intervistë të çuditshme. Një gazetar i njojur kishte kureshtje të njihte figurën e saj, si aktore e re dhe fotomodelle e vinit. Julia mendoi se Ina do t'i tregonte ato kotësirat e thashethemeve të bar “Mumjes”, do t'i fliste me pasion për një grup të rinjsh të teatrit dramatik që kishin interpretuar pjesë të panjohura, apo për bëmat e qenit të saj Volpino që lëpinte parfenë e ftohtë.

Kaluan dhjetë minuta, kur Ina u shfaq nën shoqërinë e gazetarit që për një çast mbeti i hutuar. Julias i ngjau me një endacak që fotografonte dhe shkruante me dorën e majtë mbi bllok, duke gërvishtrur heshtjen. Tha, se kishin hapur një padi për të, sepse kishte zbuluar jetën private të një aktoreje të vjetër. Madje zbulimi i të fshehtave ishte një mani e gazetarëve të rinj.

- Të them të drejtën, unë nuk kam frikë nga e bukura, - iu drejtua Danieli, kur Julia nuk po thoshte asgjë. Për fat të mirë njojja me të bukurën ka një lidhje antagoniste me atë çfarë është e bukur brenda njeriut, trupit apo shpirtit. Kam intervistuar gra dhe vajza të bukura. Them se rrëfimet e historive të tyre kanë aq të panjohura, sa nuk mjafton frymëzimi im romantik. Do të isha kurioz të intervistoja një murgeshë të bukur, sigurisht për të njojur botën e tyre.

Julia ishte mpirë. Kërkoi leje të ngrihej, por Danieli i kapi duart. Buzët po i dridheshin. Piu një gllënjkë ujë. U

ndje e shqetësuar nga mendimet e tij. As nuk i kishte shkuar në mend ta përshtaste veten me murgeshat, që ushqenin mirësi para vuajtjeve. Kujtoi shenjtoren e tokës së saj, nënë Terezën, që i përkiste gjithë botës.

- Nuk jam në një mendje me ju, - iu përgjigj ajo. - Trupi dhe shpirti rrallë kanë të njëjtën bukuri. Më mungojnë emocionet e një murgeshe. Të paktën kështu mendoj. Ndihem mjaft mirë si aktore e fotomodele. Por pas vdekjes së qenieve njerëzore mbetet, ajo që quhet dashuri për jetën. Më duhet ende kohë ta njoh vetveten. Gazetarëve u pëlqen të ngacmojnë me pyetjet e tyre. Për të ardhmen, ah, - për të ardhmen më duhet të gjej një realitet tjeter, një tjetër jetë. Ja, për shembull, të mos dëgjoj numra përvrasjet, të mos mbytem nga lotët e të pafajshmëve. Nuk dua që kjo tokë ku linda të shuhet nga vdekjet. Më duket se ende kemi të njëtat dhimbje, po përsërisim vetëhumbjen. Kontakti me të shkuarën është kontakti i lidhjes me të ardhmen. Jetoj nën ankthin e gërryerjes së kohës, ku përkitja reale po zbraset nga qendra e zemrës në brendësi, të shkëputjes nga shpirti. Po përballemi jashtë vetes me përtetje botën, pa një zë të brendshëm.

- “Mumja”, nuk i pranon moralo-pesimistët, aq më keq frikën e tyre, - foli në mëdyshje Ina. Nga prirjet jam pak shembull i aventurës.

Julia nuk kishte harruar atë ditë të hënë tetori, kur Ina hyri në bar “Mumja” me qenin e vogël kapur pas rripit të çantës. Skaji i kaltër që respektonte sjelljet intime të ndriçuar me qirinj, i cili për çudi quhej edhe vendi i zjarrit, mbeti në errësirë. Aktorët e rinj të dramës e hipën qenin e bardhë sipër tavolinave të shuante qirinjtë. Kur më në fund të gjithë qirinjtë ishin shuar, aktorët harruan të puthnin të dashurat dhe qeshën me të madhe. Ata besuan se edhe qeni dinte të zhbënte dritën. Ina mezi e arriti qenin në hijen e ngushtë të kthinate pa dalje. Të nesërmen i thanë se

pronari i lokalit kishte ndaluar që në bar të hynin kafshët me bisht. Ajo tekxa kalonte në skajin intim, dëgjonte thirrjet e aktorëve që thërrisin humm, humm... humm... . .

Kur dëgjoi historinë, të cilën Ina e tregonte krejt e pafajshme, Danieli tha se nuk ekzistonte më ideja e moskuptimit. Aktorët e kuptionin jetën si nëpër filma. Ai e ndërpren sërisht bisedën me një eufori të njojur, kur tregoi se sipas studimeve më të fundit, qeni kishte një gjuhë të padukshme njerëzore dhe ruante shprehjen e dashurisë për të zotin.

Ina nuk ishte parë për shumë kohë në bar “Mumja”. Aktorët e dramës e mbajtën mend historinë e qenit të bardhë. Ai kishte qëndruar krejt i çuditur në errësirën e mbushur me klithje, ku shquheshin sytë e tij të shuar si qirinjtë.

Të nesërmen Ina kishte thënë se genet e të rinxve po ndryshonin nga paraardhësit. Bindja se trashëgimia ishte një fill i qartë dhe zëri imagjinar që ndërthurur me energjinë e përcaktuar, bënte që secili atë lidhje pa fjalë ta shndërronte në një pasqyrë. Julia ishte e para që mori leje, për t'u larguar, pasi nuk i pëlqenin moskuptimet. I dukej se masa e ngjashmërisë ishte pikërisht si një kohë e ngjitur pas vetes, e cila kërkonte vazhdimin e një bashkimi mbetur në pëllëmbët e duarve. Drita e thellë arrinte të depërtonte përmes lëkurës së nxehËtë, ku fryma çlirohej nga thithja e zërit.

Pjesa më e madhe e bulevardit “Zhan Dark”, ndihej e lodhur, megjithëse nga pamja e jashtme gjithçka dukej sikur endej në marramendje. Nëpër cepat e ftohtë të natës, që ngjasonin me rrøba të arnuara nga errësira, klithnin lypstarët. Ata mbanin në krahë kërthnjë të vegjël, të cilët kërkonin t'i shpallnin grevë ministrit të shtetit. Qielli ndihej i shkretë, ndërsa yjet dukej se këputnin flatrat e zogjve, të cilët mbështeteshin mbi qafën e rrethit të hënës.

Pamja e stampuar me heshtjen, varej si një vitrinë absurde zhgënji, ku dobësimi i ngjyrave kishte nevojë të kurohej. Për fat të keq njerëzit ndiheshin brenda zemërimit. Ata e shihnin veten të ndëshkuar nga realiteti i mëmëdheut, që vuante prej pjellave të veta. Malkimi ishte zverdhur jashtë fjalëve të pasardhësve, të cilët ngatërronin kërvizën me emigrantët e larguar nëpër botë.

Kur në ekrarin e televizionit EIB pa fytyrën e Arlit, Julia ishte gati të formonte numrat e telefonit, për të folur me prindërit në Nju Jork. Lëshoi receptorin dhe u ul përballë. Arli lëkundet në karrigen e lëvizshme të studios me ngjyra të ndezura, a thua se po shembej. Kolegët me këmishat e kollarisura, fllisin për të tashmen e për sfidat e pasardhësve. Julia ndjeu se fytyra e tij ishte zhytur në harrim.

- E keqja më e madhe, - tha krejt i qetë Arli, - ne na vjen nga vjetvetja, ose e thënë më hapur, ne nuk jemi pjesë e plotë e qenies, por një pjesë e secilit që bashkohet me pjesën e tjetrit. Jo sepse kështu na kanë mësuar të parët, por sepse kjo lidhje na ka marrë me vete. Prandaj të gjithë ne udhëtojmë nën një erë të pafund kalimtare. Jemi mësuar të çapitemi ngadalë, sikur të themi fjalët e lutjes së mëngjesit. Ndoshta kjo është arsyaja që njerëzit i besojnë më shumë horoskopit, se sa aktorëve të atij teatri pa shpresë, që i kishin zënë pritë së ardhmes. Sipas analistëve, shteti ndihej i dobët, bënte hapa të vegjël për shkak të ndëshkimit të vvetes. Shpalleshin pa fund ide të njobura të opozitës dhe pozitës, veçse mes tyre qëndronte „muri” armik. Njerëzve u kishte mbaruar durimi. Ata shihnin lojën e barabartë të shahut. Dëgjonin idetë, ku i bëhej thirrje vegjëlisë të ishte shërbysese e mëmëdheut. Politikanët e vjetër i etiketonin politikanët e rinj si „bojaxhinj” që vetëm dinin të bojatisnin fasadat e së shkuarës dhe të vuanin nga një fantazi e tepërt.

- Kohë absurde, - tha me vete Julia. - Zotërimi i kohës

ishte në mëdyshje, kurse ata që ishin mburrur, nuk kishin qenë as bojaxhinj, për të fshirë njollat e krijuara rrëth boshtit të tyre.

Sipas shitësit të qumështit që rasti e sillte të merrej me të vegjëlit, gjithçka qe thjesht një lloj kapercimi i fajt tek të tjerët. Ca syresh, deputetë, madje kishin premtuar ide të çuditshme, si linja të prodhimit të specit të kuq, apo të shisheve plastike. Më i drejti ishte cilësuar një gjatosh me mjekër, i cili predikonte se do të luftonte shtetin plastik që kishte lindur për të vdekur, në sallën e ndëshkimit.

- Punë shkërdhatësh, - kishte thënë pa u ngutur, heroi më i vjetër. - Dinë vetëm të flasin për gjëra të kota.

Julia dëgjoi në anën tjetër të botës nga Nju Jorku i largët, zërin e nënës së saj, një grua e butë që i ishte përkushtuar artit të fjalës. Ajo pati ngjitur me durim shkallët e vështira të jetës.

Megjithëse kishte një edukatë të thellë, Anita ndihej e përkujdesur në botën që jetonte.

Nga një aktore, që sipas kritikëve të artit i përkiste më shumë zbulimit të brendshëm se atij të jashtëm në interpretim, qe harruar me kohë. Një ditë të akullt janari kishte parë në ëndërr, se sistemi që i rrëthonë i ngjante një fiku të papjekur. Askush nuk arrinte të shijonte kokrrat e tij.

Ishte zgjuar duke qeshur. Mbi sobën e vjetër gjallonte aroma e fasuleve të thata. Ajo mbeti një idealiste, ku depërtonte vuajtja. Anita po jetonte mes ëndrrës e zhgjëndrës, të cilat nuk kishin asnë urë lidhëse me jetën. Atëherë e kuptoi qartë, se koha ishte kthyer në një binom matematik, pa të njohura e të panjohura. Brenda saj zhvillohej e njëjtë ceremonia e adhurimit. U kthye në një grua të dhunuar nga idealizmi, ku njeriu brenda kohës së jetës duhej të jetonte për të tjerët dhe jo për veten. Në qendër të asaj bote të vogël, Anita kishte jetën, kujtimet dhe shtetin

e vet. Atje çdo gjë kishte humbur fillin. Njeriu ndihej i ndarë përgjysmë. Më në fund ishte larguar nga ftyra e tokës së të parëve. Pas vetes kishte lënë një lagështirë që e rrethonte si një mbulesë e akullt. Me trupin e rrënqethur nga lodhja prej mallit, gati gjysmë e ngrirë, si atë ditë kur i kishte treguar ëndrrën e vdekjes regjisitorit, puthte e ndezur nga zjarri trupin lakuriq të dheut, ku kishte mbjellë kujtimet. I ishte dukur se zëri i mbetur në pafundësi i afrohej deri në buzët që shkrepnin aq shumë, për të puthur atë trup të braktisur. Ai çdo ditë pyeste veten, pse e kishin harruar të gjallët?

Kam vdekur, nëse nuk kthehem. Ikja është harrim, - i kishte thënë me mijëra herë vetes. Shpesh qe rrotulluar nëpër ethet e ikjes dhe kthimit të përjetshëm nga tryesa e diellit, për të gjetur një zëvendësim të njëjtë të asaj dashurie të lindur. Vetja i ngjante mëngjeseve në pritje, si një zog i zhdukur nga shtëpia e qilllit. Mezi vizatonte me gishtat anonimë fytyrën e një gruaje pa trup. Kur emri i saj qe damkosur me një njollë, koha i kishte bërë pis të gjitha ëndrrat dhe kllapitë si një basme e palarë nga njollat gri. Pastaj ishte larguar në botën e lirisë, ku ujëvara e dritave zgjatej mbi këmbimin e mëngjeseve me mallin që nuk i rezistonte as trupit, e as shpirtit.

I shoqi Luka, kur ishin afruar drejt statujës së lirisë, ndjeu se ikja po i gjerryente pak nga pak vetveti, ashtu si tkurrja e frymëmarrjes në dheun e vjetër.

Stërgjyshi i tij e kishte kërkuar më herët ëndrrën prej zjarri, duke provuar lirinë e një bote të huaj. Kishte emigruar në Amerikë një jetë të tërë. Fati nuk kishte dashur ta linte vetëm në botën e largët. Një letër e vonuar dhe disa fotografi të zbardhura nga koha mbetën për shumë vite në imagjinatën e të njohurve. Sapo kishte prekur atë tokë, bleu një kalë të zi me lëkurë të lëmuar që e mbante të lidhur me shpresën. Një ditë zëri i njohur do ta priste, për ta tërhequr

pas vetes me ca duar tē hapura prej agu. Fjalët i kam shkruar mbi kurrizin e kalit, shkruante ai nē letrën e verdhë. Kjo jetë e largët më ka mbyllur brenda madhësisë së saj. Këtu më mungon, vetëm një gjë e madhe, fortesa e shpirtit.

Kur u kthye me një kuti teneqeje ngarkuar nē shpinë, lëkundej si era. Anita ende e kujtonte historinë e harrimit nē kutinë e mbyllur nga vëtmia. Ai kurrë nuk kishte kërkuar mëshirë dhe as ishte pérulur para jetës.

Në kohën kur flitej gjuha e heshtjes, Anita ishte kthyer nē një pastruese muresh. Nuk pati kohë tē mendonte më pér teatrin apo filmin. Ndjekësit e murretyer tē kohës e shihnin tē zbehtë pérndritjen e saj.

Sipas Lukës, Amerika i dhuronte lirinë tē gjithë botës. Tashmë kishin kaluar atje mbi tre vjet. Jetonin nē periferi tē Manhattanit. I shoqi një njohës i mirë i makinave ishte përshtatur menjëherë me jetën e shtetit tē madh, ku mërgimi hynte nē fjalorin e përditshëm. Ai gjeti punë nē një uzinë tē madhe tē përpunimit tē çelikut. Në shtator, tekxa ishin larguar nga toka e tyre, nuk besonin se do tē përshtateshin aq shpejt nē kontinentin e largët. Fëmijët, përkundrazi, ishin ndier modest. Sjelljet shoqërore tē tē huajve i kishin marrë si shenja drite. U mësuan me jetën e tyre dhe ndiheshin tē rrëmbyer pas èndrrës amerikane. Anita përpiquej t'i harronte vuajtjet, duke i menduar si një kohë e vdekur. Kontakti me botën e lirë, kujeta shkëmbhej me aftësinë, pér tē përkrahur jetën e kishte kthyer nē një grua tē qetë. Fëmijët shkonin mirë me mësime. E bija Eljana kishte dëshirë tē studionte pér mjekësi, ndërsa djalit që ende i shfaqej fytyra e shtetit tē tij, sikur i mblidhej një gur nē zemër, kur kujtonte ikjen pa kthim. Nga larg dëgjonte thyerjen e dallgëve tē mëdha tē oqeanit dhe qetësinë e mbrojtjes së paqes. Shtegu i kalimit drejt botës pa mure, ku takoheshin fytyra nga hija e një bote tjetër, krijonin një rreth tē përzier mes baticës e zbaticës.

**B**uzë rrugës 28-të Avenjusë pesë, Anita përkujdesej për shtëpinë dhe fëmijët. Po kapërcente të dyzet e tetat. Në fillim mezi arrinte të largonte nga vetja referimin, ku afroheshin e largoheshin dy botë të ndryshme. Nuk dinte, pse shpesh ndjenjat i zmadhoheshin ashtu si një fotografi. Ashtu duke ngritur mëngët i rishfaqej një hapësirë e mbushur me mall. Të dashurit i mungonin për shkak të erës që nuk pushonte. Vetëm kur kujtonte Tiranën zbrazëtia i ngjitej deri në fyt, sa ajo nuk ishte në gjendje të prekte jashtë rishfaqjen e humbjes.

- Jam krejt e përhumbur midis dy botëve, - i tha Julias në telefon dhe uli receptorin që dihaste nga lotët.

Julia lëvizi trupin para se t'i thoshte mirupafshim të ëmës. Ajri i dhomës ishte rënduar. Ajo mori frymë thellë. Gjithçka kishte mbetur ashtu siç i kishte lënë e ëma. Mobiljet e vjetra prej stofi vishnje dukej sikur mbanin ende në lëvizje siluetat e largëta, që kishin harruar aty hijen e tyre. Në dritaren e madhe, ku dielli binte vetëm në mesditë, shpirrat e ngjashëm kishin mbetur si përkujtim i jetës. Ditënata shkëputej në një vijë të drejtë, ku po ecte bota e re.

Vonë e kishte zënë gjumi të përqafuar me hijet e largëta. U zgjua me një ndjenjë që i zmadhohej dhe e bënte të lumtur. Veshi pantallonat blu xhins, sandalet e sheshta pa taka, bluzën ngjyrë trëndafili. Hyri në qendrën e kulturës,

për të ndjekur provat e sfilatës së vjeshtës. Ende ishte në mëdyshje për të marrë pjesë në atë sfilatë. Pikërisht kur ia tha këtë vetes, filloi të ndiqte provat. Ndonjëherë kishte menduar që pasi të mbaronte sfilatën e fundit, ta shtynte veten, për të bërë diçka në botën e artit, pse jo aktoren si e ëma.

Stilisti kishte përdorur një stil të veçantë të veshjes së saj, që i ngjasonte sa traditës, aq dhe modernes. Një fustan në ngjyrë të kuqe, me ca brinjë të zeza si xhubletat e stërgjyshërve, të cilët i kujtonin pikturat e engjëeve.

Nga sfondi i blertë i pasarelës, Julias i zunë sytë Danielin duke shkrepur aparatin fotografik. I ngjau me shitësin e qumështit, i cili kishte një kraharor të gjerë, ku dukeshin se paloseshin dy krahe të sigurtë që gjenin paqe mbi avullin e ngrohtë të qumështit. Sipas tij ai përbënte fuqinë natyrale të njeriut, e cila krijohej nga jeta e gruas nënë. Nëpërmjet gjinjve të kthyer drejt hënës, hapte buzët një jete tjetër. Ato bashkoheshin mes tyre, pastaj ktheheshin në energji, për t'u shkëputur nga dhimbja. Gruaja është si profeti, kujtoi një shprehje të Danielit. Ai e kishte kapur për krahu. Mbante lidhje me të nëpërmjet pëshpërimave.

- Më fal, Julia, - i tha Danieli, ndërsa u përpoq të fliste me një gjuhë zemre, e cila lidhej me dritën e fytyrës. Më pëlqen të flas me ty për jetën.

Tingulli i zërit të tij ishte i plotë, intim për të thënë të vërtetën. Kam pritur gjatë të flas një gjuhë të tillë. Ajo ndjeu se fjalët e zemrës po i hynin drejtpërdrejt aty ku mungonin, brenda kraharorit, tek i mbushej shpirti. Ndjeu ngrohtësinë e gishtave të tij që vinte nga një forcë e gjallë brenda qenies, para së cilës ndizej një dashuri e përtërirë. - Të dua, të dua Julia. . .

Stilisti i pa si i habitur, kur po largoheshin. Ata e pëershëndetën me një buzëqeshje të çliruar. Dukeshin se ishin të domosdoshëm për njëri-tjetrin si një qelizë, me të

cilën trupi ndihet njëherësh i lidhur. Julia lexoi sytë e hirtë të Danielit. I ngjanin me sytë e një detari, të cilët e pyesnin për gjithçka. Zgjati duart pa thënë asnje fjalë. Ndjeu aromën e trupit të tij që e shtrëngonte pas vetes. Nuk mendoi se ai ishte një pjesë e kohës së mbetur, e cila lëshonte mesazhe nga koha e braktisur që ishte në humbje. Asnjëherë nuk i pëlqente të gërvishte cipën e hollë të kujtesës për të shkuarën. Ndiente se koha i shfaqeje e dukshme, e djegur nga flaka e erës mbi sipërfaqen e zbrazët, ku nuk mund të hynte askush tjetër.

Lumturia kishte një formë që përbëhej nga dy zemra. Ato ishin pjesa më e qendërzuar e trupit. Atje hijet e harruara shkriheshin si një akull ujor. Ndjeu buzët e tij që dridheshin mbi lëkurën e lëmuar. Jetoi sikur të kishte një jetë të vetme për të gjetur atë ditë. Nga ajo formë e ëndërrt, ku ekzitonte përbajtja Julia puthte gjatë buzët e tij që vetëm e tërhiqnin drejt vetes. Të mbyllur brenda ndriçimit të trupave, secili shihte madhësinë e gjithçkaje që kishte thithur ajo natë. Dita ishte në çdo qiell e tokë të botës. Njeriu e çlironte vetëm dashuria që sipas poetit:

Bota duhet t'i përulet dashurisë së vërtetë  
O Zot ! Forca e saj është brenda dhe jashtë,  
Atje ku vdes vëtmia.

Tek përkëdhelte sytë e saj, Danieli mendoi, se përsosmëria e jetës qëndronte në zbulimin e shpirtit, ku hynte çdo qenie njerëzore.

- Sikur ta dish sa e kam pritur këtë çast Julia, - i tha Danieli.

Qelqnaja e qiellit ishte thyer në dritë, pa pluhur dhe erë. Ajo kishte një bukuri të ftohtë ajrore, të cilën Danieli megjithatë e pëlqente. I mjaftoi bukuria e thellë e shpirtit që ishte thuajse një përndezje fluide e ngashme me vallon e qiellit. Duke hyrë brenda saj, mendonte se kishte një shekull që e njihte. Jetonin të njëjtën jetë, si një magji, të

cilën e shndërruan në një dashuri që kishte munguar. Danieli apo kishte mbushur të tridhjetat. Kurrë nuk i kishte pëlqyer sentimentalizmi. Ndoshëta ishte zhytur në botën e informacionit qysh kur mendoi se dinte t'i përkushtohej fjalës dhe të vërtetës. Falë atij përkushtimi ishte bërë një nga gazetarët më të njohur të së përditshmes më të madhe "Fjala". Kohë pas kohe kishte shtyrë të kaluarën, për të kapur të nesërmén. Ajo ekzistonte, sepse pohonte të ardhmen. Asnjëherë nuk i kishte pëlqyer ta shihte jetën nga jashtë, përkundrazi, tek shikohej në sytë e njerëzve si në një pasqyrë i besonte mendimit të brendshëm të qenies njerëzore. Shpesh e krahasonte fjalën me rrymat e zemrës, ku materia e saj ishte reale. Tashmë e kishte rrëmbyer dashuria. Ajo nuk ishte më aq larg, sa e kishte imagjinuar. Ditën kur kishte lindur një ndjenjë e tillë, mendoi se njeriu duhej t'i përkiste dikujt. Vizioni i jetës ishte afrimi me një qenie tjetër, e cila të ekzistonte brenda tij tërësisht.

Julia ishte ulur në cepin e saj të përhershëm në bar "Mumja". Vështronë pikturat e reja që një seleksionist i panjohur i kishte ngjitur në korniza të murrme mbi bardhësinë e murit. Njollat gri të pikturave kishin një vijë ndarje dhe ca emërtime të veshura me shprehje të marra nga arti, si: „Njeriu në emër të pasvdekjes”, „Njeriu nën xhamat artificiale shikon të shkuarën dhe të ardhmen”, „A je e dashuruar”, „Secili ndryshon dhe bëhet i bukur nga dashuria që vjen” e të tjera shprehje të çuditshme. Me siguri këto mendime ishin të bazuara tek mëdyshja. Julia mendoi se askush nuk mund të mbijetonë pa harruar të kaluarën, e cila ishte rrezikuar nga pamja bardhë e zi. Ceremonia e depërtimit të ngjyrave tek njëra-tjetra, ishte një tejkalim i dëshirës, për të zotëruar të ardhmen. Julias i pëlqenin ngjyrat e gjalla, ku depërtontejeta, sensi i përtëritjes së fjalëve dhe shenjat e kohës.

Nuk u çudit që piktori i panjohur kishte ndarë në copë e çika bardhë e zi, pjesë të së njëjtës lidhje, të cilat më pas kishin denigruar në njolla të hirta, çuditërisht të gjalla. Sipas tij njerëzit ishin bërë të famshëm pas vdekjes. Të gjallët kishin filluar të vuanin humbjen e ngadalëtë të kohës, që nuk e dinin, kur do të soste. Të gjithë mbanin në kujtesë vetëm fotografitë. Ato nuk ishin asgjë më tepër, por një letër, ku ngajohej fytyra e kohës dhe e njeriut, i cili formonte historinë. Julia endej në të ardhmen. Danieli mendoi, se ishte më mirë që ajo të meditonë, se çfarë moskuptimesh kishte brenda sistemit të saj të mendimit. Disa herë, ai kishte heshtur, kur pikërisht Julia e pyeste, se si mund ta shpjegonte një gazetar që mblidhët jetë të vërteta njerëzore, idenë e përcmimit të jetës?

Atë ditë, Julia mezi e kishte lexuar emrin e studentes së anglishtes që kishte vrarë veten. Në fotografi ajo dukej një vajzë e hijshme. Të linte përshtypjen se lidhja e saj me jetën sipërfaqësore kishte mbaruar, ashtu siç këputet një pjesë e tërë nga pjesa tjetër. Vajzës i kishte munguar hapësira për jetë. Besoi në vdekjen për të gjetur qetësi. Nxitoi për të qenë në vetmi, në shpërthimin e dhimbjes e të humbjes, për të jetuar paqësisht me veten. Fajin sërish ia vuri gjuhës së keqkuptimit, zhveshjes së fjalëve të shpresës. Vajza kishte dashur të ishte në qendër të një shpirti, por tashmë ishte e qenësishme vetëm në fotografinë e vdekjes. Ngjante krejt e pafajshme. Julia ndjeu një therje të drejtpërdrejtë në gjoks, kur rrëthoi me sy portretin e saj. I erdhi keq që sytë e vajzës e kishin përjashtuar jetën nga trupi i botës. Ajo kishte dashur të ikte edhe pa të.

- Paska pasur një dëshirë të marrë, - tha një burrë i hollë, pranë veshit të saj. - Sot njerëzit lëndën e marrëzisë e gjejnë tek vetja. Ata përcmojnë me një urrejtje të dyfishtë idenë e mosqenësisë. Eshtë thjesht një shprishje e jetës, një mënyrë e dobët për të qenë e parakohshme në këtë botë. Zoti e ndihtë!

Dita ngadalë po kthehej në një vetëflijim. Muzgu apo kishte rënë mbi hijen e saj. Atëhere, kur zbuloi se i mungonte e nesërmja, kishte tërhequr pas vdekjen. As kishte klithur, as kishte pranuar të lutej, por vetëm ishte veshur me një fustan të tejdukshëm ngjyrë reje, ku depërtonte nata. Para ndriçimit të dritës qe spërkatur me parfumin më të shtrenjtë, kishte lyer buzët me një të kuq pa ngjyrë dhe ishte hedhur mbi vdekjen.

E ëma e studentes nuk e kishte prekur as me sy këmishën e natës që e bija kishte zgjedhur si armë për të paguar ikjen në botën tjetër.

- Jepi mirësi shpirtit të saj, - u lut Julia, para se trupi të mbyllej në arkmortin e bardhë me dilemën e fajtorit dhe të pafajshmit. - Ajo nuk arriti ta dashuronte jetën. Amen !

- Për fat të keq viktimat i marrin me vete sekretet kur ikin, ashtu siç kalon një ditë, - tha Danieli, tek hodhi në celuloid fytyrën e saj.

Ai e kishte marrë jetën, ashtu siç i kishte ardhur, me të mirat dhe të këqijat e veta. I mjaftoi një shikim i Julias, e cila apo ishte kthyer nga varrimi i studentes. U shkëput nga ideja se vetëdija njerëzore kapërthehej në zbrazëti e mbështillej në përhumbjen e trupave. Ajo vajzë, në orën katër të mëngjesit, vari veten, e mbylli atë natë kronikën e zezë në gazetë.

Kur u zgjua ishte në krahët e Julias. Ndjeu erën e lëkurës së saj të gjallë, preku buzët e lagura dhe u mbështet mbi gjoksin e mbushur me jetë. I mbështollë me krahët e hapur trupin, sikur ajo t'i largohej papritur. Jehona e ndjenjave u përplas nën qiellin e zgjimit. Julia shikonte trupin e tij të lëshuar nën hijen e kaltër të syve të ditës. Atë çast i besoi pushtetit të jetës. Dashuria ka fuqinë, për të bashkuar dy zemra dhe jo për t'u ndarë prej tyre, mendoi kur gishtat e tij ishin zhytur nëpër dridhërima kënaqësie.

Mëngjesi lëvizi gjoksin sikur të mbante mbi vete miliona dashuri që i shtrëngoheshin si rrezet rrotull tokës duke luajtur valsin e lindjes së diellit. U ngrit, ndërsa ai ende i përshpëriste në vesh ca fjalë të ngjitura me ëmbëlsi. Përgatiti kakao dhe lëng portokalli. Danieli i vendosi në tryezën e ulët afër dritares. Nën rrathët e ditës, fytyra e Julias i njigate e ndërfutur në praninë e të tjerëve. Fytyrat e ikura i zhdukeshin pak nga pak, kurse ajo fytyrë i afrohej deri në mish. Ishte njësoj, sikur të qenë një trup i vetëm, përmes të cilët depërtionin ndjenja që bashkoheshin nga brendësia e lëviznin nëpër jetë të tjera, ku çlirohet vetëm dashuri.

Majtas bulevardit disa aktorë francezë po luanin teatër komik mbi gënjeshtrat, ku njeriu lejohej të besonte aq sa i pëlqente.

- Nuk më pëlqen zhgënji, - foli i pari Danieli.

Frymëmarrja e saj ishte e qetë. Dukej se i kishte harruar të gjitha zhgënjet.

- Unë e dua fitoren e dashurisë. - Vetmia është një botë e zbrazët.

Ajo i ishte lutar Danielit ta kalonin fundjavën diku larg zhurmës marramendëse të kryeqytetit. Danieli kishte pranuar me kënaqësi. Brenda një mikrobuzi, rrinin ulur dy vajza dhe një burrë. Ata mërmërisnin me zë të ulët thashethemet e ditës. Askush prej tyre nuk pushoi deri sa arriten në luginën e gjelbërt. Julia asnijëherë nuk e kishte kuptuar, pse njerëzit merreshin më shumë me të tjerët sesa me veten. I dukej, se ata gjendeshin në një gjendje largimi nga vetja. Zbulonin turpin e krizat e mendimit të një grupi, apo ringjisnin fjalë të nxjerra nga përfytyrimet e humbura në vetëdijen e tyre. Fjalët merrnin dhenë, ulërinin nga skaji i zgjimit deri në shuarje. Pastaj ktheheteshin në një shpifje të verdhë, që fshihej nga kujtesa e njerëzve. E keqja më e madhe ishte se më vonë zhvilloheshin ngjarje të reja, të cilat edhe pse mund të ishin të rëndësishme, nuk ishin të

besueshme, pra harroheshin shpejt. Sipas shitësit të qumështit, njerëzit zienin brenda vetes. Përpiqeshin të mos mbanin mend asgjë, pasi çdo ditë ishin pushtuar nga bashkëngjitet e ngjarjeve të njëta, të cilat nuk i çudisnin aspak. Fjalët rraskapiteshin, shtynin me forcë vvetetën dhe zbrazeshin si mbeturinat.

Julia mbërtheu bërrylat në mbajtësen e dritares së makinës. Ndjeu erën t'i hynte në gjoks. Ajri i kthjellët po i prekte të gjithë trupin kur ajo si një fëmijë e lumtur nxori kokën jashtë dritares. Dukej se mbante lidhje me aq shumë shpirtëra. Danieli besoi, se ajo kishte një forcë të brendshme mirësie, sa tashmë ishte mbështjellë me një dashuri të madhe. Ai kishte njobur edhe vajza të tjera, por ato e kishin thërrmuar dashurinë në copëza të imta dhe një ditë e kishin hedhur në erë me duart e tyre. Sipas psikologëve gratë kishin gjetur një mekanizëm të çuditshëm, për t'u zbrazur ndaj burrave. Hakmerreshin kundër tradhëtisë në një formë të barazvlershme. Duhet ta kafshonin hidhërimin, për të njobur shijen e tij të hidhur. Burrat që dikur e kishin përjetuar ndryshe jetën e shihnin me dyshim atë kohë. Disa shanin luftërat, të cilat kishin pjellë sisteme të drobitura shoqërore që u kishin marrë një pjesë të potencialit të tyre. Ndoshta nuk ishin në gjendje të gjenin atë pjesë të fuqisë, e cila kishte kaluar tek pjesa tjetër.

Julia nuk dëshironte të lodhej pas fragmenteve të tillë, apo të sillej rreth ideve të shkuara që i kujtonin ca filma serialë, ku njeriu më në fund njihte formën e tij. Vetëm tani që ndodhej më afér se kurrë brenda një shpirti tjetër, ndjente se ishte në të ardhmen. E shkuara ishte një ëndërr e harruar. Ajo i ngjante me një çelës që dinte të hapte shpirtëra e të ringjallte një zemër gruaje. Lidhja e tij e fundit ishte këputur, pikërisht sepse ajo nuk kishte ekzistuar. Dikush i kishte telefonuar, se e dashura shkonte në shtrat me një burrë tjetër. Ishte njëlloj si t'i kishin thënë, se

gjithçka kishte vdekur. Julia u habit. Ai i kishte lejuar vetes atë pasdite të gjykonte jetën e një njeriu. Diku larg hodhi vështrimin dhe ndjeu se vetëm era ishte mes trupave të tyre. - Një pjesë të së kaluarës duhet ta rrëzojmë nën hendekun e harresës, - tha Julia, kur Danieli kujtoi sërisht dramën e dashurisë së tradhëtuar.

**N**gjarjen më të shpifur e kishte shkruar një gazetare e panjohur për revistën „Gruaja”. Guvernatori i bankës ishte zbuluar nga e shoqja duke iu lutur një pianisteje bjonde të bëhej dashnorja e tij. Gruaja e bankierit, pas aventurës u zhduk me një të dashur të ri. Rreth mesnatës i dërgoi një mesazh në telefon të shoqit. Ishte e njëjtë zbrazja e poshtërimit, ashtu siç zbrazej një gotë verë. A nuk ishte logjike të luante edhe ajo, të njëjtin rol?

Sipas gazetares, burrat i ishin kthyer intimititetit të mesjetës. Gruaja e tyre bëhej ajo grua që dinte të fitonte famë dhe para. Kjo lloj lidhje, kishte marrë në qafë burra me emër. Historitë e ndriçuara nëpër libra, shpjegoheshin me fshehtësinë e së vërtetës. Pastaj, pastaj brenda secilit shpërndahej urrejtja. Thua jse ishte e ndërsjelltë. Kishin lindur si ëndërrimtarë dhe po iknin të panjohur, sepse nuk kishin pranuar brenda vetes zbritjen tek e vërteta. Dashuria nuk mësohet përmendësh si një poezi e mbyllte shkrimin gazetarja. Fundi i dashurisë është vdekja e saj.

Julia hyri me njëfarë dyshimi në një kafene internet, afér qendrës, e cila ishte gati e boshatisur. Një rrip i hollë drite tkurrej, sa herë hapej dhe mbyllej hyrja kryesore. I pëlqente shpesh që pas provave të sfilatës të pinte një kafe krejt e vetme, e të zbulonte në internet të rejat më të fundit të modës. Edhe dy javë kishin mbetur nga sfilata e pranverës. Megjithëse dimri kishte qenë i butë, shiu

përnjëmend kishte harruar të kthehej. Shitësi i qumëshit mendonte, se shiu ende ishte në udhëtim. Do të binte një mëngjes, përparrë se të dëgjoheshin zhurmat në qiel.

Julia lexoi me vëmendje jetëshkrimin për topmodelen e fundit. Ajo kishte fituar sfilatën e dimrit në Nju Jork. Veshjet e salloneve amerikane që binin më shumë në sy, ishin ca fustane ngjyrë uji, stampuar mbi një sfond me yje, në copa mëndafshi. Imagjinoi prapaskenën. Jeta e modeleve ishte një përpjekje. Sipërmarrësit deri në momentin e fundit ishin nën krizën e spektaklit. Modelet ngjanin të mbështjella me drita të lakuriqta. Dukeshin, se po ndizeshin në pasarelën e veshur me lule origjinale. Pothuajse i pëlqente të ndiqte të gjitha sfilatat e modës nëpër sekuencat e ekianeve të televizioneve. Por aty shfaqeshin më shumë bëmat e djemve të rrugës, dhe fytyrat e varura nga mbipesha të politikanëve.

Julia buzëqeshi, kur në pasarelën e gjelbërt u shfaq ylli i saj i preferuar Eva. Nën duartrokitjen e shikuesve, ndjeu se bota e modës ishte bota e përfytyruar e trupave. Atje njeriu gjente episodin e së bukurës.

Ende nuk i ishin larguar emocionet, kur doli nga interneti. Brenda vetes mbante një tension midis idessë, për t'u bërë dikush në jetë e për t'u ngjitur deri në shembelltyrën e topmodeles që shkëlqente nga përsosmëria. Eshtë e mjaftueshme për njeriun të pranojë prirjet e veta e të ketë forcë, për të besuar, tha me vete. Vështroi qiellin e ndarë në dy pjesë, njëri i mbushur me yje e tjetri i veshur me re në pritje. Diku larg dëgjoi një bubullimë. Era e heshtur fërshëllente duke thërrmuar njollat e reve në pikë shiu të mëdha. I pëlqente të shihë gërvishjtjen e qiellit nga krisjet e përndritjeve që kryqëzonin tokën dhe ajrin. Kujtoi vargjet e një poeti spanjoll. Ai e krahasonte erën, me ardhjen e një ndryshimi, ku shihej harku i një dielli të ri zhveshur nga cipa ereve.

Ik, ik para se tē fryjë era,  
Pasi nesër do tē jetë më mirë  
Trupat gjysmë tē qetë nga prekja  
Nuk do tē ndahen, as në atë botë.

Sa herë e kishte tmerruar ndarja, brenda mishit kishte ndjerë rënkimin shpirtëror, që i frynte si erë e çartur. Ajo e shtynte në një botë krejt bosh.

Ndjeshmëria për tē zbritur në pasarelë, kërkonte një dashuri dhe një dhimbje tē pafund, që kushtonte sa vetë e nesërmja. Revistat e modës në kopertinat e tyre e konsideronin një modele tē pëlqyer. Ajo kishte patur guximin tē shfaqeji e çliruar nga e shkuara, për tē gjetur në formën e së bukurës përsfityrimin e së ardhmes.

Julia pa hijen e saj tē zhvendosur mbi skenën e lirë. Ndoshta për tē parën herë u pushtua nga mendimi, se edhe vdekja ishte një gjendje ëndrrre. Shtyu hapat e qetë në mes tē bulevardit ku rrëzoheshin aventurat e ditës. Mendoi se një tërheqje drejt zbrazëtirës ishte një vetëvrasje. Ndoshta atje qëndronte fundi i kohës. Tashmë qe bërë një pronare e ëndrrës së vërtetë, e cila kishte lindur aq herë, sa ajo tē paktën për një çast t'i largohej asaj ndjenje e tē jetonte kohën e përjetshme.

Në tē vërtetë, njeriut i mjaftonte vetëm jeta. Zhdukja e trupit tē gjallë nën një lëkurë tē ftohtë ishte shenjë e fundit e rijetimit tē shpirtit.

Kur hyri në shtëpi, Angjelinën e gjeti tē zgjuar. I dukej se ajo kurrë nuk i besonte dy jetëve, por brenda vetëdijes e ngacmonte ideja e dy kohëve, e cila shlyente para njerëzve fajet dhe historitë. Secili është i bindur për tē mirën, apo tē keqen e kohës së dhruuar, nga një dashuri tjetër.

Gati dymbëdhjetë vjet më vonë, ndërsa mbanin në kurriz peshën e lirisë, disa syresh kishin synuar ta kthenin historinë e shtetit më të vjetër tē gadishullit tē lagësht në një histori reale. Afër dhe larg, njerëzit që shihnin pikën e

çmuar, për t'u lidhur me urat e botës, ndiheshin të hutuar. Shumica tërhiqeshin ngadalë e ishin të padurueshëm. Mesazhet e ngadalësimit vinin mbi ca rrathë të padukshëm njerëzorë. Ato rendnin para zërit të një bote, në ikje prej trupit të vet.

Për fat të mirë, ndërsa lëviznin për të kapur botën, merreshin vesh me dheun e tyre nëpërmjet shqisës së shikimit. Çdokush ruante çelësin e shpirtit dhe kishte përshtypjen, se derisa të bëheshin stërgjyshër, shtëpia e tyre ishte mërgimi i trupit, por jo i syve të zemrës.

Sipas vajtimit të të parëve, gjunjët rrëshqisnin shtatë qiej larg, për të dëgjuar rënkin min e nxeh të dheut. Ditën e shtatë, ata mbanin në kurriz peshën e mallit dhe lagonin jashtë vetes lamtumirat.

Danieli e priste në bar "Mumja" rreth orës gjashtë, për t'i thënë një sekret. Ajo nuk e kishte parë të arsyeshme të rezistonte, për të mësuar sekretin e tij. Gazetarët, besonin se përbënин pushtetin magjik. Shpesh grindeshin me fjalë, për të pranuar, se shtypi nuk ishte arsyë i rikthimit të lajmeve pa zë, por një formë e bashkimit të zërave. Duela zhvillohej mes gazetarëve të kronikave. Ata e paraqisnin të ardhmen me ca lajmërimë aq barbare, sa Angjelina mendonte se forca e fjalëve ishte e dobët.

- Fjala është kthyer në kufomë, - mendoi me vete dhe mbylli gazeten.

- Nuk mund ta marrësh me mend se çfarë i kishin punuar asaj vajze, - tha me një zë të dridhur Ada. E kishin përdhunuar, si të ishin qenie pa shpirt.

- O Zot, si qe gjakosur trupi i saj. - Nga brendësia shembeshin dëshirat, lutjet dhe urrejtja. Kisha menduar se në kësó kohë janë zhdukur barbarët.

- Ajo kishte vdekur bashkë me turpin e botës, që e mbante mbi vete, - tha Julia. Preku me gishta njoftimin e vdekjes. Lotët pa ngjyrë pikonin të heshtur nën lëkurën e zbehtë të

fytyrës. Tashmë vajza ishte vetëm një kujtim i hidhur në historinë e botës, një kujtim i denjë, ku dëgjohej klithma e vdekjes. Dhe ishte shtatëmbëdhjetë vjeç, ishte ende fëmijë.

Pak para se të binte errësira, Julia kapërceu sheshin e luftëtarit të lirisë. Madje harroi të priste Danielin. Nata lëvizte nën tisin e errët të saj. Kishte lënë pas vetes lamtumirën e viktimës. Ajo lëkundej nëpër erën rënkuese të yjeve. Poshtë tyre zgjateshin duart e lysave, që tërhiqeshin drejt shkretëtirës së periferisë, e cila fshihej në terr.

Kufoma e vajzës së vdekur ishte shtrirë në një dhomë të ftohtë. Fustani i bardhë i saj dukej i ngrirë brenda qepallave të syve. U ul pranë kufomës, sikur po zbulonte përndritjen e shpirtit. Jeta ishte shuar në ikjen pa kthim. Fytyra i ngjasonte me një kukull, e cila diç i kishte mbetur pa belbëuar nga buzët e murrëtyera. Përmes mureve të vdekjes kobzezë, kufoma mallkonte kujtesën e botës. -Pse më detyruat të pi helmin e vdekjes? - Oh, Zot përse nuk më dëgjon?

Kur po kthehej nga funerali, Julia mbështeti kokën në duart që i dridheshin. Pyeti veten, pse ishin këta njerëz nën kllapinë e mëkatit?

Ajo ndihej e lodhur deri në mëngjes, kur trokiti në derë shitësi i qumështit. Ai përmendi edhe njëherë se prijësit e shtetit ishin damkosur me vulën e së keqes. Koha qe kthyer në një lavire, e cila ishte ndarë nga burri, pasi e kishte kthyer në modë tradhëtinë.

- Më vjen keq pér këta njerëz të dëshpëruar, - tha shitësi duke numëruar lekët e qumështit nëpër gishta. - Duhet ta gjejmë bre fajin! Atyre u është thyer zemra. Kur nuk të mbron askush, duhet të mbrohesh vetë bre... Njeriu nuk lind shtatë herë.

Julia përshkoi e vetme udhën. Nuk dinte pse kishte filluar ta urrente atë qytet, të cilin e kishte èndërruar qysh

fëmijë. Diku dëgjoi zhurmën e zjarrfikëseve. Fytyra e mëngjesit ulerinte nga sirenat. Në anën e kundërt të udhës, pa Arlin. E përshëndeti. Kishte filluar ta harronte. I erdhi mirë që po ndodhët kështu. Ndoshta, ai ende po kërkonte paqen që i mungonte brenda vetes. Ndoshta kishte gjetur të nesërmën e tij, pasi nuk i pëlqente e kaluara, as kthimi tek të tjerët. Dikur ai e kishte quajtur Julian një grua të ndarë më dysh, mes jetës dhe vdekjes. Një natë me shi e kishte quajtur të marrë. Arli besonte se fuqia e tij mund të përthyente gjithkënd. E kishte shndërruar veten në një simbol të lumtur, pa pyetur çfarë ekzistonte jashtë tij.

Julia vështroi sytë që e ndiqnin në heshtje nga larg. Mendoi, se ai kishte nevojë të shëronte shpirtin, pasi i mungonte mirëkuptimi me të ardhmen. Për të fundit herë e pa në kryqëzimin e piramidës së zhveshur nga reflekset, atje ku përziheshin ngjyrat e ditënata. Në skajin tjetër të udhës ishte një zemër e mbështjellë me dritë që e priste të harronte hijet e mbetura në udhëkryq.

# M

uzgu e kishte rrethuar qytetin me një tis të kuq. Në shëtitoren mbretërore, njerëzit vraponin pa e ditur, ku do të mbërrinin. Falënderonin njëri-tjetrin duke përgëzuar lindjen e ditës ndryshe. Të gjithë mendonin se më në fund kishin hedhur në det një kohë të mbrapshtë. Sheshi u shndërrua në sipërfaqen e frymëmarrjes së paqes si diçka e gjallë, të cilën ata njerëz kishin shekuj që e rrëmonin. Dikush tha, se atë ditë të përkushtimit, disa shpirtëra ishin mëvetuar. Ndërsa pinin kupën e shpresës në fund të nëntorit, panë të shfaqej në fasadën e shqyer nga era një fytyrë që tërhiqte pas veten. Ca syresh besonin se kujtesa e asaj dite në thellësi kishte errësirën, kurse Angjelina D. tek shihte xixëllonjat e mesnatës ndjeu se i mungonte një shpirt. Ndezi me gishterinjtë që nuk i bindeshin qirinjtë, ku shfaqeshin dy sy. Ata kërkonin brenda saj shpirtin bosh.

Mëngjesi u ndriçua nga jashtë me reflekset e ndjesive të humbura. Ishte tmerrësisht e dashruar me ata sy. Ai dukej sikur shfaqej në fytyrën e kohës, ashtu siç merrte një formë tjetër para ikjes nga ajo ditë. Sërisht imagjinoi fytyrën e njeriut të fasadës, i cili mund të quhej përkrahës, shtytës i rrotës së historisë, qenie e mangët apo filozof i dalë boje. Por, ai nuk e dinte se e nesërmja ishte afër. Hijet e qirinjve ishin zhdukur pas djegies së natës. Angjelina e përfytyroi atë fytyrë si një ndjellakeq apo vdekatar i fshehur pas kohës tjetër.

Pjesa e vjetër e qytetit qe zhytur nën flakët e mbetura nga era e ikjes. Njerëzit ishin pushtuar nga ligjërimi i përkohshëm i njeriut që shpallte nëpërmjet pështymës së zërit të tij paqen e adhuruar. Kur i digjej para vetes ajo flakë, mendoi se zëri ishte pa kohë ose hije e së ardhmes.

Njeriu i mbështjellë me veten, ishte i ngjashëm me një fotografi të zmadhuar, e cila nga jashtë qe gjithherë e ndarë nga fytyrat e tjera.

- Tashmë ti do të mbulohesh me urrejtjen time, - foli Angjelina me zë mallkues. Imazhin e tij e krahasoi me dimrin. Fjalët i ngjanin të ngrira, të ftohta si lëkurë gjarpri, fshehur brenda figurës me një ngjyrë.

Në udhën e ftohtë ende kishte shenja nga ceremonia e festës, copëra letrash të flakura nëpër erë, grimcat e thirrjeve të fituesve dhe dhimbijet e humbësve.

Lajmi se paqja ishte si lëkura e njeriut lidhur pas trupit, dilte nga një gjuhë që kërkonte të mbrohej jashtë atyre zérave. Fjalët i binin si shiu i atij nëntori mbi fytyrë. Ato ishin të akullta dhe pengoheshin para dritës. Angjelina shpresonte të gjente shijen e vërtetë të gjuhës së paraardhësve. E megjithatë ajo ndjehej krejt e huaj në ato thirrje të fjalëve. I shkaktonin dhimbje për humbjen e Ertenit.

Në ikje të mundurit përfytyronin fitoren si një mbyllje të urrejtjes. Të gjithë e kishin të vështirë të kthenin kokën prapa. Ata largoheshin duke marrë me vete hijen e vdekjes. Paqja e adhuruar pas mungesës shekullore kishte një peshë, e cila bashkonte dy kraha.

Ajo kishte parë sytë e botës fare afër. Njeriu që i ishte falur jetës e pagoi shtrenjtë çmimin e lirisë. Mbante kokën lart deri në fundin e humbësve që u mundën nga e tashmja, pa u lejuar kurrë të mendonin për të ardhmen.

Njerëzit kishin synim të zinin një vend në histori me të vetmin qëllim që të dëshmonin se ishin të dashuruar pas

lirisë. Më vonë e festuan lindjen e saj me vdekjen e tyre. Askujt nuk i shkoi në mend se shteti paqësor jetonte mbi rrënojat e harruara të kapërcimit të vvetes. Fryma e prijësve ngatërronte shtetin me njeriu.

Pas një viti Angjelina po jetonte një marrëzi. Hija dhe fama e ndjellakeqësit zmadhohej me dimensione të çuditshme. Kriza e tij po kthehej e përzier me të nesërmen. Asgjë nuk dukej e sajuar për të prekur të tjerët, por ishte ikja prej vetes. Atij i kishte shkrepur të kthehej në një Zot. Adhuruesit e zakonshëm shanin me fjalë të urta imazhet e humbësve. Nën dritën e zbrazët shihnin fytyrën plastike të njeriut hije. Ai vazhdonte të shfaqej brenda mishit të pushtetit. Ca zëra, shndërruar në heshtje thonin se hija kishte frikë nga vetja dhe nga ata që e rrethonin, sepse ishte vetëshpallur tribun apo shenjt i jetës së të tjerëve. Gjithkund lëkundej në një hapësirë bosh. I pëlqente të dukej. Kishte premtuar se do të hynte brenda shpirtrave njerëzorë. Madje do të jetonte i pandarë prej tyre. Dikush kishte treguar, se ndjellakeqësi po binte në dashuri me hijen e tij. Ai luante me vveteten rolin e jetës me figura alegorike e gjeste të pakuptimta.

Angjelina tek shihte imazhin e hijes së gjallë, në sy i shfaqej fantazma mu në qendër të botës. Ai ditën predikonte teoritë e mrekullisë, kurse natën duartrokiste aventurat e reja.

Ajo po vallëzonte në udhë, kur e rrëmbyen krejt papritur. Brofi e mbërthyer nga duart e tyre. Teksa ishte duke vallëzuar me natën, ëndërronte për sytë e Erten S. Nuk e kuptoi, pse nuk e kishin lënë të vallëzonte në sheshin e lirisë dhe të ndjente dashurinë pas humbjes së saj.

Diku u dëgjuan nga larg tingujt e ndezur të “Botës së re”. Iu duk e pabesueshme, që trupi i vrarë në shpirt, të ishte në krahët e dikujt tjetër. Ata e urdhëruan të heshtte. Nuk i njihte, madje, nuk u dallonte as fytyrat prej dimri, që i silleshin rrötull si hijenat.

I ngjau se po ikte drejt udhëve të kujtimeve. Mbi kërthizë i lëvizte një gojë e hapur, që e bënte të ndjente skajin tjetër të vdekjes. Në prapaskenë “Bota e re” po hiqte shpirt. Ajo lexonte jetëshkrimin e saj të hidhur.

- E dini se jeni vetëm një fundërrinë e këtij qyteti? - i tha njeriu trupmadh fare pranë veshit. - Nuk e di si kanë besuar se ju jeni një yll i shpallur nga një botë tjetër.

Angjelina me zor po mbahej në këmbë. U tremb, kur e pa veten të futur në korridorin e ngushtë, mbyllur në një kornizë të ndryshkur. Hapi sytë dhe mendoi se ende ishte në vallzim me një èndërr. U zvarrit nga dhimbja. Larg dalloi vetëm ngjyra të errëta. Kérkoi një copë qiell. Ai përfytyronte shuarjen e yjeve dhe mbante në trup ditën e ngarkuar me borën e nëntorit të ftohtë. Mbi veten i rrëshqisnin petalet e këputura të luleborëve, që i ishin rrëzuar mbi fustanin e shqyer. Ndjeu se gjoksin e kishte të zbuluar, madje lakuriq me thimthat drejt qiellit.

Fshehu sytë për të mos parë asgjë. Gjithçka i ngjante me një botë të vogël, të zhveshur nga kujtesa. Në shembëlltyrën e saj i shfaqej montazhi i vdekjes. Mbi supe po i rrudhej një plagë. Ishte e habitur se si nuk humbi ndjeshmërinë. Mezi mbushej me frymë nëpër atë zhurmë marramendëse që i kishin dëgjuar veshët. Parandjeu se hija e vërtetë po zbulohet duke i ngjitur në trup vragën e së keqes, e cila ndodhej në botën e tij.

- Ti Angjelina dukesh më e bukur tanë, se sa kur mbërrite kulmin në interpretimin e simfonisë «Bota e re», - i tha hija, ndërsa ajo pa të ndizeshin sytë e Erten S.

I ngjau se ishte ngritur në qiell, për t'u shembur mbi tokë. Ngriti kokën dhe nuk e fshehu buzëqeshjen. Atë çast mendoi vetëm për Ertenin. I dukej se jetonte brenda përfytyrimit të tij.

Hija zbriti nëpër ca shkallë të errëta duke u lëkundur sikur të kishte humbur kujtesën. Ajo sërisht kérkoi me sy

një copë qiel, por ai tashmë ishte gri. Lart nuk shihej asnjë vijë e hollë kaltërsie. Hija për fat të keq ishte afër.

- Kjo botë ka një hyrje, ku mund të hyjë gjithkush, - i tha njeriu hije, ndërsa zbriste shkallën e fundit. - Kërkoje ta gjesht një ditë.

- Për fat të mirë, kjo botë ka dhe një dalje, - iu përgjigj Angjelina, kur ndjeu se nuk i

shikonte sytë e tij të ftohtë si bora.

- I dashuri yt doli nga porta e jetës, ndërkokë që ti nuk pranon ta besosh këtë fakt.

- Më duket se t'i jeton me shembelltyrën e tij, - vazhdoi të argëtohej njeriu, duke u ngërdheshur para se të zbulonte një dritë të dobët

- Unë kurrë nuk do ta besoj se Erteni ka vdekur, - ia ktheu ajo. Hija, nuk e imagjinonte se cili shpjegim ishte i vërtetë.

Dikur gjykoi për një skandal, pikërisht kur i thanë se Erteni kishte vrarë veten. Njeriut, që pa në fytyrën e saj sytë e Erten S. iu ndalua fryma. Skicoi një ditë të verbër, shndërruar në ndarje përgjatë ikjes në botën tjetër.

Të nesërmen kishin qarkulluar zëra të ndryshëm, se njeriu pa fytyrë ishte një shembull i keq. Bëmat e tij po merrnin dhenë. Shpesh prekjen e famës e kërkonte tek vetja dhe i urrente deri në vdekje idetë e të tjerëve. Çuditërisht ishte i verbuar nga ndriçimi i hijeve. Angjelina mbante në xhepin e brendshëm të këmishës fotografinë e Ertenit. Përsëiste e qetë se ai jetonte brenda shpirtit të saj. Askush nuk kishte provuar se kishte vrarë veten me një plumb të fshehur në gjirin e një gruaje. Ishte ndier e përtërirë, kur i ra në dorë një letër shkruar nga gishtat e tij, se vdekjen e kishte larg. Ajo nuk mund të besonte një vdekje pa e parë me sy.

Vdekatari kishte rrëmuar deri trupin e një gruaje, për ta detyruar Ertenin të vriste veten. Me fytyrë të mbuluar, gruaja

ishte ngjitur pranë trupit të nxeh të dhe kishte nxjerrë nga gjoksi armën e vetvrasjes. Në fillim ajo shkoi për të bërë dashuri me të. Kur ai ishte larguar shtatë hapa larg, i afroi gjoksin e zbuluar, derisa një plumb i errët iu rrëzua poshtë këmbëve.

- Ty të pëlqen gjoksi im, - i tha gruaja para se lëkura i tij të ishte e akullt.

- Cila mund të ketë qenë ajo grua? - mendoi deri vonë Angjelina, pasi dëgjoi atë histori të shpifur.

Ajo e dinte fare mirë se Erteni nuk kishte të dashura të tjera, aq më pak një vrasëse që dinte t'u dhuronte vdekjen të tjerëve. Kujtoi gjinjtë e harruar të gruas mbi lëkurën e bardhë, ku ishte zhvilluar lufta për jetë a vdekje. Të shtunën dëgjoi një histori tjetër, ku as më shumë e as më pak thuhej se vrasësi nuk ishte një grua, por një qenie përgjysmë si ato personazhet e romanit „Ankthi i epërt”. Atje të gjallët kërkonin të vdekurit. Për fat të mirë fisheku i ruajtur në fletët e librit të luleve ishte aty i myllur brenda vëtmisë së gjallë.

- Eshtë thjesht një gënjeshtër vdekja e tij, një shpifje pa lidhje, ku secili duhej të

besonte se jeta dhe vdekja ishin aq afér sa faqet e një libri makabër, - vijoi ajo.

- Ju këshilloj edhe njëherë të besoni vdekjen e tij, - i tha sérish njeriu që dukej sikur

përfaqësonte qendrën e botës. Zëri i mbeti në grykë.

- Jo, - iu përgjigj menjëherë Angjelina duke fshirë sytë me lotët e tharë.

Ishte mesnatë kur ajo ndjeu se po e rrëmbenin, për të dytën herë, pasi beteja për të besuar vdekjen kishte dështuar. Kujtoi vargjet e një poeti me shpirt të bukur. Ishte e sigurtë se brenda saj mbante ftyrën e Ertenit. Diku thellë shpaljej jeta, e cila ishte virtyt i zemrave që pranonin një ftyrë.

Nuk dinte pse ata njerëz e rrëmbejn krejt papritur, ndoshta, për të humbur gjurmët, për t'u fshehur nga drita, apo për të sajuar një marrëveshje, e cila po u digjej nëpër duar. Nga afër e ngritën atë iluzion si një spirancë, ku do të kapeshin sa herë të dëshironin, për të pranuar vdekjen e tij.

- Si mund ta lëshonin të tjerët spirancën e vdekjes, për të këputur jetën e dikujt? Kjo nuk është e vërtetë, është vetëm një shpifje e rëndomtë ose e sofistikuar. Eshtë aq larg koha e vdekjes së tij, sa ajo ende largohet e largohet. . .

- Vetëm nëqoftëse jeni e çmendur, mund të mos e besoni vdekjen e Erten S. - tha edhe

njëherë njeriu që e rrëmbente, pa shpresuar se ajo do të pranonte ikjen në atë botë.

Angjelina u habit kur e pa veten në një turmë të madhe burrash që silleshin si të përgjumur në heshtjen e shkretë të natës. Nuk njoihu asnjërin prej tyre. U struk më thellë në errësirën e fshehur që zvarrisej mbi hijet e tyre.

- Më duket se edhe kjo nuk jeton më në këtë botë, - tha më i riu dhe zgjati një këmishë në ngjyrën e dheut, për t'i mbuluar gjoksin e hapur.

- Duhet të pranoni se Erten S. është në botën e të vdekurve, - ndryshe për pak ditë edhe ti do të shkosh në atë botë, - foli sërisht ndjellakeqësi dhe e përplasi në tokë si kufomë.

Angjelina peshoi mbi murin e përhimë. Trupi i saj lëngonte nga heshtja e njerëzve, që ishin brenda vdekjes. Me sy të veshur nga shpresa, besoi se aty në atë kthinë kishte gjetur jetën. I duhej një shekull për të takuar vdekjen. Kryqëzoi edhe njëherë duart e mpira në gjoks. Zemra ishte aty, fare afër trupit dhe shpirtit, ku zbulohet magjia, për të larguar vdekatarin. Iu desh pak kohë, për të ikur nga kujtimet e zhveshura të natës së shkuar. Gjithçka ishte veshur me një tis të zi, derisa ishte mbjellë mbi të drita e

rrallë. Mbanie në trupin e praruar rojen e shpirtit. Në pjesën tjetër të hapësirës që mezi shfaqej, dalloi ca sy të braktisur ta shihnin si prenë e radhës së vdekatarit.

- Dëgjoni me vëmendje, - tha duke drejtuar trupin burri me moshë më të re. Ai ndoshta, priste nga çasti në çast vdekjen.

- Trupin dhe zemrën e kësaj gruaje të mos e prekë askush.  
- Hapni sytë mbi gjoksin e saj, vështrojeni dhe ndjehuni qenie të vërteta. Endërroni mbi cicat e një gruaje, por ama nuk keni të drejtë ta cënoni aspak. Ndryshe, do të vdisni para meje. Më dëgjuat mirë, apo... ? Kjo grua nuk di të vdesë, sepse ajo është kthyer me «Botën e re» në këtë terr të humbur. Angjelina D. kurrë nuk i ka besuar vdekjes, por dashurisë, e cila mbijeton me njeriun. Vetëm përfytyroni zotërinj, përfytyroni. Shpesh koha është një lloj përfytyrimi.

Ajo njuhu zërin e Anton L. Nuk e kishte harruar. Iu duk se ende vallëzonin në bregun e huaj.

Të gjithë heshtën. Secili prej tyre kishte parë gjirin e saj të zbuluar. Pikërisht aty dalluan me sytë e kthjellët vetë jetën. Kishte qenë mjaft, që ata të mos i besonin kurrë vdekjes.

- Jeta nuk është vdekje Angjelina D. - foli nëpër gjumë Antoni.

Natën ata burra ishin mbështetur në përfytyrimin se po flinin mbi gjoksin e Angjelinës. Askush prej tyre nuk guxoi ta prekte, as me duar, as me sy, vetëm luteshin brenda përfytyrimeve të jetonin mbi trupin e një gruaje.

- Ku jam, - pyeti ajo me një fije zëri të mbytur burrin e vjetër, që i afroi një copë bukë të zezë. - Nuk ka shumë kohë që jam kthyer nga bota e re. Nuk di, pse më kanë rrëmbyer nëpër natë? A mos jam në një burg të përjetshëm apo në honin e vdekjes? Pse e duan shpirtin tim? Ai kërkon të jetojë në paqe dhe jo në një zbrazëti të humbur.

Dikush bëri thirrje për qetësi, por ajo krejt e mbledhur skrupull ngriti sytë e gjelbër, për të mbushur ata sy të harruar. Kërkoi të thoshte diçka, por u ndie e zbrazët. I ngjante se ishte kthyer në një numër, apo në një pjesë të krisur, ku e shkuara po vdiste dhe e ardhmja vuante nga sëmundje të panjohura.

- Lëreni të flasë, - përsëriti sërish Anton L. - Njeriu ndjehet më mirë, kur i thotë diçka të tjerëve. Ndoshta në fund të fundit i beson ekzistencës.

Brenda saj kishte shpërthyer përpjekja për të gjykuar para shpirtërave njerëzorë. Gruaja, krijesa më e ëndërruar për gjithësinë, fryma e lindjes së vetë jetës dhe zemra më e bekuar e botës ishte rrëthuar nga etja për dashuri. Kush tha se Erten S. ka vdekur? Ajo zbuloi sërish gjoksin e bardhë.

- Shikojeni gjoksin tim, jetoni brenda tij, - tha Angjelina. Këtu janë valët e jetës dhe bregu i ëndrrave.

- Më falni, - iu drejtua një djalosh i ri duke i mbuluar gjirin që shembej mbi lëkurën e palëvizur. - Mos ki frikë. Këtu nuk je në një bordello, por në skajin më të largët të lirisë. Përhumbja nuk është asgjë më tepër se një lajmërim për vdekjen. Ne jemi të mbushur nga dhimbja për lamtumirën e kësaj bote. Kemi matur me tik-takun e zemrave tonë ditën dhe natën. Kemi dëgjuar lavjersin e jetës nën këmbanën e vdekjes. Por kjo kohë nuk ekziston. Ajo nuk është as e gjallë, as e vdekur. Mos ki frikë nga ne. Jemi të parrezikshëm për një trup gruaje.

Angjelinës iu duk se ndjeu në shpirt peshën më të rëndë që kishte mbajtur gjatë jetës. Bota ishte përmbysur sipër saj. Mendoi se ndodhej në një spital, ku vdekatari kishte sajuar disa marifete për të çliruar njeriun nga vetja.

- Po çmendem në këtë humbëtirë, - klithi ajo, ndërsa shihte fytyrat pa ngjyrë të burrave, që e rrëthonin. Ata dinin të heshtnin. Instinkti i krijuar qysh nga lindja

kishte thithur çdo përmbajtje të ndërsjellë brenda qenieve të tyre.

- Megjithatë, - mos ma mbuloni gjoksin. - Le të lëshojë dritë jete nëpër errësirë. Harrojeni vdekjen. Ndoshta trupi i një gruaje bëhet pikëmbështetje, për t'u mbrojtur nga kjo natë e errët pus.

Angjelina pa burrat, të cilët vraponin si të ishin mbi një zjarr. Ata flisnin me kode, sikur të qenë memecë. Vështroi edhe njëherë lindjen e diellit, pasi ai kishte lëshuar energjinë e tij për një ditë tjeter që fillonte me dashurinë. Sërisht e pyeti veten, se çfarë kërkonte vdekatarit nga heshtja e saj? Përse ngulte këmbë të pranonte vdekjen e Erten S.? Apo kërkonin një provë, për të vrarë kohën.

**I**shte shumë e lodhur, kur u shtri në një cep tmerrësish tē pistë. Kérkoi tē mbyllte sytë, pér tē harruar atë pérjetim, mbërthyer brenda murit tē zbrazët. E krahaso i veten me një kufomë. Ajo kishte mbetur aty nën vështrimet e asaj turme burash tē panjohur, që e ndiqnin me një ndjenjë mëshire e dashurie munduese. Lotët i rrodhën nëpér fytyrën e zbehtë, tē çjerrë nga hija e vdekatarit. Nuk e dinte ende, pse ndodhej në një botë pa diell.

Imazhi i Erten S. i afrohej, sa herë zvogëlohej hapësira e rrokaqiejve që lëkundeshin nën erën e vjeshtës. Diku larg i shfaqeshin sytë pa jetë tē njeriut, i cili kérkonte vdekjen e vërtetë.

Nata e lagësht i hyri në gjoks, kur përsëri e pa veten tē zhveshur. Ishte mbështetur tek jeta. Ajo nuk e kishte braktisur, por ideja e vdekjes ishte si një pritje pa fund. Humbja nuk do tē ndryshonte asgjë, sepse ajo nuk e kishte menduar asnijë çast vdekjen. Ndonjëherë i ishte afruar duke thirrur emrin e saj dhe tē Erten S. Nuk ishte vdekja e keqja më e madhe e botës. Do ta kalonte edhe atë natë tē shpifur. Ishte koha më e çmendur e jetës. Zëri kërcënues e pyeste sërisht, pse jetonte me një ëndërr tē vdekur? Fytyra e tij i ngjante me një fytyrë kufome, e cila kérkonte në ajër pëlburën e vdekjes. Vdekatar i dinte se Angjelina D. do tē kundërshtonte tē qenit e humbur.

Nata kishte kafshuar mishin e saj, ashtu si kanibalët thërmonin kockat e mbetura të viktimës. Ulërima e agut qe kryqëzuar nga dhimbja. Vështroi e qetë fytyrat e burrave, të cilët shihnin tek njëri-tjetri sytë e saj. Nën orën tragjike të lamtumirës, dallohej shenja e thellë e shpresës.

Kishin kaluar tri stinë. Ajo dëgjonte ende vaj për vdekjen e Ertenit. Mirëpo, paracaktimi i vdekjes se tij nga një krismë ajrore, të cilën nuk e kishte dëgjuar askush në qytetin e lodhur, i habitit të gjithë. Fryma e zemërimit i ndau njerëzit në dy pjesë të ndryshme. Ata vazhdonin t'i besonin të kundërtës së ndarjes ngajeta të Erten S. Dikush tha në agun e së nesërmes, se lamtumira ishte shndërruar në një përshëndetje, ku mbizotëronte zëri i gjallë i tij. Ishte e vështirë të kombinonin deshifrimin e ndarjes së fjalëve brenda një viktime. Njerëzit nga portat gjysmë të hapura kishin parë tretjen e territ mbi tokë, por jo kufomën e Erten S. Pothuajse ishin shtangur nga histori të tilla dhe besonin në kthimin e tij.

Vdekatari i marrosur përhapte fjalë nga më të çuditshmet. Ato i flakte në udhët e shurdhëta, për t'i bërë sa më të besueshme për njerëzit. Madje i habitit të gjithë, kur i akuzonte se u mungonte kujtesa, pasi Erten S. kishte sulmuar veten për ta vrarë. Sipas tij, ai kishte shtirë mbi jetën, për të pasur fuqi mbi historinë, ose për t'u bërë i njohur, pse jo i pavdekshëm. Në fund të majit ngjarja që kish ndodhur nisi të përflitej. Ai ishte paragjykuar duke zbrazur nga goja e tij copëra historish që zgjonin kujtesën e qytetit të fyer. Shpifja se Erten S. ishte shuar brenda një agu, thyhej nëpër ulërimën e një zemre. Askush nuk bindej për vdekjen e tij. Plaku më i vjetër i qytetit, që i njihet të gjithë, tha se mungesa e atij njeriu po e plakte më shumë qytetin, ndaj duhej të mblidheshin në kuvend, për të gjetur atë zemër të humbur.

Angjelina nuk e kishte ndier kurrë veten më pa formë, sesa të djelën në mëngjes, kur dëgjoi se ishte pa trupin dhe

frymëmarrjen e tij. Dita kishte ardhur me një qiel të ftohtë, të cilin po e mbytnin retë e hirta. I dukej se kishte hyrë në një botë tjetër, ku dëgjoheshin vetëm lajme të këqija. Qendra e pérjetimit i afronte skena të panjohura në kolonën e trupit.

Qyteti ishte mbyllur në muret e përfytyrimit të vetr拉斯 së trupit të vet, pikërisht kur mbeti krejt i paqartë përrrethanat e vdekjes së Erten S.

Angjelina vendosi dorën e Antonit mbi supet e saj. Heshtja kishte nënshkruar vdekjen. Në zbrazëtinë e përmbytur besoi se ishte gjallë. Buzët i dridheshin, teksha sytë e tij e ndiqnin, sikur të vështronin një të vdekur.

- Ne i jemi dorëzuar jetës, ndaj askush të mos mendojë përvdekjen, - tha ajo me një zë gërvishtës. - Lëreni vdekjen të zhduket prej syve tanë. Le të presim të ardhmen.

I dukej se po ecte përmes tyre me fjalë dhimbjesh drejt shpresës. - Endërroni për jetën. Këtë mund ta bëjë vetëm ai që mbështetet tek dashuria.

Njollat e murrme të reve ishin nënshtruar para urisë së diellit. Majat e zjarrta të rrezeve preknin fundin e fshehur të heshtjes.

Angjelina lëshoi flokët e gjatë përmbi krahë, sikur të donte të mbështillte me to ditën e trembur nga vdekatarri. Njerëzit që e rrethonin ngjanin të palosur me njëri-tjetrin. Dukeshin të zmadhuar brenda vetes, pa ditur se shtegtimi i tyre do të ishte fundi i një tragjedie. Bota e re nuk ishte pjesë e trupit të vdekur, por do të kremitonte ditën e lamtumirës, mbi gjymtyrët e gjalla.

Angjelina nuk besonte, se vdekatarit, të cilin e njihet kohë më parë, i kishte hipur në kokë ideja e të qenit zot i të gjithëve. Madje ai përralliste, se i ishte shfaqur një fuqi si ajo e legjendës së Mujit. Ishte gati të kthehej në një mit.

Angjelina e kishte ndier se në këtë botë, së pari duhej çliruar shpirti, pasi ai krijonte largësinë midis shpresës dhe

dëshpërimit. Një shpirt i robëruar sendësohej në një relike të kotë, ndonëse asgjë përveç hirit nuk krijonte rreth vetes. Gjithkund kishin mbetur përshtypjet e thërmuara që harroheshin si netët vetmitare të dimrit.

Atë mëngjes Erteni i kishte shkruar dy rreshta. Ato fjalë nuk ia kishte thënë deri atëhere: „Trupat tanë janë para furtunës. Duaje jetën. . . „, Asnjëherë nuk kam ikur prej teje...

Fjalët dukeshin nën harkun e agut si nyje të lidhura brenda vertebrave të trupit. Ajo ndieu rrahjet e zemrës t'i përsëriteshin nga ajo tërheqje e fjalëve.

Njerëzit duhet të kishin durim, për të pritur një ditë ndryshe. Ajo do të lindte e kthjellët për herë të fundit. Ndoshta jo të gjithëve do t'u mjaftonte liria që e kishin fituar me jetën e tyre, por e ardhmja do të thyhej në mes. Fillimisht nuk i kuptoai ato fjalë të ndara. Iu shfaqën të trishtuara, të turbullta, të pushtuara nga largimi pa lamtumirë.

Angjelina kishte besuar se kufiri mes jetës dhe vdekjes ishte si nata, e cila kafshonte ditën, pikërisht, kur e shkuara ishte vetëm një reflektim. Lotët i rrëshqitën nga qepallat e rënduara, tekxa shihte rrënimin e së ardhmes. I erdhi të përzier, kur kuatoi prijësin.

- Ti, Angjelina, je pa të shkuar e të ardhme, - i kishte thënë ai një ditë të ftohtë nëntori, kur natyrës i mungonin ngjyrat. - Pothuajse je si kjo erë që fryn lart e poshtë si e marrë.

Ajo, dëgjonte fjalët e hidhura dhe ruante në shpirt një dashuri gruaje. Duhej të jetonte brenda dy zemrave.

Nata dukej sikur ishte përfshirë nga stuhia. Shkrepëtimat sajonin një bisht zjarri në atë qeli të ftohtë, ku jeta zhdukej dalëngadalë. - Më duhet të jetoj edhe për Erten S. - i tha vetes.

Prijësi shkundej në shtratin e muajit të mjaltit. Për të fundit herë mendoi se e kishte flakur në udhë Angjelina D.

si një mbeturinë të kujtimeve të shkuara. E kishte përplasur atje në një cep të errët mes tridhjetë burrave, për ta kthyer në një lavire të përjetshme. Dikur e adhuronte si i çmendur. Nuk dinte pse ende rijetonte me një grua tjetër, e cila, për habi të tij, kishte të njëjtat sy, të gjelbër. Ishte përpjekur të largohej nga ata sy, por nuk kishte mundur.

- Kam përshtypjen se ai njeri që kërkon shpirtin e një gruaje tjetër, i mungon vetvetja - i tha atë natë Ertenit. - Si mund të çlirohet njeriu nga dashuria pa dashuri?

Erteni e mbante dashurinë si një perëndi në rrizuillin e zemrës.

Gruaja e tij doli nga vila e hirtë në mesnatë. Stuhia u largua duke rrëzuar kujtimet e saj dhe dëshirën për ta zotëruar trupin e njeriut që mendonte se i përkiste. Sytë e gjelbër si të një lakmuesi kishin hyrë në botën e tij krejt pa dëshirë. Më në fund një fije shprese e kishte lidhur me atë njeri, të cilin e njihte, ashtu si shumë të tjerë. Ajo mendoi se njojja me të ishte një magji për të ndryshuar jetën.

- Tani Angjelina D. po bën seks me një turmë burrash, - mendoi vdekaturi duke prekur me dorë penisin e tij të butë.

- Le të ngjinjet njëherë e mirë lavirja. Më në fund është një grua e përdalë.

Gruaja tjetër i lutej të bënte dashuri, ndërsa ai mendonte sërisht për sytë e Angjelina. Pas mesnate ndjeu se i mungonte oksigjeni. Shenjat e lodhjes e kishin përpirë të harrohej pas një gjumi të trazuar. Fryma e Angjelinës D. i dukej e paarritshme. Kishte mbetur vetëm një ëndërr, qysh atëhere kur jetonte brenda botës së re.

Angjelina nxori nga gjoksi fotografinë e Ertenit. Ai dukej sikur ende e pyeste veten dhe lutej para saj të mos besonte se ai nuk ishte më në atë botë.

Një diell i vrarë u zvarrit deri në cepin rrëzë dritares. Atje shiheshin trupa që zhgërrysheshin pas njëri-tjetrit duke kërkuar jetën. Ajo i kishte dëgjuar më parë sytë e tyre të

luteshin për vdekjen. Ishte e dëshpëruar, teksha shihte atë turmë homoseksualesh, të cilët shkonin ngjitur dy e nga dy, për të lidhur kontaktet me botën. Koha po i shembej sipër vetes nën klithmat mbi dyshemenë prej dheu, përzier me një heshtje varri. Aty po jetonte ndryshimin më të çmendur të jetës. Vdekatari po përpinqej ta varroste, ashtu si shumë jetë të tjera.

- As mos të të shkojë në mend se ne kemi kryer ndonjë krim, - i tha Antoni, kur ajo u zhyt nën terrin e mbytur nga trupat e ngjitur pas murit.

Ishin kthyer në qenie të uritura për jetë. Po ecnin drejt udhës së vdekjes. Angjelinës i erdhi keq, kur mendoi se ata ishin mbyllur në një varr të madh. Dy e nga dy besonin se ishin të vdekurit e gjallë të asaj bote në lindje. Në mëngjes, ndërsa rikujtonte skenat e natës së shkuar kuptoi se rrënim i tyre shfaqeje mbi ato kocka të lyera me ngjyrën e baltës, ku vdekja kishte harruar hijen e saj. Sipas vdekatarit varrimi i tyre do të bëhej në një varr të përbashkët, sepse ata ishin ngjitur njëri pas tjetrit. Djalli mërmëriste me gjuhën e tij se burrat ishin të përdalë, bënин punë turpi, kishin palluar njëri-tjetrin dhe nuk ishin të aftë për të palluar një grua lavire. Më në fund ata po shkonin në atë botë të nginjur nga trupat e lerosur me baltë. Njëherë, vetëm njëherë, nuk kishin pranuar ta preknin atë grua.

- Ata çfarë nuk do të pranonin të bënин, - tha njeriu pa fytyrë. Disa flisnin të qetë edhe

kur kujtonin holokaustin, mbërritjen e vdekjes, varrin e përbashkët. Ikën, ikën nga kjo botë, sepse ajo iu duk e hidhur, e vrazhdë, e turpshme. Amin. . .

- Ishte një fatkeqësi e tmerrshme ajo çka i ngjau atyre burrave, - i tha njeriut të natës, pa ia parë fytyrën Angjelinës. Prandaj e lashë të zhveshur gjoksin tim që ata të besonin tek jeta. Por ju i vratë ata, i shndërruat në humbës të jetës. Ata e mbrojtën dashurinë time.

Nga fotografia dëgjoi zérin e Ertenit i ndarë më dysh mes jetës dhe vdekjes. Ai i lutej të mos kishte frikë. Kur sytë e tij afroheshin pranë syve të saj, Angjelina rijetonte kohën e prerë në mes. Sa herë kishte menduar të ikte në atë botë, zéri i Ertenit e largonte nga ai mendim i keq. Nuk i kishte pëlqyer kurrë mëshira. Ndaj tek shihte portretin e tij ndiehej e lirë.

Sipas vdekatarit Erten S. e kishte kapërcyer vetë pragun e botës tjetër. Madje pati marrë me vete mërinë e ikjes. Lotët iu derdhën nën përthyerjen e vështrimit të pafajshëm. Sytë e tij të thellë po përpinqeshin të hynin në sytë e saj.

Natën Angjelina pa vetëm një fytyrë. Shtynte shtresën e errët të kohës me gjoks. Merrte fuqi nga qelli i kthjellët, i cili kishte gjetur një të çarë, për të prekur zemrën e hënës. Sërisht pa Ertenin që ishte përkulur mbi trupin e saj. Ai i lutej të mos vdiste. I jepte frymën e tij, teksa ajo zhytej në një gjumë të lodhur, ku mbërrinte hija e vdekjes. Ishë rrëthuar nga ajo turmë burrash, të cilët për ta mbrojtur nga ikja në atë botë, i flisnin për jetën e çliruar nga vdekja.

Vonë pas mesnate ata i rrëmbyen së bashku. Angjelina nuk e kuptoi, pse ndodhët gjithmonë ta çonin drejt një marrëzie tjetër.

- Nuk është faji im, - tha njeriu pa fytyrë. - Më duhet të tē bind se Erten S. ka ikur nga kjo botë. Mos u bëj kokëfortë. Nuk mund të luftosh e vetme kundër botës. U kishin lidhur sytë me terrin e natës. Po shkonin në vdekje.

- Ti duhet të jetosh për botën e re, engjëlli ynë. - Më në fund duhet të dalësh nga kjo botë e përdalë, në të cilën ne jemi vetëm kufoma, - i tha Anton L.

Angjelina ndjeu trupin e shtrënguar pas tokës të njeriut që i rrinte pranë në atë gërmadhë të hirtë. U çudit pse nuk donte të shkëputëj prej saj. Dëgjoi zérin e tij të lëshonte ca rrokëzime të ngadalta që i kujtuan sejeta ishte lidhur edhe me zërat e të tjerëve. Nga zbraztësia në ekstazë kishte

mabetur pas ajo katastrofë. Jeta e tyre ishte vrarë. Ata nuk do të zgjoheshin më kurrë. Trupat e tyre e rrethuan, për ta mbrojtur nga vdekja, sepse ajo i besonte një bote tjetër. Njeriu me trup të fuqishëm u zhgërrye sërisht mbi tokën që fshihte vdekjen e tyre. Ajo u ndie e habitur. Përse ai nuk ishte rreshtuar me trupat e të tjerve, të cilët ishin flakur në një varr të përbashkët?

- Vetëm dheu më ka mabetur, - i tha sërisht ai, kur Angjelina iu lut të ngrihej nga balta e kuqe duke e shkundur për supesh. Ishin të gjallë, kur dolën nga varri.

Ajo po shihte veten në një cep krejt të panjohur të anës së prapme të udhës, e cila kishte vetëm hyrjen. Në anën tjetër dukeshin ca hije kufomash.

- O zot, mos jam në Mathauzen, - mendoi krejt e hutuar. U tremb nga qetësia prej varri.

Atë natë vdekatarit kishte folur përcart. Dikush e njoftoi se Angjelina D. ishte zhdukur më në fund nga ajo botë. Kishte vdekur, ishte vetëvrasë, apo ishte mbytur, atij nuk i interesonte më asgjë. Ishte miaft që ajo nuk i shfaqej më e gjallë. Por, përsëri nuk mundi t'i harrojë sytë e saj të gjelbër.

Ktheu fytyrën për të parë sytë e gruas, që kishte në krahun e djathi. Gjithë kohën dëgjonte psherëtimat e saj, të cilat e shponin si një thikë. E shtrëngoi pas vetes. U çudit. Ishte hera e parë që mendoi për atë grua. E shtrëngoi pas trupit të tij të bëshëm. Dy sy të gjelbër ishin varrosur. Shpëtova, nga Angjelina D., - foli me zë të lartë vdekatarit, ndërsa kërkonte mes shalëve të gruas që kishte ngjitur pas vetes fundin e errët, ku shpërtihente drita.

Lajmi i zhdukjes së Angjelina u përhap vetëm pas një viti. Gjithçka u mbajt sekret. Dikush kishte thënë se trupi i saj ishte djegur në krematorium, pasi ishte dënuar me vdekje. Kur kishin pyetur njeriun pa fytyrë, ai tha se zëdhënësi i tij do të shkruante një artikull në gazetën

“Zgjimi”, për arratisjen e Angjelinës. Ai kishte parë trupin e saj të ngrirë në dëborë duke u përleshur me ujqërit. E vëtmja gjë që dihej, ishte se ajo ishte larguar me një homoseksual.

Ndërsa po dëgjonte himnin kombëtar, gruaja e vdekatarit ishte treguar gjoja e qetë, për zhdukjen e një shpirti. Kishte pasur guximin të përtypte njoftimet për ikjen e saj, sikur të mos e njihte kurrë. Tashmë i shoqi dukej më i lumtur. Askush nuk mund ta ndante prej tij. Zgjohej me kënaqësi në krahët e burrit, i cili nuk ishte më në ankth për dy sy të tjerë.

Gruaja e pa veten të rrëthuar nga një turmë, e cila po e pengonte të ecte në selinë e Ministrisë së Kulturës. Truprojat u përpoqën që njerëzit të mos i bënин pyetje të tjera për zhdukjen e Angjelina D. Lajmi i çuditshëm u end e u stërhollua deri në arratisjen e saj në një vend të panjohur. Ishte pëershfaqur ideja se ajo edhe mund të ishte murosur në ndonjë vend enigmatik, një rit i njohur nga historia e qyteteve të lashta. Por muret ngriheshin të hirta pa asnjë shenjë prishjeje. Fakti që ajo po çorientonte qytetin e shtyu gruan t'i thoshte turmës, se do të zbulonin një ditë enigmën e jetës, apo të vdekjes së Angjelina D.

Ciceroni i kështjellës, teksha ngacmonte muret e hirtë me duar, kishte thënë se nuk kishte shenja të murosjes. Një thikë me majë të mprehtë ishte zbuluar një ndajnatë përpëra se qyteti të priste ditën.

Askush nuk arriti të siguronte ndonjë dokument të shkruar se çfarë kishte ndodhur me Angjelinën. Motivin më të heshtur e zbuloi një mik i nënës së saj, i cili gjatë atij dimri të ftohtë shkroi një libër për zhdukjen e mistershme të Erten S. dhe të Angjelina D. Sipas tij ajo ishte parë të kërkonte në botën e re imazhin e gjallë të një zemre të humbur. Varianti tjetër ishte se Angjelina qe tërhequr në punët e Zotit. Dyshohej se ishte kthyer në murgeschë. Më

vonë e kishte lëshuar shpirtin e saj në përulësinë para jetës. Ndoshta ajo kishte flijuar veten, sepse përfytyronte një botë tjetër me dashuri.

Më në fund qytetit të ngazëllyer, që po njihej me një histori të shkruar i lindi shpresa për një botë më të mirë. Njerëzimi kërkonte ngjarje reale, që t'i besonte të vërtetës. Ajo nuk lidhej me aventura dhe hijet në sheshin e lirisë, por me një shpirt të gjallë. Secili kërkonte fytyrën e mbuluar të shtetit të ndarë mes jetës dhe vdekjes.

Kishte kohë që brendësia e tij ishte përfshirë nga heshtja e rrëmujshme. Njerëzit hiqeshin sikur ishin të lirë, por qenë të pushtuar nga ankthi. Trupi i atdheut po mbytej nga kriza. Shteti po kthehej në një hije të fshehur, ku shfaqejet vetëm një fytyrë me sy të gjelbër.

Shumë vite më vonë një gazetar rebel që intervistonte figurat e heronjve, ishte vënë në ndjekje të zhdukjes së Angjelinës. Kishte rrëmuar të gjitha arkivat e fshehta, kishte kaluar përtjer brigjeve të botës së re. Më në fund krejt qartazi e kuptoi se bëhej fjalë për një model njerëzor të shfrytuar nga humbja e një dashurie.

Në zemrën e saj nuk kishte qetësi, sepse bota e hijeve ishte para syve të shtetit që kërkonte murosjen e lirisë. Njerëzit kishin lënë pas vetëm hijen e tyre. Zhdukeshin brenda gjysmë jetës, as të gjallë dhe as të vdekur.

**D**informatën më të çmendur e dhanë ca ndjekës të historisë së vdekatarit. Ata kishin parë Angjelinën dhe Ertenin në një kthinë prej balte, duke bërë dashuri. Eshtë e vështirë të gjendesh në dy botë, belbëzonte një fëmijë, pasi kishte larguar dheun nga trupi.

Qendra e qytetit ku nuk dëgjohej asgjë, kishte mbetur e shkretë. Nata ishte varur nën krisjet e thata të shiut. Njerëzit u larguan me vrapi nga sheshi i lirisë, pasi kishin dëgjuar broçkullat e modelit më të zhvilluar të sistemit socialist, se bota e re po lindte mbi gërmadhat e botës së vjetër, dhe se e ardhmja do të ishte më e bukur.

Angjelina vinte rrrotull në hyrjen e ngushtë të dhomës prej balte. Në lashtësi atje kishin jetuar bishat e egra. Përballë i shfaqeshin gurët e bardhë të malit të zhveshur, i cili dukej se puthej me faqen e diellit. Nuk dinte sa kohë kishte humbur duke pritur të shfaqej realisht, se kush ishte, por ndërsa bëhej gati të shpërfillte gjithçka, shpifej një histori tjetër që e detyronte të mos jepte as shenjën më të vogël të së vërtetës. Sa herë ishte ngatëruar me veten. Ndoshta ishte më mirë të quhej e humbur, sesa të rronte mes asaj bote që i mohonte jetën.

Ende brenda sistemit të kujtesës i lëkundej ideja e zhdukjes së Ertenit. I ngjante se historia po përsëritezë e njëjtë edhe për zhdukjen e saj, përmes një vdekjeje të gjallë. Ndoshta të gjithë e dinin të vdekur, por ajo në të vërtetë jetonte në një cep të mbrapshtë të botës, pra fatmirësisht

jetonte. E shihte lindjen e diellit dhe dëlirësinë e fytyrës në pasqyrën e një jete të mohuar. Disa herë e ndiente veten nën torturë, pasi i mungonte e drejta, për t'u shfaqur para forcës së vdekatarit. Në mëngjes, merrete në duar violinën dhe interpretonte sonatën e Bethovenit "Apasionata". Ata tinguj e mbanin gjallë. I dukej sikurjeta i shtohej, teksha gishtat e hollë preknin shikimin e Ertenit. Nuk dëshiroi të mendonte për ditët e vrara, se ideologët do të shpiknin gjetje të reja për sistemin që ecte në fije të perit. E keqja ishte brenda asaj udhe, e cila po shkonte drejt fundit.

Ajo gdhihej në një botë që e pranonte, ashtu siç ishte me djajtë dhe engjëjt. Ndjente se ata i afroheshin dhe i largoheshin, por asnijëherë nuk e frikësonin.

Një ditë të ndryshkur nga pritja, kur kishte hyrë brenda një njeriu, solli në jetë një engjëll. Ashtu e arratisur prej botës, kishte lindur një shpirt. Në ditën e pestë të muajit të trëndafilave nuk e ndieu kohën e zhdukur, por brenda botës së madhe, zbërtheu diellin e zemrës, për t'i afruar cicën e bardhë të birit. Trupi i ishte mbushur me gjakun e munguar. Ende besoi në lirinë e vërtetë.

Antoni e quajti të birin, Luka. Ishte i lumtur që kishte më në fund një pasardhës. Asnjëherë nuk e kishte quajtur veten një njeri të vdekur, ashtu siç e ngacmonin qysh nga koha, kur gjykimet për homoseksualitetin e tij ishin një dilemë për të ardhmen. Angjelina i kishte dhuruar trupin me dëshirën për jetën. Disa herë ishin përpjekur që ata t'i përkissnin njëri-tjetrit. Dhe kishte ndodhur të lindej një fytyrë, e cila do t'u ndriçonte jetën. Antonit i kujtohej se ishte e shtunë mbrëma, kur Angjelina ndjeu t'i lëvizte në bark një dorë fëmije. E puthi si asnijëherë tjetër trupin e saj, gjoksin, barkun dhe zemrën.

Iu kujtua ajo ditë kur vdekatar kishte urdhëruar që të gjithë ata burra ta poshteronin Angjelinën. Ishte çmenduri të bënин diçka të tillë.

Ajo kishte dëgjuar gulçimat e tyre të egra, të cilat shtyheshin nëpër urejtjen e secilit. Duke i mallkuar, mbyllte veshët për të mos dëgjuar thirrjet e akullta.

- Ishte krejt e mbropshtë ajo që po ndodhë. Por ne ishim dënuar të kridheshim në një botë të tillë, ishim të dënuar të jetonim nën ligësinë e tyre, sepse ata vetë ishin qenie të tilla. Ata e përdorën vdekjen tonë si një armë për t'u ngritur mbi të tjerët, përdorën trupat tanë, për të përdhosur apo shfytyruar botën e dashurisë. Shpirti i tij ishte veshur nga urejtja. Mallkim, mallkim vdekatarëve të ndëshkimit. . .

Luka u solli një ndryshim të thellë shpirtëror që Angjelina nuk gjente fjalë, për ta krahasuar. U bë më e gjallë. Ishte më e lehtë për të dy ta përballonin mungesën e lirisë. E flakën diku në errësirë të shkuarën e përbashkët para syve të asaj fëmije që u lutej t'i besonin së ardhmes. Zemra u thoshte se ai engjëll, po vinte në botë me një zë tjetër. Luka nuk pranonte të luante me humbjen. Ata shpresonin se ai do të ndalte fatkeqësitë e tyre. Bashkë nuk vuajtën më nga marrëzia e përndjekjes. U betuan para Lukës, se do të kërkonin të ardhmen. Sytë e fëmijës kishin refleksin e gjelbërt të syve të saj, ku mund të shihje qiellin dhe tokën. Duke i kënduar gjumit të embël, Angjelina kishte hapur një portë tjetër, ku lëviznin kujtimet e hershme, të cilat i shtrëngonte si duart e Lukës.

Ulur nën vijën e ndriçuar të diellit, një vegim i afrohej dhe i largohej. Po ikte nga bota gri e së shkuarës duke jetuar me imazhin e Erten S. Tashmë nuk ishte e ndarë nga vetja. Sytë e tij i shfaqeshin në secilën ditë, duke hyrë nga e njëjta zemër. Ajo kishte lidhje me jetën e dyfishtë në pritje.

- Çfarë po ndodh me kohën e humbur të jetës së Ertenit? - e pyeti atë natë, për të parën herë Antoni. Si mund ta pranosh humbjen e tij? Duhet të mos i besosh njerëzve anonimë. Ata janë nën pushtetin e vdekatarit, janë çnjerëzuar deri në fryshtë e tyre.

Angjelina kishte heshtur. Sërish teksa dëgjonte rrahjen e zemrës, mendoi se Erteni një ditë do të kërkonte sytë e saj, që ishin shndërruar në një qiell të shpirtit për të mbijetuar.

Natën, kur shkrepëtimat i rrëzoheshin në trup si një copë zjarri, kishte harruar fytyrën e prijësit. Ajo i shfaqej sa herë përfytyronte trishtimin e Ertenit. Dikur e kishte pyetur, për të njëqindën herë, përsë nuk besonte në vdekjen e tij? Pastaj e afroi pranë vetes për të provuar shijen e saj. Angjelina e kishte shtyrë poshtë, mbi një grumbull lettrash të grisura. Ishte larguar, për të mos e parë më fytyrën e tij. Besonte se për atë djalli kishte vdekur realisht. Ai ulërinte mes natës së errët, gjysmë lakuriq.

Ishte fundi i dhjetorit, kur ajo mori një zarf të verdhë, lidhur me fijet e ankthit. Trupi iu drodh. Gishtat iu mpinë, sikur të kishte para syve një vdekje tjetër. Vështroi fytyrën e Lukës. Ai po rritej. Madje as i shkonte ndërmend të pyeste për sytë e Erten S. Kureshtja e ngacmoi dhe pyeti veten, përsë nuk po e lexonte atë letër? E hapi sikur prekte trupin e tij. Ndoshta ishte gjallë.

- E shkuara, ka vdekur, - lexoi dy rreshta të shembur që ishin të ngjashme me një greminë. Letra i ra nga dora, kur Luka u zgjua.

U ul menjëherë pranë të birit dhe fshiu lotët. Letrën ia shkruante një grua. Po, po ishte një dorë gruaje. Ajo pa as më të voglën dobësi i shkruante se Erten S. kishte shkuar njëherë e mirë në botën tjetër, sepse kishte pasur dëshirë të bëhej pjesëtar i saj.

Angjelina u ngrit nga toka, ku ulej gjithmonë. Vrapoi në rrugë. Nuk kishte kuptim të besonte, se gruaja, e cila shkruante ato rreshta të zinj, të kishte kryer vrasjen e tij. Do të kishte qenë më mirë të mos e kishte lexuar letrën e zhubravitur, sepse për ditë e më tepër, po i afrohej së vërtetës. Zhdukja e Ertenit ishte e njëjtë me historinë e

zhdukjes së saj. Edhe atë të gjithë e dinin të vdekur. Zërat që frymonin qytetin kishin pyetur rrëth zhdukjes së Angjelinës. Askush nuk kishte arritur të mësonte, të paktën, ku ishte zhdukur ajo, në cilin kontinent ndodhej, apo mos ndoshta kërkonte Ertenin.

E vërteta ecte nëpër udhët e qytetit, shumëfishohej me enigma të denja, për një film të frikshëm, kurse fajtori ishte krejt i pafajshëm.

Sipas Lukës, e drejta ishte shndërruar në një shembull të keq brenda mendjes së njerëzve. Ata i ishin drejtuar të pavërtetës si një mjet i zakonshëm, për të zhdukur të drejtën reale, që s'dihej pse ishte e pakuptueshme.

Angjelina ulur në majën e një shkëmbi kujtonte me trishtim historinë e saj. Prindërit i kishte takuar për herë të fundit, pas ikjes së Ertenit. Ngjyra e gjelbërt e majit ishte përzier me vuajtjet e shkuara. E éma e ngushëllonte se një ditë, do të shpalje dita e festës së shpirtit, pas asaj dite të mallkuar. Ajo e kishte shtrënguar në gjoks. I ishte lutur të shkonte në Austri, për të vazhduar studimet. I ati ulte grilat e rrënuara nga koha dhe ndiehej i huaj në botën e tij. Koha ecte mbrapsht në kujtesën e pasardhësve. Shteti po kristë përbrenda, sikur të ishte nën krizën e gangrenës. Për fat të mirë historinë e krijonin popujt. Njerëzimi nuk ishte një hije.

Angjelina kishte marrë me vete atë ditë maji kundërmimin e luleve të kumbullës nga oborri. Tingujt e botës së re dëgjoheshin deri në fund të qytetit.

Mbi kokë i varej një qiell i zymtë me re të menduara, të shpërndara si fjalët pa forcë. Shiu davaritej nga perëndimi. Mori në krah çantën me gjithë violinën, si të vetmen gjë, mbetur ngajeta si pjesë e qenies.

- Do të kthehem, - iu tha prindërve. - Mos mendoni se do të iki pa ëndrra.

Nuk e mori vesh se si i dolën ato fjalë nga valët e zemrës. Larg në rërën e lagur kishte mbetur imazhi i ikjes.

Në dalje të qytetit dikush kishte shkruar mbi një mur të bardhë një shprehje të çuditshme, që varej deri në afërsi të tokës: Kjo erë është e vdekshme!

Njerëzit shihnin të pushtuar nga ankthi murin e fjalëve. E krahasonin erën me një vrasëse. Pazari i vjetër dukej si një bark i zbrazët ku shtriheshin vjetërsirat, ca vazo prej bakri të errët rrethuar me lule të heshtura, ndonjë veshje popullore gati me ngjyrën e ujrave. Një muzikë e vjetër përhapej në atë qetësi të lodhur, duke rikthyer edhe njëherë fytyrën e maskuar të ditës tjetër.

Mali i Dajtit ishte ndarë në përmasa rreshtash të verdhë e të bardhë, lyer nga bora dimërore. Diku formonte një kurorë të veshur nga ndriçimi i hënës. Qielli i mbuluar dukej sikur ishte i përgjumur dhe lëshonte një zë të mekur.

Nxori nga libri “Ankthi i epërt” fishekun e vjetër, një rit tabu nga paraardhësit, i cili u jepej grave në pajë për të ruajtur nderin. Në fundin e tij lexoi dy shkronja të ngrira A. E. Dukej se ai i lutej, të mos e harronte kurrë. Ajo kërkoi dritën e një ylli për të gjetur krijimin e atij kodit, të shpikur para vdekjes.

Puthte fytyrën e të birit duke e mbajtur brenda vetes, ashtu siç kishte mbajtur në zemër, dashurinë për Ertenin. Krijesa që po rritej nuk dinte të zbulonte humbjen e saj, përveçse të parandjente ikjen e stinës dimërore.

Luka kishte dy sy të gjelbërt, të njëjtë me sytë e së emës. Aty nuk lexohej asnë vdekje, apo vrasje e dritës. Dukej se ai fëmijë i kishte dhënë reflektimin e lindjes së një kohe tjetër, e cila do të shpërbënte njollat e së kaluarës. Gjithçka rrezëtinte brenda syve të Lukës, si një far apo një zemër dielli. Kishte jetuar një mbrëmje dhjetori marramendëse, kur Luka i përshpëriti ca fjalë të shtrenjta që e kishin çuditur. Shpirti Erten S. është gjallë dhe ndodhet brenda një gruaje.

Ai kishte lindur në botën mes tyre si një pemë, e cila ndodhej brenda rrënjeve. Pema lidhej me degët e larta pa u këputur. Nuk do të mund të jetonte i rrethuar nga vdekjet, sikur të mos kërkonte tek e ardhmja jetën.

Në kubenë e ndezur të qiellit ai kishte pranë vetes një kohë të re. Do të çlirohet nga e kaluara, sikur t'i ngjante me një kafshatë buke. Atë e përtypente vetëm njëherë duke harruar shijen dhe ndjenjën. Në sytë e saj dalloi të njëjtën grua-nënë me sy të bukur, brenda një zemre të gjelbërt që jetonte nga dashuria.

Ajo përqafonte të birin. Fytyra engjëllore e tij e shtynte për të jetuar.

Antoni udhëtonte dy orë në këmbë, për të thyer gurët e mëdhenj të shkëmbinjve, të cilët i kujtonin ndryshimin e lashtë me skllavin e harruar nga bota. Mbështetej mbi tokën e ngrohtë, ia dëgjonte fryshtën, ashtu siç ndiente fryshtën e Lukës. Ai kapërcente sipërfaqen e saj, pa e ditur, se kush ishte fajt i tyre. Në mbrëmje, megjithëse ishte krejt i këputur dhe mezi e mbanin këmbët, kishte frikë mos e humbiste Angjelinën. E dashuronte shpirtin e mirë të asaj gruaje, si gjënë më të shtrenjtë, që i kishte falur jeta. I kujtohej se pikërisht, kur ajo fliste me një zemër, ai i pohonte vetes se Angjelina do të jetonte, sepse nuk i besonte humbjes.

Atë mëngjes dhjetori era e ngrohtë i përkëdhelte fytyrën. I tha, se brenda vetes dëgjonte një muzikë të njojur. Ajo i përkushtohej një bote tjetër. Koha po bashkohej me njerëzit, për të prekur indet e saj të këputura që lidheshin me dritën, duke shembur mugëtirën. Nuk e fshehu mendimin se po trokiste një orë tjetër. Bota do të shkonte drejt së mirës dhe ai dimër do të varroste zërin e mallkuar.

Luka ngriti sytë e butë. Një lloj shkëmbimi i vështrimeve dukej sikur lindte çdo orë stinën e gjelbër. Kishte marrë fund dimri i gjatë i urrejtjes. Sytë e egër të vdekatarit ishin

rrëzuar si ca sy plastikë të djegur nga zjarri. Jeta ishte shndërruar në një dashuri të përjetshme. Ajo ishte qendra e botës dhe jo fundi i saj.

- E pra, Julia, babai yt Luka ka lindur atje ku të thashë, - në kthinën e ndarë mes jetës dhe vdekjes. Atje shkëmbinjtë u kthyen në gurë të vegjël, pastaj në kokrriza. Vonë kur dielli pushtonte tokën, largohejjeta nga vdekja. Ne na kishin numëruar tek të vdekurit në dimrin e gjatë. Por një ditë dëgjuam sërish tingujt e "Botës së re", e cila kishte mbijetuar. Ne e kishim pritur këtë kohë, sepse urrejtja ishte shndërruar në dashuri.

I gjithë qyteti ndali frysmin, kur Angjelina D. u përul mbi tokën e të parëve. Ajo puthi e përmalluar dheun e butë, sikur të puthte fytyrën e Julias që e mbante prej dore.

Ishte e pabesueshme ajo skenë. Nuk ia kishin parë fytyrën gati gjysmë shekulli. Njerëzit mezi i kishin mbajtur lotët. Ajo shtrëngohet si një fëmijë pas tokës dhe trëndafilave të bardhë.

- Eshtë e pamundur ardhja e saj në botën e të gjallëve, - tha atë pragmengjesi gruaja e vdekatarit. Ai ende sillej si hije përgjatë trotuareve të shtetit më të vjetër.

Kurrë nuk ishte folur as në zemër të qytetit dhe as në periferi të tij, se Angjelina kishte ikur në atë botë. Lindën ca histori të çuditshme, të cilat njerëzit nuk kishin menduar se ishin të vërteta.

Gruaja e vdekatarit kishte dëgjuar krisma të parashikuara. Pas një minute, ai besoi se Angjelina, ishte kthyer në një lavire që e shpërfillte gjithë qyteti.

- A nuk të thashë se ajo mbante pas vetes një jetë tjetër. Kurrë nuk e pa vdekjen me sy, klithi edhe njëherë gruaja duke u ndeshur me sytë e saj të gjelbërt.

- O, Zot më ndihmo ta gjej atë zemër të humbur, - u lut Angjelina kur ende gjunjët po i nguleshin në dheun e ëmbël.

Vala e forcës për dashurinë i lëvizte në të gjithë qenien. Nxori nga gjoksi i çliruar fotografinë e zverdhur nga ikja të Ertenit. Sytë e rrëthuar nga syzet e hirta i luteshin të besonte se ishte gjallë. Ai po kërkonte sytë e saj. Preku sërish buzëqeshjen e hershme, e cila ishte e njëjtë me kalimin e viteve. Mbeti e çuditur pse Julia e tërhiqte nga duart për ta ndalur para murit të njoftimeve të vdekjeve. Askund nuk i pa sytë e Erten S.

- Atë duhet ta kërkoj tek të gjallët, - i foli ajo Julias. - Ndarja e gjatë nuk ekziston brenda meje. Ai gjithmonë ka qenë i gjallë në shpirtin tim.

Julia shtrëngonte duart e saj. Dikur ngriti kokën të shih te shtatorene e heroit kombëtar. Ai qëndronte mbi trupin e qytetit si të ishte mburoja e tij. Shtatoret e vdekatarit ishin shembur. Kurrë nuk kishte arritur t'i shpëtonte humbjes.

Ishte e para herë që shikonte varreza të vërteta. Angjelina kalonte afër vëtmisë së tyre në botën e përjetshme. Mbështeste duart në mermerin e ftohtë dhe vazhdonte të kërkonte një fytyrë.

Qielli kishte ndezur yjet, kur ajo kishte zbritur në zemër të qytetit. Diku përfytyroi gjurmët e mbetur nga e kaluara e vajzës së vogël, veshur me një fustan të bardhë.

Angjelina njoihu nga larg shtëpinë e vjetër, ku kishte vdekur e kaluara. E ëma nuk e përballoi dot të ardhmen. Për shkak të zhdukjes të së bijës kishte vdekur nga ëndërrimet. Mjekët e kishin sajuar këtë diagnozë të panjohur, pasi ajo nuk kishte pranuar as të jetonte të ardhmen. Në atë botë do të komunikonte me të bijën nëpërmjet ëndrrave.

I gjëmuani në vesh tingujt e gjalla të pianos. Ishte si një genie e gjallë, për të kujtuar ato jetë të shuara. Kapërceu pragun e mermertë të dhomës së heshtur nga pjesa e mbetur e fëmijërisë. Pikturat ishin të gjalla, siç i kishte lënë para se të shpikej vdekja e saj. Ajo ndoshta nuk e kishte ndjerë braktisjen.

Në portretin e gjyshit, të cilit i ngjante nga krenaria, shquheshin dhimbjet e vjetra të kohës dhe të shpirtit. Më në fund ishte pranë të gjithëve. Ata e dinin të vdekur.

Ndezi dritën e dhomës së saj. Për herë të parë e ndieu veten në paqe. Koha ishte veshur me një lëkurë të re. Ndjehej e çlirët pas shembjes së murit të zhgënjimit dhe po depërtonte në thellësinë e dritës. Angjelina kërkoi me sy në çdo cep të shtëpisë së rrënuar nga vitet e humbura të kaluarën. Diku mbante brenda millefin e vëtmisë.

Të atit i kishte ndodhur e keqja më e madhe. Një mëngjes të ftohtë i sekuestruan të gjithë pasurinë duke e lënë të varfër. Pas zhdukjes së vajzës, ai jetonte mes pasigurisë dhe vdekjes. Vëtmia i ngjante një tuneli pa fund. Në ditën e parë të shkurtit ishte varur nën degën e një lisi.

Angjelina lëshoi nga dora Julian, e cila po thyente heshtjen e kujtimeve të mabetura në kohën tjeter. I nguli sytë mbi fytyrën e Angjelinës, si për të kapërcyer ankthin e kohës, ku nuk i përgjigjej askush.

- Harroje të kaluarën - i tha vetes. Julia po flinte e qetë në dhomën e fëmijërisë së saj.

Jetët e të parëve ishin shuar, ashtu siç shuhej drita e zbehtë e natës në ikje. Rrënjet e tyre, kishin mbetur në shpirtin e pasardhësve. Buzëqeshi edhe njëherë, kur pa Julian që flinte e qetë pa shikuar lotët e së kaluarës.

Të nesërmen nisi të kërkonte zambakë dhe lulebore, për t'i mbjellë në vazot e mbushura me dhë. Lulet ishin tharë, por dheu kishte mbetur aty. Iu duk vetja një zonjushë e panjohur. Mendonte vetëm për t'i sjellë dritë zemrës së Angjelinës.

Luka ishte fytyra, ku ajo dalloi vlerën e të qenit njeri, pas shpirtit të vrarë nga mungesa e ngushëllimit. Ai vuante brenda vetes dhimbjen e së ëmës, e cila megjithatë kishte mbijetuar. - Ende është e fortë, - lidhur pas dashurisë, thoshte shpesh me vete.

Luka e kalonte pjesën më të madhe të ditës duke kërkuar punë në qendrën e qytetit.

Disa herë kishte emigruar në Greqi, por ishte kthyer.

- Ndjeħesha keq, - i kishte thënë Angjelinës, natën e errët tē kthimit. - Një jetë thua jse copë-copë. Gjendesha i ndarë, sepse kisha harruar vvetveten.

Ishte tmerruar një tē shtunë në mëngjes, kur afendikoi ulérinte si i çmendur.

- Ne kujtuam se ai do tē na merrte nē punë dhe vrapiam drejt tij. Ishim shumë. Ne vinim nga varfëria. Ndoshta na mungonte edhe gjaku. Por afendikoi vetëm klithte. Më nē fund kishte marrë me vete ca djem tē rinj me shpatulla tē gjera që ngjasonin me lisat e maleve tē vendlindjes. Tē nesërmen njéri prej tyre nuk u pa më nē shesh. Kishte mbetur pa jetë. Dikush tha, se djaloshi ishte gjetur i vrarë mes dy botëve, pasi i kishin vjedhur pikën e fundit tē gjakut. Në çantë mbante vetëm pak bukë thatë dhe vdekjen e tij.

Jeta qe kthyer nē një udhëtim drejt fatit tē mirë. Kérkonim atë që nuk mund ta gjenim, atdheun e vërtetë. Njerëzit shihnin kufirin e lirisë nē tē katër anët e botës dhe po zvogëlonin vveteten nëpër brigje tē reja. Qytetin e kishte mbërthyer kaosi i ikjes. Ai po gërryhej ngadalë siç gërryente breshëri trupin e tokës.

Julia festonte ditëlindjen, kur Luka tha atë ditë se do tē shkonin nē parajsën e botës. Unë e dua gjithë botën, por atje është ajo që quhet toka e premtuar.

Angjelina ishte thinjur brenda vitit, kur i biri kishte vendosur tē ikte nē Amerikë. Ditën e ikjes mbylli tē gjitha dritaret. Ajri i ftohtë i kujtimeve sillej nga bota e afërt rrëth botës së largët. Hynte e dilte si e gjymtuar duke përjetuar braktisjen e madhe, rrëmujën e shtetit dhe euforinë e udhërrëfyesve.

- Këtu mbi tokën e të parëve, më duket vetja i madh, - kishte thënë para ikjes shitësi i qumështit. - Atje në botën e të gjithëve jam një “hiç”.

Angjelina ndaloi hapat në pazarin e vjetër që mbytej nga zhurmat e njerëzve. Ndaloj si gjithmonë para njoftimeve të vdekjeve. Fytyra e Erten S. nuk ndodhej tek të vdekurit. Ende nuk i ishte fashiturjeta. Koha e mbetur lëshonte një zë, të cilin ajo e dëgjonte pas vetes. Erteni nuk jeton më. Midis alibisë dhe reales ekzistonte vetvetja.

- Në këtë botë të gjithë jemi të përkohshëm, - kishtë thënë atë mëngjes Antoni dhe

ishte shembur për tokë.

- Zot, - tha ajo, - mos ik. Ç'ishte kjo e keqe, apo mos vallë, dita më e vdekur e jetës?

Iu duk se gjithçka u shprish nga fillimi, kur ideja e përkohshmërisë i shfaqej njeriut në fund të jetës. Brenda trupit të tij, ndjeu një zë të njojur, i cili vinte nga “Bota e re”.

- Lamtumirë, Angjelina. Lamtumirë. . .

Julia largoi mendimet nga dita e shkuar. Danieli i kishte thënë, se do t'i bënte një surprizë. Megjithëse atë e kishte në zemër, dashuritë e humbura e ndiqnin pas si hije të padukshme. Ndryshimi ishte se. Daniel F. kishte hyrë brenda një shpirti të mirë duke pranuar veten. Ndjenjat e vjetra i luteshin, për t'u larguar prej tyre.

Stilisti komunikonte me zë të ulët rreth modeleve. Reflekset e dritave ishin përzier në thellësi të skenës veshur nga nuanca rozë. Fotografët e njohur shkrepnин blicat, mbi fytyrat e modeleve. Në veshjet e dimrit mbretëronte linja bardhë e zi. Spikasnin më shumë minifundet me kuadrate. Julia largoi cepat e bluzës së bardhë, e cila kishte një motiv të qëndisur me lulebore.

Gjithnjë para sfilatave ndiehej e pushtuar nga pështjellimi. I dukej se e prekte ideja që i depërtonte brenda vetes, sikur të ndodhej në një festë. Bota e së bukurës i ishte shndërruar në hapësirë dashurie. Ajo megjithatë ishte pjesë e reklamës dhe modës së zhurmshme.

Sa herë i afroheshin ethet e sfilatave, nuk dinte për çfarë arsyе përshkohej nga shenja e zotërimit mbi fytyrat që preknin me shikim lëkurën e saj.

- Eshtë një lojë, - i thoshte Angjelina, para se ajo të zgjohej me ditën. - Të luash veten për kënaqësinë e të tjerëve. Ja, kjo është bota e modeleve!

Valët e zemrës i përplaseshin me gjurmët e dritës. Gjithçka ishte sa në regëtimë, aq në një dehje të lehtë joshëse. E dinte që zemra ishte një tërësi e akteve të tjera rreth trupit. Bota e saj qe e kthjellët, pjesë e dritës, bashkim i jetëve dhe vdekjeve. Ajo sillej rrrotull nëpër kujtesën, tek përfytyrimet e ndarjes nga një jetë. Dritaret e kubesë nën një qiell të mugët nuk arrinin t'i ndalnin njollat e reve që mbështeteshin në krahët e tij.

- Dua të shkëlqesh sonte, - i tha afër veshit stilisti. Julia buzëqeshi lehtë.

Në atë çast u dëgjua ritmi përkëdhelës i zërit të Selin Dion. Ai ngjasonte me paqen e kristaleve. Frymëmarrja mezi po i bindej, kur në skenë u shfaq Arli, i cili ekzistonte vetëm pse ishte aty, para syve të saj. Përballë në anën e djathtë, ai qëndronte sikur të ishte i panjohur duke kërkuar hijen e mbetur të Julias rreth ajrit të ftohtë dimëror. Ajo pati ndjesinë se e kishte jashtë vetes imazhin e tij. Dikur edhe e përshëndeti, pra nuk e urrente. Gjithmonë i kishte pëlqyer të mbizotëronte dashuria, jo urrejtja.

Një dritësim tundues endej në ato sy të largët dhe shpërthente mbi buzët e Daniel F. Ai vetëm filmonte portretet e modeleve.

Julia besoi se brenda vetes, kishte shpirtin e Danielit. Udhë e shenjtë natyrore e dashurisë i dukej si një fotografi magnetike. Ajo pasqyrohej në ekstazën e trëndafilëve që i dhuroi Danieli.

Ishte e vërtetë që fuqia e vështrimeve shpérndahej në të gjithë sytë e shumëfishuar nga hyjnia e jetës. Vetë njeriu dinte të fliste me gjuhën e shpirtit.

- Duhet të interpretosh me sy, - i tërhoqi vëmendjen edhe njëherë stilisti, kur ajo kërkonte sytë e Daniel F.

Julia lëshoi një oh të brendshme, a thua se kërkonte të çlirohet nga vizionet e syve të adhuruesve në botën e modës.

- Kurajo, kij kurajo, - i foli edhe njëherë vetes dhe u shfaq mbi tapetin vishnje. Një shpërthim duartrokitjesh e shoqëroi deri në fund. Copa e hollë transparente, nuk kishte fshehur asgjë, madje Arli mendoi se i kishte shfaqur dhe zemrën.

- Po, po ishte një zemër e hapur, - tha Danieli.

- Ishe një mrekulli Julia. Të gjithë mendonin kështu. E meritoje çmimin e fotomodeles së vitit. Le të ngremë një dolli për suksesin, që të dhanë sytë e të tjerëve. Urime Julia!...

Ende ishte mesnatë, kur mbaroi festa tek bar “Mumja”. Telefonatat nuk rreshtën deri në mëngjes. Atë ditë i dukej se një lloj tjetër lumturie i kishte hyrë pranë zemrës dhe brenda gjithçkaje që e rrëthonte. Mezi iu shmang bliceve të fotografëve. Ngatërrrohej me idenë, se imazhi i saj kishte tërhequr vëmendjen e të gjithëve. Mori frymë thellë, kur gazetarja e një të përditshmeje e pyeti për raportin mes jetës dhe vdekjes.

- Jeta është ndjenjë, të cilën e shijojnë të gjallët, kurse vdekja një skenë kujtimesh, - ishte përgjigjur ajo. Sërisht u ndje në një gjendje mallëngjyese.

Sapo hyri në shtëpi, nxori nga sirtari i një tavoline të vjetër diskun e Angjelinës, për të dëgjuar simfoninë “Bota e re”. Kërkoi ta harronte atë natë që e kishte shndërruar në një vetvete tjetër, por me shpirt të njëjtë. E bukura ishte vetëm një imazh i kërkuar.

Të nesërmen u ndie larg mendimeve të mira, kur lexoi njoftimet e vdekjeve. Iu duk, se gjymtyrët dhe ç'kishte brenda trupit u kthyen në mbetje gjaku e kockash. Para syve të lagësht ishin sytë e pafajshëm të një burri. Dikush tha, se atë njeri e kishte vrarë hija e së shkuarës, të cilës i kishte borxh një vdekje. Mezi mblodhi fuqitë, për të përballuar lajmin e ikjes në atë botë të viktimës. E kaluara ishte afër dhe larg.

Në qytetin verior, të vrarë ngaurrejtja, njerëzit lypnin jetën e të pafajshmëve. Ata jetonin në shekullin e pasvdekjeve të shkuara. Në mes tyre ishte pragu i gjakut. Sipas së vërtetës nuk ishte aspak një eksperiment i ri, por një vazhdim dhimbjeje që na e kishin lënë peng paraardhësit. Ajo qe një gjurmë e mbetur nga ikja e kohës, sendërtuar në një lëndë të tejdukshme me ngjyrën e gjakut. Aty shkruheshin gravurat që fiksonin ndeshjet e kohës. Vdekja ishte bërë e domosdoshme në grafikën e tmerrit dhe paracaktimin e jetës.

Julia nuk kishte parë qiel më të afërt, se sa ai qiel, ku vargmalet jetonin me legjendat e kreshnikëve, afër frymës e historive të të parëve. I dukej se bluja e tij ishte zgjatur deri në dhimbjen e thërrimit të rrezeve, për njeriun që do të varrosej me perden e gjakut. Ajo krisje, çau ditënët, me ngjyrën e mortjes.

Orët ngjanin sikur po shkëputeshin nga klithja e gruas flokëverdhë. Ajo lëshoi kujen e fundit të harruar, që ishte ngjallur duke thyer qelqin e kohës. Ndoshta ishte klithja për jetën. Edhe në atë botë njerëzit po shkonin të lidhur nga gjaku. Shtatë fëmijë lotonin të zhgënijer nën krismën e erës. Të vdekurit nuk dinin, pse po hakmerreshin kundër të gjallëve.

Kishte afër nëntë vjet e nëntë ditë që njerëzit nga emblema e tmerrit, po rrëmonin imazhin vdekësor të paraardhësve. Pothuajse qenë kthyer në ca hetues të këqinj. Ata përdornin më shumë fjalët e një libri, për të zbuluar vdekjen e tij dhe vdekjen e të tjera si kusht të zbërthimit të nyjeve jetësore. Pas kombinimit të vdekjeve njerëzit ndjeheshin të qetë nga formula e marrjes së gjakut, aq sa përfytyrimi i të ikurve ishte në përjetësi.

Julia hodhi sytë në shaminë e zezë të gruas që lutej në luginën e shkurreve. Burrat gjuanin me grusht tokën për të zotëruar hidhërimin. Askush brenda atyre fytyrave të

zbehta nuk mund ta gjente kodin e sakrificës të historisë së urrejtjes.

Sytë e të vdekurit, teksa shikonin në zbrazëti fundin e agut, luteshin para asaj bote në marramendje që njerëzit të arrinin tek drita.

Në mbrëmje Julia u kthye e ngarkuar me botën e vrarë brenda vetes. Ende dëgjonte klithmën e gruas që shkulte flokët e verdhë nën dritën e zezë. Mezi diskutoi me kryeredaktorin për hartën e vargmaleve, ku ishte shpikur vdekja e dyfishtë.

- Nuk di si e dallova ndarjen e qiellit blu nga reflektimi i malit të bardhë, - i tha Endri Z. - Ndoshta e kuptova nga shenjat e viktimës. Ai gjendej nën ankthin e errësirës së përtejme. Nuk shihja as qielin, as tokën.

- Njerëzit që nesër do të lexojnë kronikën, mund ta marrin për një marrëzi lëvizjen e vargmaleve, - ia ktheu Julia. - Madje do të mendojnë për një rrëshqitje të ligjvënësve të shtetit. Më duket se ata vetë janë në udhëkryq.

- Të them të drejtën, njerëzit ndjehen të tmerruar kur lexojnë të tilla kronika, - vazhdoi sërisht Endri. - Një lexues më telefonoi se në gazeta lexonte lajmet më të tmerrshme. A thua se vinin nga ferri!

- Për fat të keq, gazetarët nuk mund t'i zgjidhin problemet e globit, - ia ktheu Julia dhe ndjeu marramendje.

- Kuptimi i shtetit të turbullt vjen nga zërat e atyre vargmaleve që gjithsesi përbëjnë gurët e dritësimit.

Qielli ishte më blu se kurrë, ndërsa nga larg u rrëzua një shkreptimë e vonuar. Nuk besoi se personazhet tragjikë ishin të njëjtë me gurët që vështronin tragjedinë në një skenë letre.

- Ti je një personazh tragjik, - i kishte thënë një natë Arli. - Tragjike do të më shfaqet edhe fantazma jote. Nuk di pse të pëlqen të hulumtosh vetëm vdekjen?

Julia nuk ishte përgjigjur. Kishte dëgjuar se njeriu duhet të ikte nga bota e të gjallëve bashkë me dinjitetin e tij, domethënë të linte pas një dritë për të tjerët. Ai duhet të ishte i tejdukshëm, për të zbuluar të mirën nga funksioni i jetës. Asgjë nuk dukej e idealizuar, madje as ikja dhe pamja e zbulimit të tragjikes si diçka shkatërruese.

Natën kishte bërë një gjumë të trazuar deri në mëngjes, kur Danieli i telefonoi se e kishte marrë malli. Julia përjetoi të njëjtën frazë, kur uli receptorin. Kishin shpëtuar nga ndëshkimi i dashurive dhe ishte krejtësisht e vërtetë. Më në fund, jetonin për njëri tjetrin.

- Pikërisht, më duhej të merrja gjakun e një gjaku, - kishte thënë vrasësi. Tashmë jemi brenda vdekjeve. Askush nuk ishte marrë me vrasësin. E kaluara kishte formë të ngjashme me të nesërmen. Njerëzit hakmerreshin për gjakun. Këmbanat dhe lutjet e Shën Mërisë ishin dëgjuar deri në vargmale, kur nata vajtonte një ditë të vdekur.

Në periferi të qytetit verior ngjyra e ngushëllimit ishte e trishtuar. Vrasësi ndjehej i qetë.

Myllur brenda katër mureve apo territ të ngujimit,jeta qe zbruzur nga e ardhmja. Lamtumirat zbeheshin prej dhimbjeve. Energjia e së shkuarës qe shfaqur në vdekje të përbashkëta. Pastaj, pastaj e shkuara kishte vrarë fëmijët, kishte shuar pemën e fisit dhe të rinjtë që puteshin me të dashurat e tyre.

Qielli me njolla të hirta fshihte yjet, sepse vrasësit po kërkonin ende vdekjen. Era përsihej me zërin e përhumbur që shqiptonte një nina-nana të ikur.

- Mallkim, hakmarrjes, - tha Julia para trupit të pajetë të burrit. - A nuk u mjafton dashuria? Vriteni urrejtjen njerëz!

I ngjau se po luante rolin e gazetarit, apo të njeriut të letrave. Nuk e kupto si një ditë, pasi kishte parë fytyrën e njeriut të vrarë nga hijet e gjakmarrjes, pranoi t'i kushtohej kronikës. Ishte e rëndë të shkruaje për kronikën e zezë që

rizgjonte kohën e çmendur. Të tjerët e kishin kundërshtuar një mundësi të tillë. Ajo e pranoi, ndoshta, sepse tragjikja thërriste si e marrë udhëve, sikur po dilte nga heshtja.

Në mbrëmje i kishte telefonuar Danielit. Ndjeu ditën e ngrohtë të tectorit. Era e vjeshtës sapo kishte filluar të rrëzonte gjethet e verdha, të cilat ndryshonin si sinjalët e semaforëve. Ajri i thatë nën tabunë e metropolit thithë pluhurin, që luante mbi rrëmujë, duke u tretur nëpër ankimet e njerëzve. Në parkun që ngjante si një koloni, baret dhe hotelet ishin mbushur me adoleshentë që mburreshin, se po kërkonin një botë pa tabu.

Angjelina kishte thënë, se shteti po vuante nga epidemia e rendjes drejt çmendurisë. Nuk e di xhanëm, pse ende nuk e kemi gjetur të mirën? - pyeste shpesh Julian.

- Kërkojnë shpëtim të përjetshëm, por ai nuk ekziston. - Le të vazhdojnë vallëzimin në atë botë. Amen!

Qarkullonin lloj e lloj thashethemesh për njerëzit që ishin zvogëluar para vetes dhe të tjerëve, pas shkëmbimit të botëve. Edhe deti ishte zvogëluar nga pushtimi i zërave.

Julias i vinte keq, kur shihnte parkun „Rinia „të lidhur me zinxhirë. Njerëzit ndjeheshin të rrethuar nga gjithçka, madje edhe nga vetvetja.

Dikush kishte publikuar tezen e shpifur të fillimit nga zeroja. Angjelina nuk e honepte fytyrën e tij, sepse njerëzit kishin këputur edhe rrënjet e blireve.

- Eshtë një teori e njobur, kishte predikuar shpikësi i saj dhe njerëzit ishin rrëzuar mbi pjesën e hiçit. Pastaj ai ishte shembur mbi kënaqësinë e të qenit teoricien i zeros.

Julia pa nga larg shitësin e qumështit. Ai përgjërohej, se asgjë nuk mund të fillonte nga zero, pasi ishte ferr i vërtetë të ishe një hiç, për të paguar teoricienët e humbjes.

Vetë ai, asnjëherë nuk kishte pranuar, t'i vlerësonte idetë e mendjeve njerëzore, se gjysmë shekulli i jetës së tij mund të ishte një hiç.

- Jo, bre, mos i besoni parajsës së zeros. Vetëm kërmilli di të mbyllë vveteten.

Kryeredaktori që kërkonte mausin e kompjuterit i shtrëngoi dorën. Ishte njojur me të, qysh kur ai qe student në gazetari. Për disa kohë Endri Z. kishte emigruar në Kanada.

- Më vinte keq nga vetja, kur isha atje, - thoshte shpesh.  
- Ndjehesha i ndarë përgjysmë. As këtu, as atje, një shprehje mes hiçit dhe vetes. Krahët diku, kurse mendja nën qiellin e paraardhësve. Dhe zgjidhja më e lehtë ishte kthimi. Kam një ide reale. Ndoshta të gjithë do të kthehen një ditë. Kushedi për çfarë arsyе i besoj episodit të kthimit.

- Isha i përkohshiëm në atë botë, - u kishte thënë miqve të tij, sapo qe kthyer natën nën një shi të imët tетori. - Eshtë fatkeqësi të mendosh përkohshmërisht, të bësh një jetë të përkohshme e të vdesësh përkohshmërisht. Më besoni, ndjehesha si një kufomë e përkohshme. Pastaj vendosa t'i mblidhja copat e kohës së ikur. I hodha pas krahëve, bashkë me kufomën e ikjes.

Kishte mbledhur mënjanë ca para nga puna e rëndomtë në një merkato të madhe perimesh. Siç mbinin përditë gazetat e reja, themeloi gazeten "Fjala", në të cilën publikoheshin shkrime që kishin si qëllim të largonin namin e keq të përkohshmërisë.

*N*jë kohë e tillë, mund të quhet dhe koha e dhimbjes, - kishte thënë e dashura e tij Laura, - ose koha e përdhosjes së dashurive. Mjaft zemra të thyera kanë ikur në atë botë. Zhgënjimet e përkohshme kanë prekur deri edhe fjalën. Më vjen keq që e vërteta e fjalës po ngatërrohet me të pavërtetën.

E shkuara i ngjante një ndërrese brenda trupit, e cila ishte e nevojshme të ndërrohej. Më dukej sikur po vdisja. Tashmë nuk ekziton ajo kohë. Eshtë zgavruar nga harrimi, pothuajse është bosh. - Zot mos më bëj të rijetoj të shkuarën!

Julia e pa se si vështrimi i tij po zhdukej nga sytë e saj, për të shmangur ndonjë keqkuptim qysh në takimin e parë. E falënderoi që kishte arritur të vërtetën e kërkuar tek vetja.

Ajri i mbrëmjes ishte çliruar nga lagështia. I pëlqeu të ecte në këmbë. Danieli e priste përballë piramidës. Mori gishtat e saj në duart e tij. E shtrëngoi lehtë. Fliste krejt i qetë si të kishte gjetur lumturinë imagjinare. Kërkonte një jetë që i kishte munguar, pa trupin dhe përkëdheljet e një gruaje. Asnjëherë nuk e kishte ndier Julian më pranë se atë mbrëmje. Ndiente aromën e trupit të saj. Duart i lëviznin nëpër lëkurë. Zjarri që tërhiqte thellë trupat e tyre nuk u shua deri kur agu u përmbyt nga dielli.

Në mëngjes ai i tha, se nuk i pëlqente të ishte i vetmuar. Dashuria e tyre, sipas tij kishte peshën e një dashurie të vërtetë. Ata nuk mund të jetonin pa njëri-tjetrin. Kjo në

fund të fundit ishte jeta. Brenda saj ishte përjetshmëria . Njeriu dinte të flijohej për dashurinë.

Julias iu duk, se ai zë që i kishte munguar prej kohësh tashmë ishte shkrirë brenda zemrës. I mjaftonte t'i largohej së kaluarës, pér t'iu bindur së ardhmes. Dhe më në fund ishte në thellësinë e shpirtit të një burri, nga i cili asgjë nuk do të mund ta ndante askush.

Në mëngjes shkuan pér kafe në bar “Mumja”, atje ku gazetarët njiheshin shumë shpejt me njëri-tjetrin. Realiteti i tyre ishte ndarë më dysh. Asnjera palë nuk e pranonte tjetrën. Secili i lejonte vetes fjalë të mbapshta, shpifje të rëndomta, histori të pavërteta që harroheshin të nesërmén.

Sipas shitësit të qumështit kjo gjendje kishte sjellë zhvlerësimin e fjalës dhe shpjegohej lehtë, pse njerëzit nuk besonin asgjë. Të gjithë dyshonin pér gjithçka. Kriza e iluzioneve po mbërthente qysh nga premtimet e ministrit të shtetit e deri tek projekti i urbanistit të kryeqytetit. Atë e kishin akuzuar, se nuk ishte më shumë se një bojaxhi ekstravagant, që e kishte ngjyrosur hapësirën e metropolit me ca ngjyra të çuditshme si sytë e semaforëve. Sipas gojëve lakuuese qyteti ngjante me një kryqëzim të rrënuar. Qentë e rrugës gërmionin plehrat pas natës dhe kafshonin pastrueset e ngrata.

Drejtori i gazetës “Fjala” shkruante në faqe të parë, se e mira më e madhe e urbanistit të ri qëndronte tek e keqja e paraardhësve. Ata nuk kishin qenë bojaxhinj, por i kishin dhënë qytetit rrumpallë një ngjyrë gri të errët. Pasardhësit përdorën penelat e tyre duke bashkuar të gjitha ngjyrat e zhdukura. E kishin ngjyrosur hapësirën, sikur ajo të ishte një hije e ylbertë.

Julia rrëth dritësimit të qirinjve pa të zhytur në cepin intim Arlin. E përshëndeti me dorë. Bëmat e fundit apo thashethemet kundër njëri-tjetrit, kishin të bënин me zhgënjimin e pjesës së moderuar, e cila përbënte elitën e

re. Aty përziheshin ca mendësi delirësh nga e majta dhe nga e djathta. Të gjithë dyshonin brenda vetes se humbja e tyre reale ishte mes dy grupeve kundërshtare.

Danieli shfletoi gazetat e ditës. Gjykonte se bota e ndarë më dysh ishte si ato lajme, ku flitej për çudirat e një të çmenduri që kishte thërrmuar trupin e një fëmije, apo dashuriçkat e një gruaje me tre burra. Kronika e zezë ishte si një makinë e vjetruar, e cila zakonisht hapej me pshëritim mat e vdekjes, me vrasje, me braktisje fëmijësh e gjithfarolloj ngjarjesh.

Julia priste Danielin në redaksi. Ajo tha se e shikonte si një vitrinë ere kohën e dashurive të humbura. Nuk e gjykoi veten asnjëherë për ato ndryshime të pazakonta. Shihe gjoksin e Danielit, shtrëngohen pas tij dhe largohej nga hijet e shkuara.

Migen T. përfytyronte Julian duke lexuar njoftimet e vdekjeve. Sytë e saj, ende shoqëronin kufomat e të ikurve nga bota e të gjallëve. Besonte se një ditë do të shërohej nga ajo ndjenjë lamtumirash. Por Julia nuk e kishte përfillur mëshirën e askujt, për t'u larguar nga paqja e vetes. Dhimbja ishte brenda njeriut.

Në mbrëmje, tekxa lexonte njoftimet në internet, u tmerrua pse vetë njeriu kthehej në një kamikas dhe hakmerrej kundër jetës. Eshtë çmenduria më e re e vdekjes mendoi, duke numëruar viktimat. - Deri kur . . . - thirri me zë të lartë. . . deri kur?

- Megjithatë, ne jemi një popull që na mjafton e ardhmja, - kishte thënë atë mbrëmje Angjelina. - Do ta gjejmë një ditë, atë çka është e mirë.

Migeni zgjati dorën të merrte fotografinë e Julias, të cilën e mbante brenda një ditari. Aty ruante episodet e kujtimeve. Sytë e saj kishin një shikim të largët, lyer me refleks rozë. Kujtimet po i mbulonin ndjenjat. Përkundrazi, ato nuk i

kishte harruar. I afroheshin deri në atë qytet të huaj. Në mes të asaj bote ekzistonte një ditë e re, prekur nga ndjenjat e shkrirjes së kohëve me njëra-tjetrën.

Zilja e telefonit ra rreth orës një pas mesnate. Ai duke fshirë qetësinë, mendoi se Katja e dashura e tij zvicerane, ishte jashtë lumturisë së tij. Pyeti veten, pse iu kujtua Julia D. - Ajo ndoshta të ka harruar, - iu bë sikur i tha Katja. - Harroje edhe ti!

Julia vështroi sytë e ndezur të Danielit. Në to nuk fshihej asgjë. Mëdyshja ishte thyer, si ajo ditë e mbështjellë me një qiell të larë nga shiu. Njeriu nuk mund të përjashtonte veten nga zëri i të tjerëve dhe as të jetonte jashtë tyre. Kujtimet i rëndonin mbi sy si një peshë e dukshme. Një pjesë e tyre ishin të këputura nga fijet e kujtesës.

- Të dua Julia, - i tha Danieli.

- Edhe unë të dua, - shqiptoi ajo me një zë të thellë.

Julia vështroi shiun e imët që mbulonte njollat e verdha të vjeshtës. Ndoshta për herë të parë i kishte pëlqyer drita e qirinjve. Vetëm tymi i hirtë përplasej në humbie bashkë me lamtumirat e ikura. E shkuara si një dëshpërim i largët kishte mbetur jashtë.

I dukej se e kishte lidhur jetën brenda jetës së tij. Thua jse i përshkonte e njëjta çudi romantike. E ndienin se kishin nevojë për lumturinë e zbrazur nga të tjerët.

Qirinjtë u shuan, kur dita kishte përthyer vertebrat e natës. Ata qenë arratisur mbi trupat e njëri-tjetrit, ndërsa koha po çlirohej nga përndritja. Ishin mbështjellë me një jetë të përbashkët. Njeriu vetë përbëhej nga dashuria.

Danieli ishte tashmë rrjedha e historisë së asaj jete. Sytë e tij asnjëherë nuk e vështronin larg. Ishin pranë syve të zemrës. Ajo kishte njojur ca sy të tjerë që ishin zhdukur.

Danieli duke parë muret e bardha që i zgjonin kujtime të hershme, dëgjoi tingujt e "Botës së re". Vinin nga shpirti i Angjelinës. Ajo lëvizte gishtat e hollë në jetën e botës, e

cila e kishte mbajtur larg vdekjes, pa harruar një shpirt. Dielli lyente me rrezet e tij luleboret e fundit. Në parmakun e dritareve lulet dukeshin sikur ëndërronin.

Julia hapi sytë. Ndjeu, se dashuria ishte një harmoni mes shpirtit dhe trupit, një gjendje midis ndarjeve dhe bashkimit të ndjenjave drejt përjetësisë.

Nata kishte qenë e kthjellët nën mëndafshin e qetësisë. Agu ndriçonte fytyrën i lehtesar. Julia vështroi hijen e së kaluarës për të fundit herë nën dritën e ditës. Mendoi, se ai fillim dashurie po e largonte nga ndjenjat e vjetra. Pjesa tjetër e jetës pëershkohej nga e ardhmja, e cila kishte shembëlltyrën e ndryshuar nga dashuritë e ikura. Ato i kishin prekur rrëthin e syve, ku shkruhej harrimi dhe ndjenja e njeriut që kishte pranë. Pyeti veten, a ndodhej me njeriun që dashuronte, apo me një shembëlltyrë?

Danieli ia kishte larguar perden e ankthit, pikërisht kur ajo besoi se ishte e vështirë të zhdukte të kaluarën, madje të çlirohej prej saj.

- Duhet të përvetësojmë të ardhmen, - i tha ai duke i mbështjellë trupin e hollë me trupin e tij. Tashmë ne e kemi zotëruar njëri-tjetrin deri në harrimin e ndarjes.

Të nesërmen hapësira i ngjau më e madhe se pamja e shikimit të syrit, për të gjetur universin, i cili njësohej me dimesionin e rrokaqiejeve.

Angjelina ende luante në violinë. Tingujt e harkut kishin pushtuar të gjitha qelizat e saj, si një membranë mbrojtëse rrëth shpirtit. Frymëzimi i mbetur ngajeta e afronte më shumë me kujtimet e lodhura. Ajo ndiente një lamtumirë tjetër.

Danieli të nesërmen festonte tridhjetë vjetorin. Në jetën e tij nuk i kishin pëlqyer aventurat. Kufiri mes dashurive të shkuara dhe Julias, ishte krejt ndryshe. Lidhjet e tjera po i shuheshin nga vëmendja. Ato ishin kthyer në kujtime. Gjithçka kishte mbetur si një skelet dashurie, duke u

mbuluar nga cipa e harrimit. Bota e dashurisë formohej nga prania e njeriut brenda një zemre. I ngjante lojës së fishekzjarreve që shpërthenin pikërisht për të shfaqur shkëlqimin.

Danieli mori me vete fotografitë e fundit të sfilatës. Kur dielli zbuloi një ditë tjetër, ai mendoi se nuk mund të ekzistonin dy dashuri brenda njeriut. Njëra prej tyre kishte vdekur, kurse një tjetër sapo kishte lindur. Mendimi se mund të ndahej prej saj ishte zhdukur.

Në parkun e madh, ku të gjithë i largoheshin zhurmës, njerëzit shtrydhnin titujt e gazetave të palosura nga fjalët. U ngjante sikur çliroheshin nga situatat e kohës së mbetur.

- Ajo që ka mbetur, quhet e ardhmja, - tha shitësi i qumështit duke lënë shishet plastike

në portën e Angjelinës. - Era e saj fryn për të larguar dhimbjet e vjetra. Gjithçka tashmë është larg. Nuk është aty ku ishte.

Angjelinës kishte kohë që nuk i pëlgente vëtmia e Julias. I ngjante me historinë e saj. Mungesa e dashurisë ishte si një ditë e ikur, e cila kthehej në kufomë.

Ajo vështronte sytë e Julias të lyera me një tis të njëjtë si mëndafshi i luleborës nën prekjen e agut. Njeriu kishte nevojë të shëronte shpirtin që përbënte botën e madhe të lumturisë. Ndoshta po zbulonte një frymëzim tjetër brenda shkrirjes me ndjenjën e Danielit. Druhej se, do të vuante sërisht të kaluarën. Kishte frikë se mos Julia do të rrëzohej nga dëshpërimi përpara vdekjes. Dashuritë ishin shndërruar në një trill të mbështjellë me lamtumirën e jetës njerëzore.

Ndezi abazhurin e komodinës dhe u përkul e trishtuar, për të parë sytë e Erten S. Nuk dinte nëse rrihte ende zemra e tij. Historia e jetës ishte një model që të conte tek ato rrahje të njëjtë duke formuar lidhjen e trupit. Pushtetin më të madh njeriu e kishte në ata sy që nuk ndodheshin më

larg se sytë e tu. Mendoi e përkundur nga ëndrrat e së shkuarës për kohën e përjetshme të dashurisë. - Daniel F. është i imi, -i tha atë natë Angjelinës. - Eshtë vetë dashuria.

**A**nita zbriti e para nga aeroplani i linjës Romë-Tiranë. Julia mezi e njohu, kur hyri në aeroportin „Nënë Tereza”. Dukej sikur ishte plakur. Në fytyrë i shquhej dhimbja e mallit. E përqafoi. Ndjeu lotët t'i rrëzoheshin mbi fytyrë. E ëma ndoshta vuante ende nga kujtimet e së shkuarës. I ati, përkundrazi, me ngazëllim preku tokën e atdheut të të parëve.

Kishin jetuar të dy gati gjysmën e jetës. Thellë brenda vetes mbanin kujtimin e fundit që kishte qenë një ndjeshmëri e frikshme. Secili pati jetuar nën thyerjen e një bote, të zbrazur nga liria. Të gjithë kishin qenë nën mëshirën e të gjithëve. Një lloj alla-shteti, ose gjasme shteti siç thoshte shpesh Angjelina. . . Njerëzit e atij dheu, po vuanin nga humbja e vvetvetes.

Anita kuptoi apo njohu tokën e përbashkët, se trupi iu përtëri si nga një magji e çuditshme. U mbështet mbi fytyrën e tij. E puthi si një nënë të porsalindurin e vet. Koha dhe largësia nuk po bënин asgjë më tepër. Kishin zbuluar fryshtën e drithës, e cila kishte zanafillën në térheqjen drejt zërit dhe trupit të madhësisë së vogël. Atdheu asnjëherë nuk mund të ishte më larg se sytë e zemrës. Madje, edhe të çmendurit e dinin një gjë të tillë.

Mezi arriti të nxirrte nga goja fjalët përgjysmë. Ato e bënин të vuante nga mungesa jashtë asaj bote. Eshtrat e kujtimeve lëshonin një flakë të nxehthë, e cila vinte nga zjarri

i mbetur pas ikjes së kohës. - Ka vdekur e përkohshmjë, - mërmëriti Anita, përpara se të dilte nga aeroporti.

- Do ta festojmë ardhjen e tyre, - i tha në mbrëmje Angjelina.

Thuajse ishte dëshpëruar. Pandehte se do të ëndërronte ato letrat e verdha, shenjë e përzierjes së mallit me forcën e kthimit. Sa herë e kishte ndier veten të vdekur, kur imagjinonte ca letra të zverdhura nga mbulimi i ëndrrave pa ngjyrë që vinin nga fundi i një nate tjetër. Angjelina i kishte lidhur ato letra si me një shirit të përshkuar nga shpresa. Ajo lindte pikërisht, kur shuhej terri. Buzët e ditës puthnin tokën. Errësira ishte fundi.

- Ata do të kthehen, - i thoshte një zë para muzgut. - Vetëm këtu mund të arrihet bashkimi i trupit me shpirtin.

Angjelina ishte ulur në prag të shtëpisë atë buzëmbrëmje gushti. Psherëtimat e nënshtuara po i largoheshin, ashtu si një mish i huaj nga prékja me përkohshmërinë. Me bastunin që shuante hijen e ditënetëve ishte ngritur më herët se agullimi i drithës dhe kishte mbledhur luleborët. Rrallëherë i shkonte ndër mend se po i vinte ora e vdekjes, pasi kurrë nuk e kishte shtyrë veten në përparësinë e idealizmave. Për herë të parë e kuptoi se qe e vështirë të mblidhë copat e thyera të së kaluarës. Megjithatë ende ishte në jetë. Sërisht mendoi për funeralin. Si në një dyzinë drite dalloi për të fundit herë sytë e ndezur të Erten S. Vetëm atë ditë mendoi se njeriu ishte një udhëtar i përkohshiëm i botës që i nënshtrohej ligjit të jetës. Qysh nga lindja, çdo ndjenjë e re ishte një pararendëse drejt ikjes. Nuk e shtyu veten të merrej me histori të sajuara si nëpër telenovelat latine. Ishte e sigurtë se ato orë po e tërhiqnin drejt ikjes. Megjithatë ende nuk e pranonte humbjen. I pëlqente të ishte në duel.

Lukën e gëzonte ideja se tashmë ndodhej brenda një dashurie të madhe në atë copëz tokë që i kishin dhuruar paraardhësit. Diçka e ngjashme me një tërheqje si batica. Aty kishte nevojë për bregun. Ai e afronte me praninë e

asaj dhome të bardhë, ku ishin fytyrat e fëmijëve që mbështeteshin mbi krahët e tij.

Trupi i hollë i Angjelinës i kujtonte zërin e hidhur të kohës, ku shquhej cipa e mavjosur e historisë. Çuditërisht kishte dëshirë që të tjerët ta kujtonin pjesë-pjesë. Ai u gjallërua, kur ndjeu të rrahurat e zemrës të së ëmës. Angjelina i përngjiste një kështjelle. Brenda saj hynte vetëm dielli. Ajo e kishte ndihmuar të parashikonte pjesën tjetër të jetës brenda një dashurie të përjetshme. Mbështeti trupin e imët mbi gjoks njëlloj sikur të ishte një brendësi e tij. Vdekja iu duk e largët, e padukshme.

- Do të të fal që ke ikur, - i përshpëriti me një zë të përhumbur Angjelina. - E dija se do të ktheheshe. Kam pritur në kafazin e vëtmisë, ashtu siç kam pritur të nesërmen.

Nuk dinte pse e përmbysi zemërimin atë ditë të mbrapshtë tectori, kur Luka shkroi një letër fajtore, të cilën e la në mes. Dukej se çdo fjalë i përgjigjej zërit të fajit. Nuk gjente arsyё të ngushëllonte mëkatin e ikjes. Mori me vete lëkurën e kujtimeve.

Në mëngjes kujtoi fytyrën e largët të vdekjes krejt të paqenësishme. Ndoshta ende nuk e kishte përbushur misionin e saj në botën e të gjallëve.

Dy ditë më vonë, tekxa era frynte si e marrë, ajo u zgjua në agoni. I shfaqej para syve me ca njolla të errëta të shkrira tërësisht mbi kujtimet. Kishte menduar se njeriu qe një udhëtar i përkohshëm i botës. Por ende ndjehej nën rrezet e jetës. Preku edhe njëherë fotografinë e Ertenit. Kishte jetuar një jetë me imazhin e tij të gjallë. Atë ditë i dukej se po e braktiste. Brenda saj, ajo fytyrë kishte një shprehje dhimbjeje e paqeje, misteri dhe vdekjeje. Tashmë Erten S. përmes syve të gjelbërt, pa se po i mbaronte e ardhmja.

Luka i ulur në poltronin ngjyrë dheu, akoma lutej për shpirtin e saj. Trupi i hollë i së ëmës i kishte ngjarë me një

mburojë të përjetshme, e cila e pati shtyrë gjatë gjithë jetës të besonte afrimin e lirisë. Ajo ishte e vetmja grua që ishte rrethuar nga paqja dhe po largohej duke lënë pas një rijetim shpirtërash. Ndjenja e bashkimit, ashtu si ndjenja e têrheqjes, zgjohet nën dritën mëngjesore. Angjelina kishte jetuar, sepse në brendësi të vetes mbajti kohën e re, me të cilën përkulej para jetës. Erten S. kishte qenë vetëm një dritë në jetën e saj.

Mbuluar me tisin e artë të rrezeve, tekxa rrinte e mbështetur në gjoksin e tij, ajo tha sërisht se nuk i besonte vdekjes. Kurrë nuk e kishte imagjinuar atë.

Në shtëpi ishte kthyer dashuria e mërguar, siç e quante Julia. Dikur ajo ishte përcartur në udhët e largëta të botës, ku kilometrat shndërroheshin në metro malli dhe udhë të përkohshme. Kujtimet e dëlirta të ikjes shtyheshin si ecejaket e tyre që kërkonin nën peshën e kohës kthimin tek një shpirt i përjetshëm. Për ca kohë Angjelina i kishte ndier të shkulura nga trupi eshtrat dhe gjakun. Kthimi qe i vetmi shteg, në të cilin shihte në brendësi pasardhësit. Nga mungesa e pjesës tjetër ishte krijuar një cep i mbyllur jashtë dashurisë. Si mund të jetonte bota pa eshtra? Ishte e pamundur një gjë e tillë!

Një çast shquajti fytyrën e Ertenit. Nuk e kishte ndjekur më shumë hija e vetes se sa hija e tij. Dy hije që iknin pas njëri-tjetrit.

- Ajo prandaj ende jeton, - i tha Julia të atit. - Pikërisht sepse epilogu i dashurisë për të ishte i përjetshëm. Ndaj kurrë nuk e pranoi vdekjen.

Në të vërtetëjeta dhe vdekja kishin jetuar në trupin e saj. I ngjante një peme pa moshë, të cilën e kishte mbajtur gjallë e nesërmja. Ajo nuk e kishte shuar kurrë dritën c zemrës. Besonte se dita që do të lindte nesër ishte më e madhe se dita e vogël e vdekjes. Asnjëherë nuk kishte menduar për atë ditë.

Julia vërejti cipën e dritës që i kishte veshur fytyrën dhe hodhi vështrimin në sytë e Angjelinës. Ajo ishte ngjitur deri në majën e pemës së jetës, për të ndezur dritën e dashurisë. Diku, atje në kohën e thithur nga vitet, kërkoi të gjente një mrekulli, e cila shfaqej në pikën më të afërt me ditën. Pas natës, kur vrojtonte shkuljen e errësirës përthyente zbrazjen e lamtumirave të pritjeve.

Në botën e zemrës mbante të njëjtën dashuri. Kapej pas trupit të Erten S. si me të vetmin rikthim që ekzistonte pas ndjenjës së humbjes. Çdo ditë e griste shiritin e zi të errësirës. Në vitrinën e ditës shihte të ardhmen pas së shkuarës. Nuk ishte e vërtetë as thënia e Antonit, se ishte takuar me një ëndërr. Ajo kishte mbërritur në kulmin e jetës, pa dyshuar ndonjëherë në vdekjen e Erten S. Vallëzonin bashkë në sheshin e lirisë.

- Eshtë një formë e përcartjes për të vuajtur, - tha Anita në heshtje.

Angjelina lëvizi sikur kërkonte të gjente një lidhje të paracaktuar. Era e lodhur ishte në mëdyshje të harronte shfrimin e saj në një shi vjeshtor.

Ca syresh të harruar edhe atë ditë e akuzonin, se ishte një mendje e çmendur që kërkonte në humbëtirën e vdekur një hije të gjallë.

Për fat të mirë mrekullia ekzistonte. Ishte e vërtetë se dikush dinte t'i zbulonte mrekullitë e reja. Angjelina nëpërmjet mënyrës, për të mbajtur gjallë dashurinë e saj, ishte përtërirë duke u lidhur me jetën. Pastaj harroi të vdiste, sepse vetë dashuria qe një zë i përsosur, i cili mjaftonte për t'i besuar një ëndrrë. E vëtmja lidhje ose komunikim mes trupit dhe shpirtit ishte një fjalë e lindur nga zemra.

- Po është e vërtetë, - tha Julia. - Ajo kishte brenda vetes një zemër të përjetshme.

Angjelina u përpoq të lehtësonte trupin, për të gjetur pak qetësi pas atyre orëve të zhveshura nga ankthi i humbjes së lidhjeve me zërat që e rrëthonin. Ndoshta në ato momente kishte ndier se eshtrat i qenë bashkuar si me magji duke mbajtur mbi vete një ditë tjetër. Poshtë gjoksit ndieu një dhimbje të bukur. Ra në gjunjë duke u lutur për dashurinë. Jashtë era kishte prerë litarët e shiut. Dielli po i vinte rrotull botës.

**L**uka e afroi në gjoks. Iu lut Zotit ta shpëtonte lumturinë e saj. Ai mendueshëm u bind se lumturia ishte e përbotshme dhe jetonte në dimensionin e çdo zemre. Njeriu rrënohej atë ditë kur venitej brenda vetes dashuria.

Shpirtërat në mërgim ishin bashkuar atë mëngjes të dhembshur me shpirtin e saj. Dukej se ajo, kryqëzimin mes ikjes së paraardhësve dhe ardhjes së pasardhësve e shihet, ashtu siç kishte parë bregun e lagur të detit. E ardhmja i ishte ngjitur në trup, e në gjak, ashtu si ajri i mëkatit të ikjes dhe i dëshirës së kthimit.

Zërat e tyre në shtëpi dukej se po e mbronin nga vdekja, e cila ishte prapa si një muzeum i së shkuarës. Atje e priste vëtmia dhe dy që e kishin pritur një jetë.

- Ç'ka ende brenda saj? - pyeti të nesërmen Julia. - A thua më në fund do të bashkohet me një qenie tjetër, të cilën e ka pritur me fuqinë e zgjimit?

Luka nxorri nga sirtari diskun e vjetër të "Botës së re". Ajo e kishte ruajtur siç kishte ruajtur fryshtë e zemrës së humbur.

- Gjatë gjithë jetës e ka kërkuar atë zemër, - tha edhe njëherë Julia para se i ati t'i bënte shenjë të heshtte.

Nëpër dhomë u përhapën tingujt e ngarkuar me dhimbje e shpresë të simfonisë së një bote tjetër. Angjelina midis lotëve, ku ishin zbruzur pshëritimat e vjetra, pa diku pamjen e fundit të jetës që i ngjasoi me një vajzë veshur me këmishë të bardhë.

- Edhe e vdekur do të ringjallem, për të prekur botën e re, - tha ajo. Vdekja nuk iu bind lamtumirës së fundit. Ende ishte larg prej saj.

Të gjithë kishin shtangur prej atyre fjalëve. Anita mendoi se ndoshta ishte amaneti i vetëm i Angjelinës dhe jo ndonjë përfytyrim nga vdekja. Ajo përshpëriti me zërin e mbetur në dritë edhe njëherë, se në botë do të mbretëronte pushteti i dashurisë.

Ora mbeti në vend. Akrepat u shkrinë tërësisht në një bashkësi të vetme. Rrezet e hidhëruara të diellit depërtuan nga dritarja. Natën u derdhën në sytë e luleborëve.

- Pak qetësi, - pëshpëriti Luka duke prekur gishtërinjtë e saj të ftohtë.

Angjelina ngriti sytë e gjelbërt, për të fundit herë. I ngjau se po rrugëtonte drejt një udhe të gjatë me shpirtin dhe zemrën e Erten S.

Të nesërmen nuk u zgjua më. Duart i kishte të bashkuara me njëra-tjetrën. Mes tyre mbante fotografinë e Ertenit.

Ishte e djelë, kur u lajmërua vdekja e Angjelinës. Njoftimin e shpërndau nëpër qytet shitësi i qumështit. Ai e krahasonte atë me një pasqyrë, ku zbuloheshin gjurmët e një dashurie të vdekur, përzierjet e dritave dhe parandjenjat e një bote tjetër.

Qyteti ishte rrëqethur nga dridhmat, kur kishte dëgjuar për atë vdekje. Askush nuk e kishte zbuluar të fshehtën e saj. Njerëzit patën jetuar me parandjenjën se ajo do të çlirohej nga e shkuara, kur të gjente një frymëzim që e kishte shtyrë të jetonte njëqind vjet. Kaq ishte e mjaftueshme, për të ikur në botën e përtejme.

- Mos kujtoni se ishte një aventurë, - tha Luka teksa njerëzit e shumtë e ngushëllonin për vdekjen e saj. - Njeriu nuk mund të jetojë gjithë jetën me një aventurë, por mund të mbijetojë vetëm nga dashuria. Dhe Angjelina iku e dashuruar nga kjo botë.

- Ajo mori me vete një dashuri të vetme dhe magjinë e botës së re, - tha prifti, teksa vuri mbi arkmort luleborët. Amen! - Shpirti i saj mbetet rrëth nesh. I përjetshëm qoftë kujtimi i saj! O njerëz, kremtoni ditën e dashurisë së botës! Vetëm ajo është mrekullia e madhërishme e njerëzimit. Fshijeni mykun eurrejtjes. Le të besojmë në botën e re që jeton me të ardhmen.

Hëna kishte ndriçuar natën e zbehtë. Ajo lëshonte një dritë të argjendtë në qiellin e lodhur. Ndoshta dita e zbrazur nga një èndërr i bënte njerëzit të lidheshin me fijet e kujtimeve nëpërmjet urave shpirtërore. Hija e së kaluarës që mbështjellë me copëza kujtimesh duke lënë pas historinë.

- Edhe Angjelina D. la pas vetes një histori, - tha Julia duke larguar valën e lotëve mbi fytyrë. Sa shumë kemi nevojë për dashurinë!

Julia e kishte dëgjuar një natë maji zërin e zemrës së Angjelinës. Jashtë binin fjollat e imta të dëborës. Njerëzit sodisnin të heshtur cipën e bardhë dhe çuditeshin me tekat e natyrës.

- Do të dëgjojmë një vdekje, - kishte thënë Angjelina të nesërmen.

Të gjithë ishin duke pritur stinën e diellit, kur ja behu heshtja e ftohtë. Gjithë natën ishin dëgjuar ulërimat e ca këlyshëve të turmës së qenve. Ata përshkonin qytetin sikur të njihnin gjithkënd. Nën dritën e hënës gjetën shembëlltyrat e tyre dhe heshtën. Qyteti u zgjua të nesërmen nga një vdekje. Shembëlltyrat ishin në gjumë.

Përballë fotografisë së Angjelinës ishte zbuluar e kaluara. Por Julia nuk mungoi ta njihte me të ardhmen. Kishte sajuar në fletën e ditarit, një rrëth të rrumbullakët. Brenda tij ishte mjaftuar të çmonte të kaluarën duke prekur ardhmërinë. Kohëve të ikura pati përjetuar ngjarje nga më të papriturat. I bënte përshtypje ideja e ndërsjelltë e lëvizjes së kohës që njeriu tërhiqte pas vetes. Bota nuk harronte të zgjohej.

- Unë jetoj me jetën, - i tha Julia atë natë Angjelinës. - Nuk jetoj me vdekjen.

Përkufizimi i së shkuarës ishte si një frazë e largët, e cila qe zhveshur nga ikja. Ajo ndiqte të ardhmen siç ndiqte dita natën, për të zbuluar triumfin e drithës.

Kafene "Mumja" ishte e kaltër nga tymi i qirinjve, që gati ishin në të shuar. Ndjeu mall për Danielin. Iu duk se zemra po i zbrazej nga mungesa e tij. Atëhere besoi se qe pushtuar nga dashuria.

- Do të jetë lidhja jote e vërtetë i kishte thënë Angjelina një mbrëmje. - Lëre zemrën të çlirohet nga koha e ikur. Të duash një njeri është njësoj si të hysh në një botë.

Danieli ishte atje, në cepin intim duke e pritur. Kishte ndodhur ajo që u ndodhë gjithë njerëzve. Të dy po kërkonin njëri-tjetrin. Kujtimet e zgogluara të dashurive qenë bjerrur, ashtu siç treteshin hijet në harrim. Njeriu ndiente lëvizjen, e cila të çonte thellë në udhët e zemrës. Brenda atij oqeani hyjnor secili gjen engjëllin e përqafuar, që të zgjon me puthje. Bota lindi, sepse kishte lindur dashuria. Ndryshe pema e jetës do të kishte vdekur, ashtu siç shuhën yjet nën lëkurën e agut.

Atë mbrëmje Luka e shikoi Julian me një ndjenjë ankthi. Qysh kur ishin kthyer nga Nju Jorku e kishte parë të bijën, sikur të ishte brenda një ere.

Anita apo ishte kthyer nga varrezat. Nxori nga bufeja shishen e konjakut dhe e hapi.

- Mos u çudit për atë çka do të dëgjosh, - iu drejtua të shoqit. - Në varreza, teksha blija lule dëgjova tingujt e "Botës së re" mbi varrin e Angjelinës. Afér zemrës, Julia i kishte vendosur një magnetofon të ri, ku shpërndaheshin tingujt e muzikës për shpirtin e saj. Njerëzit mbetën të çuditur, madje një gruaje i ra të fikët. Varrëmihësit më thanë, se ishte diçka e bukur dhe e rrallë

ai respekt për të vdekurit. Ndoshta e kishin marrë për një ringjallje.

- Zoti e bekofjtë mendjen e asaj vajze, - kishte thënë një varrmihës duke nxjerrë nga xhepi kasetën e Selin Dion që i kishte dhuruar Julia. E adhuroj muzikën. Eshtë diçka e bukur të dëgjosh tinguj të gjallë në këtë botë të vdekur. Edhe të vdekurit kam idenë se e largojnë vetminë, sepse nuk duan ta harrojnë jetën.

Luka nuk e mori atë veprim si një trill të së bijës. Madje as nuk u çudit. Hodhi vështrimin në sytë e gjelbërt, të cilët ndjeheshin të qetë.

- Le të harrojë vdekjen, - iu përgjigj të atit. - Ajo kurrë nuk i besonte botës së përtejme.

Qielli ende ishte i pérndezur, kur Julia ndjeu t'i zgjoheshin kujtimet për Angjelinën. Preku fotografinë, në të cilën dukej se ajo ishte në jetë po aq sa ishte në vdekje. E shtrëngoi në gjoks, sikur të ishte trupi i saj. Eshtë shpirti mendoi me vete. Ai nuk mbytet me një lamtumirë. Ishte mbështjellë nga drita hyjnore.

Aeroplani i linjës "Albania Airlines" fluturonte mes heshtjes së qiellit, kur Migen T. çmpiu këmbët dhe piu një gotë me Coca-cola. Ndiehej gjysmë i zbrazët në mes të dy botëve. Një zë që vinte nga mijëra kilometra larg po e afronte me tokën e diellit. Pasagjerët shihnin hapësirën poshtë, të njëjtë me hapësirën e mallit. U mungonte pjesa e madhe e jetës. Besoi se Julia kishte gjetur paqen brenda vetes, para se të merrte pjesë në vdekjen e fundit.

Shitësi i qumështit kishte qenë i pari që mori vesh celebrimin e Julia D. Sytë i kishte të ngijer me imazhet e fytyrave që i mungonin. E ardhmja ishte atje.

- Gjithçka ka ngrirë mes nesh, - i tha Arli K. gruas që i rrinte përpara, si një pritë. - Jemi vetëm dy hije të padukshme, një ëndërr e vdekur në pritje.

Julia dukej e përtërirë. Ishte veshur me një kostum mëndafshi të bardhë dhe rrëthohej nga tre burra. Ngjante sikur po ecte në një botë të ëndërrt, të tejdukshme e mbrojtur ngajeta, pas erës së vdekjes.

- Çudi, si në ceremoninë e bashkimit ajo kishte ftuar të gjithë të dashurit e saj, - tha Anita.

- Ka një zemër të madhe Julia, - ia ktheu Luka. - Ndoshta lamtumirat janë larg. Jeta e saj duket e ndriçuar nga paqja.

Udhët e qytetit ishin të urta. Shitësi i qumështit ende rrugëtonte. Ai u rrëfente njerëzve lajmin, se Julia D. ndodhej në altarin e dashurisë. Madje kishte thirrur edhe dashnorët e vet. Hi, hi, hi - qeshte ai duke mbushur shishet.

- Mendoni bre, çfarë mrekullie, të të dashurojnë tre burra. E pashë duke vallëzuar edhe me ta bre... Ju betohem. Midis atyre fytyrave, njeriu dinte të pushtonte botën e zemrës.

- Kam gjetur një shpirt të mirë, - tha me zë të qetë Danieli dhe largoi nga kujtesa dy hije.

- Unë jetoj nesër, - iu përgjigji Julia, duke lëshuar pas vetes trëndafilët e bardhë.

Daniel F. puthi buzët e saj të nxehta. Duke hyrë thellë brenda njëri-tjetrit, kërkuan jetën. Asgjë më shumë.

Tiranë, Janar 2004